

Council of Europe
European Commission



Conseil de l'Europe
Commission européenne

Projekti Rajonal CARPO

Shqip

Përditësim i Raportit të 2006-ës mbi Gjendjen e Krimin të Organizuar dhe Krimin Ekonomik në Evropën Juglindore

Strasbourg, qershor 2007

Projekti CARPO ("Zhvillimi i sistemeve policore të besueshme dhe funksionale si dhe nxitja e luftës kundër aktiviteteve kryesore kriminale dhe i bashkëpunimit policor") është një projekt teknik i përbashkët dhe i bashkëfinancuar nga Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian. Ai ka një kohëzgjatje prej 30 muajsh (mars 2004-shtator 2006) dhe u shty për 9 muaj të tjerë deri në qershor 2007. Këshilli i Evropës është përgjegjës për zbatimin e projektit, në partneritet me Belgjikën, Finlandën, Hungarinë, Italinë, Slloveninë, Spanjën, Suedinë dhe Organizatën Ndërkombëtarë për Migracionin.

Për çdo informacion shtesë, ju lutem,
kontaktoni:
Departamenti i Bashkëpunimit teknik
Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtave të
Njeriut dhe Çështjeve Ligjore
67075 Strasbourg CEDEX, Francë
Tel +33-3-9021-5305 ose
E-mail: jean-charles.decordes@coe.int të
Website: www.coe.int/economiccrime
Ref. n° : PC-TC(2007)

Ky dokument është prodhuar me ndihmën
financiare Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të
Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund
të interpretohen në asnjë mënyrë se
përfaqësojnë opinionin zyrtar të Bashkimit
Evropian, ose Këshillit të Evropës.

Paqyra e Lëndës

1	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
2	KRIMI I ORGANIZUAR DHE KRIMI EKONOMIK NË EVROPËN JUGLINDORE: KUADRI	6
2.1	QËLLIMI DHE KUADRI I KËTIJ RAPORTI	6
2.2	KRIMI I ORGANIZUAR DHE TIPARET E TIJ DALLUESE	9
3	AKTIVITETET KRIMINALE	11
3.1	TRAFIKIMI I DROGAVE.....	11
3.1.1	<i>Stimuluesit e llojit të amfetaminës (ATS)</i>	12
3.1.2	<i>Produktet e Kanabisit</i>	13
3.1.3	<i>Kultivimi i luleve të opiumit dhe prodhimi i paligjshëm i heroinës</i>	15
3.1.4	<i>KOKAINA</i>	17
3.2	TRAFIKIMI I QËNIEVE NJERËZORE	21
3.3	KONTRABANDIMI I PERSONAVE.....	27
3.4	KRIMI EKONOMIK.....	32
3.5	PASTRIMI I PARAVE	37
3.6	KORRUPSIONI	41
4	REKOMANDIME (TË SHKURTRA)	44
5	SHTOJCË: KONCEPTI I KRIMIT TË ORGANIZUAR	45
6	BIBLIOGRAFIA	47
7	SHKURTIMET DHE AKRONIMET	52

1 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Krimi i organizuar dhe krimi ekonomik kërcënojnë të drejtat e njeriut, shtetin e së drejtës, sigurinë shtetërore, ekonominë dhe demokracinë në Evropën Juglindore dhe më tej. Kjo situatë kërkon një analizë të përditësuar esenciale dhe të rregullt mbi qëllimin, natyrën dhe karakteristikat e krimit të organizuar dhe krimit ekonomik në rajon. Si rrjedhim, në kuadrin e projektit rajonal¹ CARDS, janë përgatitur tri raporte mbi situatën e krimit të organizuar dhe krimit ekonomik në Evropën juglindore.

Raporti mbi situatën e **2004/2005** u përgatit gjatë pranverës dhe verës së 2005-ës dhe iu paraqit ministrave të Brendshëm dhe të Sigurisë të Evropës Juglindore në takimin e nivelit të lartë të mbajtur në shtator të 2005-ës në Brijuni (Kroaci).

Raporti mbi situatën e **2006-ës** ishte një përditësim substancial i raportit të mëparshëm, dhe përfshinte informacion për të gjithë vitin 2005 dhe informacion të pjesshëm mbi punën në tremujorin e parë të 2006-ës. Raporti bazohej në kontributet e përfaqësuesve nga institucione të ndryshme të zbatimit të ligjit nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova², Mali i Zi, Serbia, dhe “ish Republika Jugosllave e Maqedonisë” (të cilave më poshtë do t’ju referohemi si “zona të projektit”). Gjatë përgatitjes së raportit u morën parasysh informacione shtesë nga organizata dhe struktura³ të ndryshme ndërkombëtare të policisë dhe raporte të botuara së fundmi nga burime qeveritare, jo-qeveritare dhe burime të tjera të hapura. Raporti iu paraqit Shefave të policisë dhe zyrtarëve të lartë nga Evropa Juglindore në takimin rajonal të mbajtur në Sarajevë më 21 shtator 2006.

Qëllimi i raportit të situatës për **2007** është që të përditësojë shkurtimisht raportin e situatës për 2006-ën. Përderi sa në këtë fazë të hershme burimet e tjera nuk janë botuar ende, raporti aktual është bazuar kyesisht mbi kontributet e dhëna në zonat e projektit. Raporti lejon një rishikim për një periudhë 3 vjecare mbi situatën e krimit të organizuar dhe krimit ekonomik dhe do t’i paraqitet Shefave të Policisë nga Evropa Juglindore në takimin rajonal në Beograd (Serbi) më 20 qershor 2007.

Bazuar në gjetjet e periudhës 2004-2006, krimi i organizuar dhe krimi ekonomik në Evropën juglindore, ashtu si dhe në vendet e tjera, përbën një koncept dinamik që i përshtatet një mjedisi gjithnjë e në ndryshim. Ai strukturohet gjithnjë e më tepër në nivelet e shumëkombësisë dhe të të qenit heterogjen, është shumë i ndryshueshëm, i drejtuar drejt sipërmarrjes, duke përfshirë një gamë të madhe të aktiviteteve kriminale, kryesisht trafikimin e drogave, prodhimin dhe shpërndarjen e tyre, trafikimin e qënieve njerëzore, kontrabandimin e njerëzve dhe krimin ekonomik.

Të gjitha zonat e projektit kanë zbatuar përkufizime ligjore mbi krimin e organizuar dhe krimet e rënda në kuadret e tyre ligjore kombëtare. Ata janë të ndërgjegjshëm për faktin se parandalimi dhe ndalimi i krimit të organizuar dhe krimit ekonomik varet shumë nga një njohje e thellë të këtyre fenomeneve ndërkombëtare, një zbatim i plotë i politikave të krimit kombëtar dhe strategjive në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare dhe një bashkëpunim i krijuar mire dhe funksional për zbatimin e së drejtës ndërkombëtare.

Gjetjet kryesore të këtij raporti janë:

¹ “Zhvillimi i Sistemeve të Besueshme dhe Funkcionuese të Policive dhe Nxitja e Luftës kundër Aktiviteteve Kryesore Kriminale dhe i Bashkëpunimit Policor”. Ky raport është financuar nga Komisioni Evropian dhe Këshilli i Evropës, dhe fillimisht zgjati për 30 muaj (mars 2004-shtator 2006) dhe më pas u shty për 9 muaj të tjera deri në qershor 2007. Për më tepër informacion referojuni adresës www.coe.int/carpo.

² Aktualisht nën administrimin e përkohshëm të UNMIK-ut në përputhje me rezolutën nr. 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

³ Psh Europol, Eurojust, Frontex, EMCDDA, PAMECA, UNMIK, Qendra SECI, por edhe Interpol, ICTY, UNODC dhe struktura të tjera të Kombeve të Bashkuara.

Rruga tradicionale ballkanike e trafikut të drogës është shndërruar në një rrugë dykahëshe, duke e rritur vëllimin e trafikut. Kryesisht, heroina dhe kanabis lëvizin në kahjen drejt Bashkimit Evropian që është dhe tregu kryesor i konsumimit të drogave të paligjshme, ndërkohë që perkursorët kimikë dhe drogat sintetike janë duke lëvizur në kahjen drejt lindjes, gjithnjë e më shumë në formën e trafikimit të shumë-drogave ('ngarkesë koktejl').

Trafikimi i qenieve njerëzore për shfrytëzimin e tyre seksual është bërë më i fshehtë (klandestin) dhe më i sofistikuar, por duket sikur po ulet. Duket sikur viktimat trajtohen më pak dhunshëm në aspektin fizik (dhe duket sikur marrin më shumë para) por janë objekt i më shumë presioni psikologjik (kërcënimeve për familjet e tyre në vendet nga vijnë). Disa zona projekti kanë raportuar trafikimin e fëmijëve (nën 18 vjec) për të lypur ose për qëllime të tjera klandestine .

Migracioni i paligjshëm ka qënë dhe vazhdon të jetë në krye të axhendave kombëtare dhe ndërkombëtare për ca kohë. Përpjekjet për zbatimin e ligjit dhe për një menaxhim më efektiv të kufijve duket sikur kanë sjellë një ndryshim pozitiv pasi shifrat janë në rënie; të paktën për sa i takon angazhimin të grupeve të kimit të organizuar.

Krimi ekonomik i cili çënon seriozisht të gjitha zonat e projektit në rajon vazhdon të zhvillohet, por vazhdon të jetë i paqartë. Legjislacioni i ndryshuar i taksave ka cuar në rritjen e të ardhurave dhe në ulje të ndjeshme të evazionit fiskal. Gjithsesi në rajon ka akoma disa mundësi të tregtisë së paligjshme, të tilla si kontrabanda në përmasa të mëdha e të gjitha llojeve të mallrave (cigareve dhe armëve). Shumëfishimi i parave të falsifikuara dhe falsifikimi i dokumenteve po rritet. Forma të tjera të krimit ekonomik, të tilla si prodhimi i mallrave pirate dhe krimi kibernetik duket sikur kërkojnë më shumë vëmendje.

Ndërkohë që zonat e projektit e kanë pranuar ndikimin negativ që krimet e rënda kanë mbi ekonominë, shoqëritë dhe zhvillimet demokratike të këtyre vendeve, ato kanë krijuar Njësi të Inteligjencës Financiare (FIU) ose organizma të tjerë të ngjashëm. Hetimet financiare dhe informacionet e inteligjencës janë shumë të dobishme, ashtu sic dhe përdorimi i të gjithë mundësive ligjore për të konfiskuar dhe sekuestruar të ardhurat nga krimet. Gjithesi, shërbimet e inteligjencës janë të fragmentarizuara.

Korrupsioni duket se është një instrument themelor për ndikimin dhe depërtimin tek strukturat politike dhe komerciale. Në të gjitha zonat e projektit, korrupsioni ende përbën shqetësim madhor. Gjithsesi, në të gjitha këto vend janë miratuar kuadre ligjore të modernizuara, janë miratuar strategji gjithpërfshirëse, janë zhvilluar plane veprime si dhe janë krijuar strukturat e duhura organizative. Shifrat në rritje në disa zona të projektit dëshmojnë për një zhvillim pozitiv.

Masat e zhvilluara nga zonat e projektit në kuadër të projektit CARPO, por edhe në kontekstin e bashkëpunimeve të tjera më BE-në, Paktin e Stabilitetit, Qendrën e SECI-t, Kombet e Bashkuara, apo mekanizmat monitorues të Këshillit të Evropës si GRECO dhe MONEYVAL, do të ndihmojnë në kapërcimin e këtyre të metave, nëpërmjet:

- Përmirësimin të vazhdueshëm të mbledhjes së informacionit, krijimi i një sistemi të fortë informacioni dhe statistikash të krahasueshme të krimit, zbatimi i një sistemi analizimi në përputhje me standartet e BE- (ENFOPOL 35) dhe përfundimi i zbatimit të instrumentave ligjorë për privacinë dhe mbrojtjes së të dhënave në nivelin e BE-së;
- Bashkëpunim i synuar dhe me përparësi për strukturat e zbatimit të ligjit në rajon (ndërgjithësisht dhe qasja ndërkufitare), duke përdorur intensivisht strukturat e BE-së dhe strukturat që janë ngritur në rajon (Europol, Eurojust, Frontex, Olaf, Qendra Seci, Iniciativa e Paktit të Stabilitetit);
- Trajnim dhe mbështetje teknike e vazhdueshme për të forcuar aftësitë e hetimit në fushat e krimit të organizuar dhe krimit ekonomik, duke përfshirë dhe përpjekje domethënëse për trajnim gjuhësor për të mënjanuar barrierat;

- Monitorim dhe efektivitet strukturash, masash dhe ndihmë për parandalimin dhe kontrollit të krimit të organizuar dhe krimit ekonomik nga zonat e projektit mbi një bazë më shumë sistematike⁴;
- Zhvillim i mëtejshëm i SEEPKA-s për të krijuar një strukturë me funksione dhe përgjegjësi të ngjashme me Shefin e Bashkimit Evropian për Grupin e Punës së Policisë;
- Përfundim i procesit të ratifikimit dhe të zbatimit të plotë të Konventave Evropiane dhe instrumentave të tjerë, të cilat do të ndihmojnë përfundimisht zonat e projektit që të arrijnë rezultate dhe të lehtësojnë bashkëpunimin ndërkombëtar⁵, miratim dhe zbatim i standarteve dhe rregulloreve të BE-së si dhe përdorimi i programeve mbështetëse⁶.

Pritet që ky raport të përbëjë një udhërrëfyes për politikë-bërësit në Evropë dhe në rajon për të projektuar politika publike kundër krimit, nga pozita më të informuara, si dhe për të ndërmarrë në përputhje me këto politika, veprime të ndërthurura në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimit ekonomik në Evropën Juglindore.

2 KRIMI I ORGANIZUAR DHE KRIMI EKONOMIK NË EVROPËN JUGLINDORE: KUADRI

2.1 QËLLIMI DHE KUADRI I KËTIJ RAPORTI

Shkëmbimi i informacionit në shkallë të gjerë ndërmjet autoriteteve evropiane të zbatimit të ligjit, analiza e përmirësuar e informacionit kriminal si dhe një bashkëpunim më i ngushtë ndërkombëtar kanë ngritur shqetësime të mëdha lidhur me krimin e organizuar dhe krimin ekonomik në Evropën Juglindore. Kjo si dhe perspektiva e pranimit të këtyre vendeve në BE, diktojnë nevojën e një analize sistematike dhe thelbësore të shtrirjes, natyrës dhe karakteristikave të krimit të organizuar dhe krimit ekonomik në rajon, si dhe rrjetet e tij ndërkombëtare.

Si kundërpërgjigje, Këshilli i Evropës skicoi projektin rajonal për të fuqizuar kapacitetet e policive kundër krimeve të rënda në Evropën Juglindore. Një prej rezultateve të pritshme të këtij projekti është të thellojë njohjen për krimin e organizuar dhe krimin ekonomik si dhe kërcënimet që lindin prej tyre. Në kuadër të këtij projekti janë përgatitur raporte të rregullta mbi situatën mbi krimin e organizuar dhe krimin ekonomik në Evropën Juglindore që prej 2005-ës:

Raporti mbi situatën e 2004/2005 u përgatit gjatë pranverës dhe verës së 2005-ës dhe iu paraqit Ministrave të Brendshëm dhe të Sigurisë të Evropës Juglindore në takimin e nivelit të lartë të mbajtur në shtator të 2005-ës në Brijuni (Kroaci).

Raporti mbi situatën e 2006-ës ishte një përditësim substancial i raportit të mëparshëm, dhe përfshinte informacion për të gjithë vitin 2005 dhe informacion të pjesshëm mbi punën në tremujorin e parë të 2006-ës. Raporti bazohej në kontrobutet e përfaqësuesve nga institucione të ndryshme të zbatimit të ligjit nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Kosovo⁷, Mali i Zi, Serbia, dhe “ish Republika Jugosllave e Maqedonisë” (të cilave më poshtë do t’ju referohemi si “zona të projektit”). Gjatë përgatitjes së raportit u morën parasysh informacione shtesë nga organizata dhe

⁴ Krijimi i një komiteti drejtues ose paneli drejtues të përbërë nga përfaqësues të strukturave dhe homologëve kryesore ndërkombëtarë të zonave të projektit do të mund të mblidhte sinergjitë dhe të conte në kursimin e parave.

⁵ Shih për shembull Rekomandimin e Këshillit të Evropës, Nr. R (86) 8 mbi politikën kundër krimit në Evropë në një kohë ndryshimesh.

⁶ Si programet e BE-së FALCONE, PHARE, programi i ri “Për Parandalimin dhe Luftën Kundër Krimit 2007-2013”, Vendimi nr 2007/125/JHA, i miratuar nga Këshilli i BE-së më 12.2.2007, ose programet e ndryshme të asistencës teknike të Këshillit të Evropës.

⁷ Aktualisht nën administrimin e përkohshëm të UNMIK-ut në përputhje me rezolutën nr. 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

struktura⁸ të ndryshme ndërkombëtare të policisë dhe raporte të botuara së fundmi nga burime qeveritare, jo-qeveritare dhe burime të tjera të hapura. Raporti iu paraqit Shefave të policisë dhe zyrtarëve të lartë nga Evropa Juglindore në takimin rajonal të mbajtur në Sarajevë më 21 shtator 2006.

Qëllimi i raportit të situatës për 2007⁹ është që të përditësojë shkurtimisht raportin e situatës për 2006-ën. Përderi sa në këtë fazë të hershme burimet e tjera nuk janë botuar ende, raporti aktual është bazuar kyesisht mbi kontributet e dhëna në zonat e projektit. Raporti lejon një rishikim për një periudhë 3 vjecare mbi situatën e krimit të organizuar dhe krimit ekonomik dhe do t'i paraqitet Shefave të Policisë nga Evropa Juglindore në takimin rajonal në Beograd (Serbi) më 20 qershor 2007.

Për të shmangur mbivendosjen, profilet e zonave të projektit u shqyrtuan me vëmendje dhe iu dërguan homologëve përkatës, por nuk u përfshinë në këtë raport.

Përderi sa në këtë etapë të hershme, pjesa më e madhe e organizatave të policisë, strukturave, iniciativave ndërqeveritare dhe OJQ-ve nuk i kanë botuar ende raportet e tyre të reja, ky raport i ri i përditësuar është bazuar kryesisht në kontributet e përgatitura nga zonat e projektit, në vijimësi të një pyetësori të përditësuar, i cili kërkonte më shumë të dhëna statistikore.

Përgjigjet dëshmojnë për disa përmirësime në raportimin e krimit dhe analizat kombëtare dhe lejojnë bërjen e krahasimeve në një periudhë 3 vjecare për të parë zhvillimin e kapaciteteve si të kriminelëve dhe të zbatimit të ligjit gjatë kohëzgjatjes së projektit rajonal CARDS:

- Kapitulli i parë trajton gjetjet themelore dhe rekomandimet në formën e një përmbledhjeje ekzekutive;
- Kapitulli i dytë ofron një vështrim të përgjithshëm të kuadrit në të cilin ky raport u përpunua, sfondin dhe qëllimin e hartimit të tij, konceptin e përgjithshëm të krimit të organizuar dhe një përshkrim të shkurtër të krimit të organizuar dhe të tipareve të tij më të spikatura;
- Kapitulli i tretë analizon një numër zonash, të cilat gjykohet si të rendësishme për zonat e projektit për të identifikuar zhvillimet përkatëse gjatë tre viteve të fundit dhe tendecat e raportuara nga zonat e projektit;
- Kapitulli i katërt dhe i fundit e mbyll raportin dhe jep disa rekomandime që mund të jenë me vlerë, për intensifikimin e përpjekjeve në luftë kundër krimit të organizuar dhe krimit ekonomik.

Në vijim të synimit të saj për të krijuar një zonë lirie, sigurie dhe drejtësie, BE-ja tashmë është përqëndruar fuqishëm dhe në çështje të zbatimit të ligjit në Evropën juglindore dhe i ka vënë detyrë strukturave të saj që të bashkëpunojnë ngushtë me agjencitë kombëtare të zbatimit të ligjit dhe strukturat rajonale, si për shembull me Iniciativat e Paktit të Stabilitetit, SECI-in dhe Bashkëpunimin Ekonomik të Detit të Zi. Si rezultat, ky raport do të trajtojë informacionin dhe sfidat në policimin ndërkombëtar dhe aspektet përkatëse të BE-së.

Evropa Juglindore ka vecantitë e saj në lidhje me sfidat e politikës dhe qeverisjes si për shembull luftën në vendet e ish Jugosllavisë, sanksionet ndërkombëtare kundër Serbisë, rënien e shtetit shqiptar në vitet '90, pavarësinë e Malit të Zi në 2006-ën, marrëdhënien e Serbisë me BE-në dhe diskutimet e vazhdueshme për statusin e ardhshëm të Kosovës. Gjithësi, elementët kyce të mjedisit qeveritar dhe ekonomik nuk kanë ndryshuar shumë; figura të reja të asimetrive ekonomike zor se ekzistojnë.

Informacion mbështetës për këto tema jepet në detaje në raportin e situatës së 2006-ës për krimin e organizuar dhe krimin ekonomik në Evropën Juglindore dhe mund të sudiohet më tej në këtë raport.

⁸ Psh Europol, Eurojust, Frontex, EMCDDA, PAMECA, UNMIK, Qendra SECI, por edhe Interpol, ICTY, UNODC dhe struktura të tjera të Kombeve të Bashkuara.

⁹ Raporti i vitit 2006 dhe 2007 u përgatitën nga Z Uwe G. Kranz (konsulent, Gjermani)

Shpresohet që ky raport të shërbejë si bazë ose model për raportte të tjera mbi krimin e organizuar dhe krimin ekonomik në të ardhmen në Evropën Juglindore, të hartuar çdo vit nga vetë zonat e projektit ose me ndihmën e BE-së, ose organizatave të tjera evropiane apo ndërkombëtare. Gjithsesi, kjo dihet të lidhet ngushtë me procesin e Europolit për hartimin e raporteve të tij specifike mbi krimin dhe me "Vlerësimin e Kërcënimit të Krimin të Organizuar në BE (OCTA)".

2.2 KRIMI I ORGANIZUAR DHE TIPARET E TIJ DALLUESE

Krimi i organizuar dhe forma të tjera të krimit ekonomik dhe krimeve të rënda ka të ngjarë të mbeten përparësi të shoqërive evropiane, në vecanti në vendet në tranzicion, si për shembull në vendet e Evropës Juglindore.

Në përgjithësi duhet të theksohet se ka shumë shoqëri të organizuara kriminale në Evropë¹⁰.

KONCEPTI I KRIMIT TË ORGANIZUAR¹¹

Koncepti i vjetër i një grupi kriminal hierarkik dhe të ngurtë (grup kriminal i organizuar) ka ndryshuar në një koncept sipërmarrës të krimit të organizuar nga struktura të forta hierarkie në rrjete të lirshme dhe fluide, duke e shtrirë fushën e tyre të aktiviteteve përtej llojeve dhe kufijve, duke shfrytëzuar bizneset ligjore për të legjitimuar aktivitetet e tyre kriminale dhe duke përdorur teknologji të lartë, në vecanti për të vulosur komunikimin e tyre. Grupet e krimit të organizuar ndryshojnë nga origjina, përmasa, sfera e specifikimit dhe disa parametra të tjerë, krijojnë marrëdhënie shumë elastike, dhe komplekse ndërkombëtare dhe gjithnjë e më tepër duket se përziejnë aktivitete me rrezikshmëri të ulët me aktivitete me rrezikshmëri të lartë. Gjithnjë e më tepër krimi i organizuar po bëhet i padukshëm dhe shpesh është i lidhur me bizneset e ligjshme.

Gjithsesi, vlerësimet e numrit të grupeve të krimeve të organizuara në Evropën Juglindore mbeten të vështira për t'u bërë pjesërisht për shkak të mbledhjes së rregullt të të dhënave, statistikave ose sistemeve të raportimit.

Në përgjithësi, duket se grupet e krimit të organizuar si organizata kriminale shumë-funksionale, kanë lidhje të fuqishme në rajon dhe në disa raste edhe me shtete të BE-së. Gjithsesi, etnia ekskluzive po bëhet gjithnjë e më pak domethënëse. Edhe grupet shqiptare të krimit të organizuar kanë krijuar marrëdhënie të ngushta me grupet kriminale nga Turqia, Maqedonia, Serbia apo vende të tjera. Shumë grupe të krimit të organizuar karakterizohen si "fluide", "të rrafshata", "të strukturuar në formë celulash", dhe "të ngjashme me rrjetin".

NUMRI I GRUPEVE, PADIVE DHE AUTOREVE

Duke pasur parasysh të dhënat, kohën dhe zonat e krimit të raportuara nga zonat e projektit është e vështirë që të jepet një numër i përgjithshëm për grupet e krimit të organizuar, veprat penale dhe kriminelët (të dhëna që lidhen me krimin e organizuar në disa zona raportohen e në disa të tjera jo; ndonjëherë jepen statistika specifike për krimin e organizuar, herë të tjera statistikat përmendin të gjitha krimet; disa herë numri i kriminelëve raportohet vetëm për disa zona krimi e jo në të tëra zonat; disa zona të projektit paraqesin të dhëna për grupet e krimit të organizuar, disa të tjera jo, disa zona të projektit raportojnë vetëm të dhënat e policisë, ndërsa të tjera përfshijnë të dhëna nga policia tatimore dhe kufitare dhe informacionin që jepet nga autoritetet gjyqësore, etj.).

Sipas përgjigjeve të pyetësorit të vitit të kaluar, një vlerësim konservator do të ishte që të gjitha zonat e projektit kanë hetuar në 2005-ën të paktën 200 deri në 300 grupe të krimit të organizuar. Për shkak se grupe të tilla ndryshojnë në lidhje me numrin e kriminelëve (raportimet shkojnë nga 3 deri në 20 vetë), numri i kriminelëve të përfshirë në krimet e organizuara mund të shkojë nga **2,000 deri në 3,000**.

Bazuar në përgjigjet e pyetësorit të këtij viti (megjithëse numri i grupeve të krimit të organizuar nuk është raportuar gjithnjë): në 2006-ën, Shqipëria, Kroacia, Mali i Zi dhe Serbia kanë hetuar vecmas rreth 3,500 çështje dhe **më tepër se 4,000 autorë krimesh**, çfarë do të thotë që në të gjitha zonat e

¹⁰ Vlerësimi i Kërcënimit të Krimit të Organizuar në Bashkimin Evropian-- (OCTA) 2006, <http://www.europol.europa.eu/>

¹¹ Më tepër informacion mund të gjeni në shtojcën që i është bashkëngjitur këtij raport

projektit numri i kriminelëve aktivë është shumë më i madh dhe është rritur me më shumë se 50% krahasuar me shifrat e raportuara në vitin 2005. Kjo dëshmon gjithashtu se numri i grupeve të krimit të organizuar në 2006-në mund të variojë nga 400 deri në 500.

Duke marrë parasysh dobësitë e përgjithshme të sistemit të lartpërmendur të raportimit dhe faktin se shifrat e raportuara për lloje të caktuara të krimeve “të zakonshme” kryhen zakonisht nga grupet e krimit të organizuar (migracioni i paligjshëm, trafikimi i drogës, fabrikimi i parave, etj.) dhe nuk përkojnë me raportimet statistikore të raportuara për krimet e organizuara, ka të ngjarë që shifrat reale të grupeve të krimit të organizuar, veprave penale dhe kriminelëve të jenë shumë më të larta. Në përmbledhje, duket sikur zbatimi i ligjit qartësoi disa çështje dhe bëri të mundur dënimin e më shumë kriminelëve, por ka cuar në zbulimin e më pak grupeve të krimit të organizuar.

DHUNA DHE KËRCËNIMI

Dhuna dhe kërcënimet vazhdojnë të përdoren si modus operandi tipik por gjithnjë e më shumë në një mënyrë më të përlogaritur dhe të kujdesshme. Frikësimi dhe dhuna kundër viktimave janë element i pandashëm i grabitjes, shantazhit dhe gjobëvënies. Këto janë gjithashtu metoda tepër të përhapura në tregun e drogës, si një mjet për zgjidhjen e pretendimeve ndërmjet grupeve rivale. Dhuna përdoret për të shtrënguar disiplinën brenda vetë grupit të krimit të organizuar, ose kundër grupeve konkurruese. Grupet shqiptare janë ndër më të dhunshmet në këtë drejtim (përmenden dhe vrasje me pagesë në sferën e krimit ekonomik), megjithëse aktivitete të dhunshme janë vërejtur edhe në Bosnjë Hercegovinë dhe në Serbi. Në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore dhe shfrytëzimin e individëve, është e qartë se dhuna është zëvendësuar nga metoda alternative për të garantuar bashkëpunimin e viktimave, të tilla si presionet psikologjike kundër familjarëve të tyre që gjenden në vendet e origjinës, martesë të detyruara, ofrimi i një pagese modeste dhe kushteve më të mira për jetesë, ashtu sic praktikohet nga trafikantët në Bosnjë Hercegovinë dhe në Kosovë.

PRAKTIKAT MASKUESE

Praktikat maskuese janë bërë një modus operandi i rendësishëm i përdorur nga grupet e krimit të organizuar. Praktikat më të shpeshta maskuese synohen të identifikojnë anëtarët e mundshëm të grupit, për të korruptuar zyrtarët e organeve të zbatimit të ligjit për të marrë informacion për masat hetuese të agjensive të zbatimit të ligjit dhe për të mbrojtur të gjitha llojet e komunikimeve ndërmjet kriminelëve; psh komunikimet GATEWAY që përdoren gjerësisht, telefonat celularë me kartë të ndërrueshme SIM, sikurse dhe mjete të tjera komunikimi të zëvendësueshme, të cilat i ndryshojnë shpesh, si dhe mesazhe gojore ose të shkruara të koduara, kodimin e të dhënave, kundër-survejimi, etj.

3 AKTIVITETET KRIMINALE

3.1 TRAFIKIMI I DROGAVE

Raporti¹² Botëror i Drogës së UNDOC-së për vitin 2006, dhe Qendra e Monitorimit Evropian për Drogat dhe Narkomaninë në nivel evropian (EMCDDA)¹³ nxjerrin në pah disa elemente të dobëta në sistemin global të kontrollit të drogës, në më të shumtën furnizimin me heroinë nga Afganistani, kërkesën për kokainë në Europë, dhe furnizimin/kërkesën për kanabis gjatë. Europa që po zgjerohet, duket se përbën tregun më fitimprurës të drogës në botë. Afërsia ndaj një tregu të tillë, krijimi i 'Rrugëve të Ballkanit' dhe konfiskimet në rritje të drogave nga organet e zbatimit të ligjit në zonat e projektit tregojnë se nga njëra anë shkalla e madhe e prodhimit dhe trafikimit të drogave mbeten format më të hasura të krimit në rrjetet kriminale. Nga ana tjetër, ka rreth 40 milionë njerëz, shumica të rinj, në vendet europiane të cilët kanë përjetuar përvoja të përdorimit të drogave kohët e fundit, dhe që përfaqësojnë një treg tejet të madh të kërkesës për drogë, i cili po rritet gjithnjë e më tepër në Evropën Juglindore.

Pas kaq shumë vitesh përvoja në kontrollin e drogës në planin botëror dhe më specifikisht në nivelin e BE-së, duhet se vetëm një strategji koherente dhe afatgjatë mund të ulë ofertën, kërkesën dhe trafikimin e drogës. Si rezultat, është me shumë rëndësi që zonat e projektit të zbatohen në nivel kombëtar dhe rajonal politika të zbatimit të ligjit që janë provuar në nivel ndërkombëtar, si ato të identifikuar në sistemin ndërkombëtar të kontrollit të drogave, i cili përfshihet në të tri Konventat¹⁴ e Kombeve të Bashkuara për Grogën, dy Strategjitë e BE-së dhe Planet Përkatëse të Veprimeve mbi Drogat¹⁵ dhe Planin e Përbashkët të Veprimit për Drogat ndërmjet BE-së dhe Ballkanit, i miratuar nga Këshilli i BE-së në qershor 2003 në mënyrë që të krijohet një bashkëpunim i ngushtë ndërmjet vendeve të rajonit dhe në mbarë Evropën. Strategji të ngjashme kombëtare kundër drogës dhe plane përkatëse veprimi janë krijuar në të gjitha zonat e projektit, të cilat kanë amenduar dhe kuadrin kombëtar të legjislacionit dhe kanë përcaktuar struktura të forta organizative dhe metoda pune për të trajtuar këto fenomene krimi. Nga të gjitha zonat e krimit, sistemi i raportimit që ka të bëjë me drogat është sistemi që funksionon më mirë.

Trafikimi i drogave përfshin grupet kriminale të organizuara lokale të përbëra nga shtetas të vendeve të burimit apo të tranzitimit. Megjithatë, projektet zonale raportojnë në mënyrë të zgjeruar lidhjet e ngushta midis grupeve vendore dhe jo-vendore të krimit të organizuar, si në transportimin dhe shpërndarjen e drogave, si dhe përfshirjen gjithnjë e më shumë të tyre në trafikimin e drogës në kuadrin e "trafikimit të shumë drogave" ku ngarkesat njihen si "ngarkesat koktejl", dhe që përfshijnë perkursorët, drogat kimike dhe sintetike.

Në të shkuarën pjesa më e madhe e zonave të projektit dukeshin sikur ishin vetëm vende tranzit. Ndërkohë, hetimet dhe sekuestrimet e sasive të drogës tregojnë qartë se tregjet e konsumit të brendshëm po rriten, në vecanti në lidhje me drogat sintetike (Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova dhe Serbia), produktet e kanabisit (pothuajse në të gjitha zonat e projektit), kokaina (Kroaci, Kosovë) dhe heroina (Shqipëri, Kosovë, Serbi).

¹² Raporti Botëror i Drogave të UNODC World 2006; Vetëm tre vende nga Evropa Juglindore (Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia) i kanë dërguar të dhëna UNODC).

¹³ Qendra Evropiane e Monitorimit të Drogave dhe Narkomanisë (EMCDDA), Raport Vjetor 2005.

¹⁴ Këto janë Konventat e Vetme për Drogat (1961), the Konventa e Substancave Psikotropike (1971) dhe Konventa kundër Trafikimit të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Substancave Psikotropike (1988).

¹⁵ Strategjia e BE-së 2000 - 2004 (e miratuar nga Këshilli i BE-së, Dokumenti 9283/00, CORDROGUE 32, Bruksel, 7. qershor 2000) dhe Planet e Veprimit të BE-së për Drogën (200-2004), të miratuara nga Komisioni Evropian, Dokumenti COM(2001) 301; Strategjia e BE-së 2005-2012 (e miratuar nga Këshilli i BE-së, Dokumenti 15074/04, CORDROGUE 77, Bruksel, 16.-17. dhjetor 2004 dhe Planet Përkatëse të Veprimeve të Drogës (2005-2008), të miratuara nga Komisioni Evropian, në qershor 2005 (CORDROGUE 25) dhe Planet Pasardhëse të Veprimeve për Drogat (2009-2012).

3.1.1 Stimuluesit e llojit të amfetaminës (ATS)

Grupi i stimuluesve të llojit të amfetaminës (ATS) përfshin amfetaminat (amfetaminën, metamfetaminën), ecstasy (MDMA dhe substancat që lidhen me të), dhe stimulantë të tjerë sintetikë (metkatinoninën, fenterminën, fenetilinën, etj...). Stimulantët e llojit të amfetaminës prodhohen më së tepërmi në Kinë, Mianmar dhe Filipine, por edhe në Poloni. Prodhimi global i stimuluesve të llojit të amfetaminës është për momentin afër 480 tonë metrikë¹⁶, tri të katërtat e së cilës janë ose metamfetaminë ose amfetaminë, dhe një e katërta e së cilës është 'ecstasy'. Procesi i prodhimit, që përfshin blerjen e kimikateve, sintetizimin, kthimin në formë tablete, paketimin dhe hedhjen e mbeturinave, është pandryshueshmërisht i ndarë mes vendeve të ndryshme, duke përfshirë shpesh bashkëpunimin ndërmjet grupeve kriminale që operojnë në zonat kufitare. Prodhimi i amfetaminës dhe "ecstasy" raportohet në të gjithë Evropën në nivele të ndryshme. Rritja në mënyrë të vazhdueshme e konfiskimeve në BE gjatë vitit 2004 dhe 2005 të dërgesave të amfetaminës deri në 500 500 kg¹⁷ (konfiskimet më të fundit në Serbi), tregojnë një zgjerim të këtij tregu dhe në Evropën Juglindore dhe rritje të prodhimit të amfetaminës.

Prodhimi i konsiderueshëm i amfetaminës në Evropë vazhdon të jetë gjerësisht i kufizuar në Republikën Çeke dhe në një nivel më të ulët në Republikën Sllovaqe, një pjesë të Shteteve Balltike dhe Moldovë. Një numër i madh cmontimesh të laboratorëve për prodhimin e amfetaminës janë raportuar për Republikën Çeke gjatë dekadës së fundit, duke e cuar numrin e tyre nga 188 në 2003-n në 248 në 2004-ën. Një numër i madh cmontimesh të laboratorëve të prodhimit të amfetaminës janë raportuar dhe për Moldavinë (136 në 2004), e ndjekur nga Republika Sllovaqe (nga 3 në 2003-in në 12 në 2004-ën). Holanda, Polonia dhe Belgjika pasohen nga Estonia, Bullgaria dhe Gjermania dhe citohen si burimet kryesor etë amfetaminës. Numri i laboratorëve të amfetaminës të zbuluar në Evropën perëndimore dhe Qëndrore u rrit mesatarisht nga 25 në vitet 1995-99 në 35 gjatë periudhës 2000-2004 (47 në 2004), ndërkohë që ato përbënin 77 përqind të laboratorëve të tillë në të gjithë botën për periudhën 2002-2004. Kjo përqindje ka qenë dhe më e lartë në Evropën Lindore (Bjellorusi, Moldavi, Rusi dhe Ukrainë) ku zbulimet e laboratorëve të prodhimit të amfetaminës u rritën nga mesatarisht 11 në periudhën 1995-99 në 94 në periudhën 2000-2004 (141 në 2004)¹⁸.

Në nivel botëror konfiskimet e raportuara të ecstasy janë rritur me 87% në 2004, dhe kanë arritur një rekord të ri prej 8 kilogramësh të shprehur në ekuivalencë, nga të cilët 51% u konfiskuan në Europë, duke tejkaluar edhe shifrat maksimale të shënuara në 2002 me 20%. Rëndësia e Hollandës dhe Belgjikës, vendet tradicionale burimore të ecstasy, duket se ka rënë, meqenëse prodhimi në vende të tjera evropiane po rritet¹⁹.

Këto të dhëna bashkë me konfiskimet e kohëve të fundit tregojnë se ka një zhvendosje graduale të prodhimit të amfetaminës drejt Europës Lindore dhe Juglindore. Duke pasur parasysh shpërndarjen e përdorimit të matamfetaminës, pëdorimi i saj në Evropën Juglindore nuk mund të neglizhohet dhe mbetet një zonë e rëndësishme vigjilence²⁰ pasi të dhënat tregojnë se:

Shqipëria deklaroi se drogat sintetike nuk përbëjnë problem për të. Gjatë periudhës 2004–2006 nuk janë raportuar masa të mëdha (në përjashtim të 10 pilulave që zotëroheshin nga një i pandehur në 2004-ën), por në 2005-në përmenden dy hetime, pas konfiskimit të shumave të konsiderueshme të efedreines nga Kina dhe Mbretëria e Bashkuar.

Bosnja dhe Hercegovina për 2005-2006-ën raportojnë sekuestrimin e vetëm 7.2 kg amfetaminë dhe një treg në rritje i përdorimit të brendshëm (nuk ka të dhëna të disponueshme për 2004-ën).

¹⁶ UNODC, Raporti Botëror i Drogave 2006

¹⁷ Raporti i Drogave të Europol-it 2006.

¹⁸ UNODC, Raporti Botëror i Drogave 2006.

¹⁹ UNODC, Raporti Botëror i Drogave 2006.

²⁰ Kjo duhet të shihet në përputhje me raportin e fundit të Ministrisë së Brendshme të Republikës Srpska (Bosnjë dhe Hercegovinë) që thotë se "sasi të imptuara të substancave të synuara për prodhim industrial i tejkalojnë nevojat industriale, dhe nuk janë të pakta rastet kur bëhet trafikimi i tyre"

Kroacia raporton gjithashtu një treg në rritje të përdoruesve të drogave sintetike dhe mënyra më agresive furnizimi duke rritur “trafikimin mbrapsht” (nga juglindja/lindja në perëndim). Në vitet 2004-2006, Kroacia konfiskoi në total 31.1 kg amfetaminë (me ndryshime të vogla me kalimin e viteve), 77,000 pjesë ecstasy (në 2006-ën, ulja e konfiskimit ishte 50 përqind) dhe rreth 100 doza LSD (rreth 60 përqind në 2006-ën).

Kosova raporton për një treg të brendshëm për amfetaminën, por nuk jep informacione të tjera për domethënien e saj. Gjithsesi, Kosova raportoi konfiskimin e 25.0 kg amfetaminë në 2006-ën dhe 25.12 kg më tepër në periudhën 2004-2005. Konfiskimet e ecstasy u rritën shumë në 2006 (189 pjesë) krahasuar me 56 copëza ecstasy në 2004-ën dhe 39 copëza në 2005-ën. LSD nuk u raportua në këtë periudhë kohore.

Mali i Zi ka shumë pak informacion në lidhje me drogat sintetike dhe në 2006-ën ka kapur vetëm pak pjesëza ecstasy.

Serbia raporton tregun më të fuqishëm të drogave sintetike. Gjatë viteve 2004-2006 konfiskimet janë rritur në mënyrë konstante, si për shembull amfetamina me 33.5 kg (më tepër se 75 përqind më shumë sesa shuma e sekuestruar në 2006-ën) dhe ecstasy afër 36,000 pjesëzave (53 përqind të sekuestruara në 2006-ën). Konfiskimet e LSD-së, të cilat u rritën nga 102 doza në 2004-ën në 1,013 doza në 2005-ën nuk u raportuan në 2006-ën. Për më tepër, në 2005-ën policia zbuloi një tregëti me perkursorët kimikë të importuar nga Franca, Republika Çeke dhe Rumania, të cilët u kontrabanduan më pas në Bullgari dhe Turqi dhe u zbuluan disa laboratorë të paligjshëm për prodhimin e ecstasy si dhe u sekuestruan 2 milionë pilula ecstasy si dhe 2 tonë acidë.

“**Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë**” ka sekuestruar amfetaminë në sasi shumë të vogël (2005: 1.8 kg) dhe deri në 4,200 pilula ecstasy për periudhën e raportimit (2005-2006) dhe shuma më të vogla të narkotikëve të tjerë të ndryshëm (metadonit, prokainës, kafeinës, paracetamolit, etj.).

3.1.2 Produktet e Kanabisit

Prodhimi i kanabisit përbëhet kryesisht nga tre produkte të ndryshme: kanabisi bimor (marihuana), kanabisi në formë rrëshire (hashishi) dhe vaji i kanabisit.

Prodhimi global i kanabisit ka ardhur duke u rritur dhe përllëgaritet në 45,000 tonë²¹ metrikë. Si përllëgaritet e numrit të konsumatorëve të kanabisit në botë, ashtu edhe sasi të konfiskuara të kanabisit nga agjensitë e zbatimit të ligjit, janë rritur gjatë dekadës së kaluar. Europa përbën tregun më të madh të botës për kanabisin në formë rrëshire, që numëron për më shumë se 70% të konfiskimeve të këtylla për vitin 2004. Gjatë periudhës 2002-2004, Shtetet Anëtare cituan Marokun si vendin²² kryesor burimor, të pasuar nga Pakistani dhe Afganistani. Vende të tjera të cituara si burime të rëndësishme të kanabisit në formë rrëshire janë Shqipëria dhe Holanda.

Sipas EMCDDA, të dhënat mbi konfiskimet e kanabisit në formë rrëshire dhe konsumit sugjerojnë se tendenca afatgjatë është drejt rritjes së prodhimit botëror në 50,000 – 55,00 tonë metrikë (bazuar në faktin se 3 milionë njerëz, kryesisht meshkuj të rinj, përdorin kanabis në bazë ditore në Evropë).

Për më tepër, sipas sondazheve në Kanada, SHBA, Hollandë dhe EMCDDA, për shembull, potencia e produkteve të kanabisit dhe përmbajtja mesatare e THC²³ është rritur²⁴ në mënyrë të ndjeshme.

²¹ Raporti Botëror i Drogave i UNODC 2006

²² Sipas raportit të EMCDDA të vitit 2005, Spanja, Italia, Danimarka, Finlanda dhe Irlanda raportuan se pothuajse i gjitha kanabisi në formë rrëshire vjen nga Maroku, Sipas Europol, Moroku vazhdon që të furnizojë me më shumë se 80% të konsumit të kanabisit në formë rrëshirë në Evropë (2005 Raporti i BE-së për Krimin e Organizuar)

²³ Tetrahydrokanabinol (THC), përbërësi kryesor aktiv.

²⁴ Në vitin 2003, në vendet nga të cilat kemi të dhëna, kanabisi në formë rrëshire u raportua se kishte një përqindje mesatare THC-je që ndryshonte nga më pak se 1 përqind (Poloni) deri në 25 përqind (Republika Sllovaqe), ndërsa potencia e kanabisit bimor shkon nga 1 % (Hungari, Finlandë) deri në 20 % (prodhim i rritur vetë në Hollandë) dhe madje dhe në 25 % (Republika Sllovaqe). Vetëm Mali i Zi raportoi se kanabisi që vjen nga Shqipëri “është i një cilësie të lartë (shkallë e lartë e THC)”, nuk është dhënë informacion tjetër.

Si rezultat, ka një shqetësim në rritje në Evropë, në tregun më të madh botëror të kanabisit në formë rrëshire ku cdo vit gjenerohen rreth 10 miliardë euro, për ndikimin negativ të përdorimit të kanabisit.

Prodhimi i kanabisit bimor (marihuanës), është gjithashtu shumë i shpërndarë dhe pjesa më e madhe e zonave të projektit raportojnë për raste të kultivimit të kanabisit (në përjashtim të Serbisë dhe Malit të Zi). Në total, në zonat e projektit janë shkatërruar gjatë kësaj periudhe kohe më shumë se 614,000 rrënjë.

Shqipëria vazhdon të jetë i vetmi vend në rajon që ende prodhon produkte kanabisi në masë për eksport (hashash, marijuanë dhe vaj hashashi). Ndërsa qeveria i dha përparësi kryesore luftës kundër prodhimit dhe trafikimit të drogave, rezultate të dalluara u arritën në shkatërrimin e zonave të mbjella me kanabis (2004: 74,000 bimë; 2005: 333,000 bimë; 2006: 74,052 bimë), dhe me lule opiumi (2004: 695, 2006: 580). Kriminelët akoma nuk kanë filluar të përdorin teknikat serë në Shqipëri. Vetëm pak zona kultivimi njihen ende në rajonet e Vlorës, Gjirokastrës, Shkrodrës dhe Fierit, ku zonat e kultivuara janë të fshehura në male dhe pyje, duke e komplikuar kështu shumë zbulimin dhe marrjen e masave të duhura të zhdukjes së tyre.

Bosnja dhe Hercegovica në 2005-ën shkatërroi rreth 2,000 rrënjë kanabis dhe në 2006-ën deri në 10,000 rrënjë kanabis.

Kroacia raportoi për 2006-ën se ka shkatërruar një masë më të vogël të rrënjëve të kanabisit (rreth 2,700).

Kosova vazhdon aktivitetet pasuese. Në 2004-ën: Shërbimet Policore të Kosovës dhe UNMIK shkatërruan rreth 12 fusha të mbjella me kanabis (rreth 8,000 rrënjë), në 2005-ën shifra u rrit në më shumë se 31,500 rrënjë kanabis dhe në 2006-ën, Kosova raportoi shkatërrimin e më shumë se 75,800 rrënjëve kanabis.

“Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë” shkatërroi rreth 3,077 bimë në 2005-ën dhe 545 rrënjë në 2006-ën. Nuk ka më informacion të disponueshëm për këtë vend.

Gjithsesi, zonat e projektit janë më shumë vendne tranzite përgjatë Rrugëve të Ballkanit dhe nëpërmjet porteve të tyre. **Importi i marihuanës** organizohet kryesisht nga grupet e organizuara kriminale nga Kolumbia, Xhamaika, Afrika e Jugut, Nigeria dhe gjithnjë e më shumë nga Shqipëria, e cila është kthyer në një furnizues kryesor të kanabisit bimor.

Marihuana arrin kryesisht me rrugë detare nëpër portet italiane, sllovene, shqiptare dhe kroate, dhe mendohet se dhe në portet malazese (të ngarkuara në kamionë dhe kontenierë) prej ku, kryesisht nëpërmjet kamionëve, vazhdojnë rrugën nëpër zonat e projekteve si në Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Serbi, “Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe vendet e Evropës perëndimore. Vendet e destinacionit të hashashit dhe marihuanës së prodhuar në Shqipëri, janë kryesisht Greqia dhe Italia, por ka pasur raporte të trafikimit në Kosovë, Malin e Zi, “ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë”, dhe në disa raste të pakta, edhe në Shtetet Anëtare të BE-së, në shkëmbim të heroinës.

Konfiskimi i produkteve të kanabisit, kryesisht të marihuanës, në zonat e projektit është rritur shumë gjatë periudhës 2004-2006:

Shqipëria, e cila nuk bën dallim ndërmjet hashashit dhe marihuanës raporton për një rritje të qëndrueshme të konfiskimeve (4,544 kg në 2004-ën, 6,332 kg në 2005-ën dhe 6,754 kg në 2006-ën, kohë në të cilën u konfiskuar dhe një sasi e vogël vaji hashashi).

Bosnja dhe Hercegovina raporton vetëm konfiskime në shuma të vogla të hashashit në 2005-ën (rreth 12 kg), por shifra e raportuar për 2006-ën është më e lartë se 137. Konfiskimet e marihuanës qenë konstante në 2005-ën (rreth 318 kg) dhe 2006-ën (rreth 336 kg). Nuk ka informacion tjetër të disponueshëm.

Kroacia raporton vetëm sekuestrime në masë të vogël të hashashit gjatë periudhës 2004-2006 (6 kg, 54 kg dhe 13 kg), por konfiskime më të mëdha të marihuanës (428 kg, 938 kg dhe 202 kg). Duke krahasuar shifrat e pakonsiderueshme dhe të ulta në deklaratën e Kroacisë në 2005-ën, fakti që marihuana vjen drejtpërsëdrejti nga prodhues të mëdhenj nga vendet e Amerikës së Jugut në portet e detit Kroat duhet të vihen në pikëpyetje.

Kosova ka kapur vetëm sasi të vogël hashashi në 2004-ën (në total rreth 1.2 kg), por në 2006-ën sasia u ul në 0.38 kg. Një zhvillim i tillë është i dukshëm tek marihuana, ku në 2004-ën dhe në 2005-ën u sekuestruan në total 78.5, por 66.64 kg u raportuan për 2006-ën, dhe fatkeqësisht nuk u dhanë shpjegime të mëtejshme shpjeguese.

Mali Zi raportoi për 2005-ën kapjen e vetëm 10.5 kg hashashi dhe në 2006-ën nuk u raportua asnjë sekuestrim. Gjithsesi konfiskimet e marijuanës u rritën nga 367.5 kg në 1,114 kg, të cilat konsiderohen të një cilësie të lartë (përqëndrim i lartë i THC-së; nuk ka informacion tjetër të disponueshëm për këtë përqindje).

Serbia duke sikur është më e prekura nga produktet e kanabisit dhe ka sekuestruar gjatë kësaj periudhe kohe një sasi të madhe e në rritje hashashi: 3,350 kg in 2004, 8,020 kg në 2005-ën dhe 60,355 kg në 2006-ën. Një zhvillim i tillë mund të shihet në konfiskimin e marihuanës: 3,901.9 kg në 2004-ën, 1,142 kg në 2005-ën dhe 1,817.3 kg në 2006-ën.

“**Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë**» paraqiti të dhëna nga administrata doganore dhe policia. Të dy institucionet së bashku në 1006-ën sekuestruan në total 640 kg marihuanë, dhe Ministria e Brendshme raportoi për 2005-ën një shtesë prej 203 kg (nuk ka informacion të mëtejshëm nga administrata doganore). Sic dëshmohe nga rastet studimore, 75 përqind e marihuanës së konfiskuar nga policia në 2006-ën u sekuestrua në tri hetimet mbi trafikimin e marihuanës nga Shqipëria. Hashashi duket sikur luan një rol të vogël, pasi vetëm 3.3 kg janë raportuar se janë sekuestruar gjatë periudhës së raportimit (2005-2006).

Ashtu sic u tha – përse i përket kërkesës Evropa është mbase tregu me më fitim i kanabisit në botë. Aftërsia me një treg të tillë dhe rëndësia e “Rrugëve të Ballkanit” dëshmojnë se trafikimi i drogës duhet të vazhdojë të jetë në vëmendje të agjensive të zbatimit të ligjit në të ardhmen, dhe kërkon mbrojtje dhe analizim të saktë të të dhënave.

3.1.3 Kultivimi i luleve të opiumit dhe prodhimi i paligjshëm i heroinës

Në vitin 2005, ekspertët kanë vënë re disa zhvillime pozitive: zona e përgjithshme e përdorur për kultivimin e luleve të opiumit është zvogëluar në tre vendet²⁵ kryesore të origjinës ashtu siç është zvogëluar edhe prodhimi global i opiumit, ndërkohë që konfiskimet globale të opiateve (heroinës, morfinës dhe opiumit) u rritën, veçanërisht në Europën Juglindore. Në rang botëror, zona e përllogaritur nën kultivimin e paligjshëm të luleve të opiumit është vlerësuar në 4,620 tonë metrikë.

Kultivimi i luleve të opiumit vazhdon të shpërndahet në Afganistan, duke financuar aktivitetet e luftës së talebanëve dhe duke ofruar mbështetje për terroristët islamikë. Përpyekjet për kontrollimin e drogës nga komuniteti ndërkombëtar, nuk kanë qenë aq sa duhet të suksesshme. Rreth gjysëm milioni njerëz besohet që të jenë të përfshirë në këtë biznes në opiatet afgane, me një fitim të përllogaritur në 45 miliardë dollarë amerikanë në vit.

UNODC vlerëson se 72% e opiumit konvertohet në heroinë në Afganistan. Në 2005-ën janë prodhuar rreth 410 tonë metrikë heroinë, dhe pjesa kryesore është dërguar në Evropë dhe Rusi²⁶ dhe në 2006-ën do të jetë të paktën rreth 500 tonë metrikë. Rreth 10,000 tonë kimikatesh, duke përfshirë dhe 1,000 tonë anhidride acetike janë të nevojshme në këtë proces.

Agjensia e Kontrollimit të Drogës në Taxhikistan llogarit se në Afganistan²⁷ gjenden më shumë se 400 laboratore për prodhimin e heroinës. Pjesa më e madhe e sasisë së heroinës së konsumuar në Europë, është e bazuar në opiumin që vjen nga Afganistani, (90%), për të cilën “Rrugët e Ballkanit”, vazhdojnë të mbeten kanalet kryesore të trafikimit, të opiateve drejt BE-së. Trafikimi i heroinës drejt BE-së vazhdon të dominohet nga grupet kriminale turke dhe ato grupe të tjera të lidhura me to, kryesisht grupe²⁸ shqiptare të krimit të organizuar. Ndërsa pret që të transportohet më tej në Evropën Perëndimore, shpesh heroina ruhet në vendet përgjatë “Rrugëve Ballkanike”. Përdorimi i dyfishtë i

²⁵ Afganistan, Republika Demokratike Popullore e Myanmar dhe Lao (Lao PDR).

²⁶ Raporti Botëror i Drogave i UNODC 2006.

²⁷ Raporti Botëror i Drogave UNODC

²⁸ Në këtë kontekst shqiptarët konsiderohen si persona që i referohen kulturës, historisë, gjuhës, traditave, pavarësisht se ku jetojnë në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi, Serbi ose gjetkë.

“Rrugëve të Ballkanit’ për të kontrabanduar heroinë në BE dhe për të marrë ecstasy prej BE-së ia vlen që të theksohet²⁹.

Shqipëria është një ndër vendet më të rëndësishme tranzite për trafikimin e heroinës dhe shpërndarjes me shumicë nga Afganistani nëpërmjet Evropës Juglindore, duke mos përmendur shifrat në rritje ose ulje për trafikimin e heroinës (2004: 91 çështje me 152 autorë; 2005: 67 çështje me 116 autorë; 2006: 90 çështje me 196 autorë). Kriminelët shqiptarë importojnë heroinë në bashkëpunim me trafikantët turq, maqedonas dhe kosovarë. Në përgjithësi transporti organizohet me kamionë, autobuzë dhe makina nëpërmjet rrugëve tokësore, si për shembull rrugën Turqi-Bullgari-Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë-Shqipëri ose Turqi-Bullgari - Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë - Kosovë - Shqipëri. Pjesa më e madhe e heroinës përfundon në Greqi, Itali dhe drejt zonave të tjera të projektit në tregjet në veri të BE-së. Vetëm një pjesë e vogël heroine mbetet në Shqipëri për tregun e brendshëm në rritje. Për të gjithë kohën, Shqipëria raporton konfiskime mesatare të heroinës që shkojnë në rreth **317 kg** (2004: 165.0, 2005: 40.9 dhe 2006: 120.0 kg). Shqipëria është e vetmja zonë projekti që raporton shkatërrimin e bimëve të opiumit (2004: 695 dhe 2006: 580).

Konfiskimi i 34 tonëve acidi anhidrit, (një kimikat perkursor për heroinën), që u raportua nga **Bosnjë-Hercegovina** në vitin 2005, dëshmon për ekzistencën e një tregëtie të perkursorëve kimikë që përdoren për prodhimin e drogës në Europën Juglindore. Gjithsesi, të dhënat e krimit për trafikimin e heroinës janë në nivel të ulët dhe shkojnë në rreth **78 kg** (2005: 68.53 kg në 2006: 9.24 kg) gjatë periudhës së raportimit. Miratimi i “Strategjisë Kombëtare për Abuzimin me Drogat Narkotike” dhe krijimi i një “Komisioni të Pavarur Drogash” brenda Këshillit të Ministrave dhe krijimin e në “Komisioni të Pavarur për Drogën” vazhdojnë akoma të diskutohen dhe shpresohen të miratohen në 2007-ën.

Kroacia thekson pozicionin e saj gjeografik dhe “Rrugët Ballkanike” të cilat kalojnë përmes vendit, të cilat janë shumë të rëndësishme për trafikantët e heroinës. Kroacia raporton që grupet shqiptare të krimit të organizuar (nga Shqipëria dhe Ish Republika Jugosllave e Maqedoninë” të cilët bashkëpunojnë ngushtë me grupet e krimit të organizuar të Turqisë dominojnë në kontrabandimin e organizuar të heroinës. Gjithsesi, të dhënat e krimit për trafikimin e heroinës nuk janë raportuar (çështje, akuza, kriminelë), konfiskimet janë të ndryshme dhe gjatë periudhës së raportimit shuma në total shkon në rreth **163 kg** (2004: 114.4 kg, 2005: 27.1kg and 2006: 21.6 kg).

Në Kosovë heroina raportohet si droga më e pranishme. Konfiskimet në sasi të mëdha mund të realizohen nëpërmjet veprimeve të koordinuara ndërkombëtare, dhe nuk duhet harruar konfiskimi i 500.4 kg heroinë në Austri, Germani, Itali, Zvicër, Serbi, Bullgari dhe Shqipëri në lidhje me hetimet në Kosovë në 2004-ën. Të dhënat e krimit mbi trafikimin e heroinës nuk janë raportuar (çështje, akuza, kriminelë). Në total, Kosova ka sekuestruar gjatë kohës rreth **74.53 kg** (2004: 23.3 kg, 2005: 36.5 kg dhe 2006: 14.65 kg). Shërbimet amerikane të inteligjencës kanë informuar kohët e fundit për një shumë në rritje të opiumit të rritur në këtë zonë dhe kjo përbën një burim kryesor furnizimi për mjaft laboratorë kryesorë të heroinës të drejtuara nga Ushtria Clirimtare e Kosovës (KLA/UÇK: Ushtria Clirimtare e Kosovës), e cila ka funksionuar në zonën e Urosevacit në Kosovë, megjithëse është kuptuar se opiumi i papërpunuar mund të dërgohet në laboratorë nga ose nëpërmjet Turqisë (duke përfshirë mundësisht dhe ca opim të papërpunuar nga Afganistani)³⁰.

Mali i Zi ka raportuar se heroina në tregun vendas zakonisht përpunohet dhe përzihet me substanca të ndryshme. Të dhëna për trafikimin e heroinës nuk janë dhënë (çështje, akuza, të pandehur). Në periudhën e raportimit konfiskimet e Malit të Zi arriën në **22 kg** (2005: 17.6 kg dhe 2006: 4.0 kg).

Heroina është droga e dytë më shumë e gjendur në tregjet serbe; pjesa më e madhe e heroinës vjen nga Afganistani nëpërmjet Shqipërisë, Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Bullgarisë dhe Kosovës dhe ka si vend destinacioni Gjermaninë, Zvicrën, Spanjën, Mbretërinë e Bashkuar dhe vendet Skandinave. Rreth 10 përqind e heroinës mbetet në vend për konsumatorët vendas. Gjatë tre viteve të

²⁹ Raporti i Europol Drugs 2006.

³⁰ 25 tetor 2005, Këshilli Amerikan për Kosovën <http://www.savekosovo.org/default.asp?p=4&leader=0&sp=42>

fundit Serbia ka sekuestruar më shumë se **1,508 kg** heroinë (2004: 469.6 kg, 2005: 342 kg dhe 2006: 696.6 kg). E thënë me fjalë të tjera të gjithë vendet e projektit të marra së bashku kanë sekuestruar të njëjtën sasi sa ka sekuestruar Serbia në 2006-ën, cka përbën një rezultat të mirë dhe një shenjë të qartë të tregjeve të zhvilluara mirë të heroinës në Evropën Juglindore, kanale që funksionojnë mirë përmes zonave të projektit si dhe agjensi efikase serbe për zbatimin e ligjit.

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë e vlerëson sasinë e heroinës së konsumuar në vit në 300 kg. Të dhëna të krimit për trafikim heroinë nuk janë raportuar (çështje, akuza, kriminelë). Në total vendi gjatë periudhës së raportimit ka kapur rreth **245 kg** heroinë (2005: 69.3 kg dhe 2006: 151.9 kg – nga të cilat 147 kg janë sekuestruar në dy operacione në Pikën e Kontrollit të Kufirit të ‘Kafasanit’ dhe ‘Novo Selos’ dhe rreth 24 kg të tjera janë sekuestruar në administratën e doganave). ‘Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë’ është e vetmja zonë projekti e cila raporton kapjen e 3 kg opiumi në 2006-ën. Nuk janë zbuluar laboratorë për prodhim heroine.

Për t’a përmbledhur, gjatë tre viteve të fundit më shumë se 1,000,000 kg heroinë është transportuar nga Afganistani përmes Evropës Juglindore në Evropën Perëndimore. Konfiskimet e heroinës në zonat e projektit gjatë tre viteve të fundit u rritën në pak më pak se 2,500 kg; përgjatë “Rrugëve më të rëndësishme të Ballkanit” është konfiskuar jo më shumë se 0.25 përqind e heroinës së disponueshme.

Për më tepër, tregjet e brendshme të përdoruesve po rriten. Si pasojë e këtij zhvillimi, UNODC-ja, për herë të parë, ka përcaktuar vendet e Europë Juglindore në Raportin e saj Vjetor mbi Drogën për vitin 2006, duke i cilënuar këto vende me tendencë rritjeje në lidhje me abuzimin e heroinë dhe opiateve³¹. të tjera. Në mënyrë shumë të ngjashme me vendet evropiane, zona të projektit do të vazhdojnë të kenë probleme me heroinën më vonë dhe do të kenë një situatë më fluide, por aktualisht shërbimet e informimit janë akoma të fragmentarizuara dhe të varfëra. Ekspertët vlerësojnë se do të ketë të njëjta zhvillime si në vendet e Evropës perëndimore – të cilat kanë një rritje të kërkesës për heroinë dhe një mundësi rritje të kërkesës dhe ofertës.

3.1.4 KOKAINA

Kokaina prodhohet nga gjetet e kakaos të kultivuara në Amerikën Jugore. Zona në kultivimin e gjetheve të kakaos (159,600 hektarë) ka qenë përgjithësisht e qëndrueshme kryesisht gjatë vitit 2005 me një shifër prej 28% nën nivelet maksimale të shënuara gjatë vitit 2000 (221,300 hektarë). Shumica e kakaos vazhdon të kultivohet në Kolumbi (54%), më pas vjen Peruja (30%) dhe Bolivia (16%)³². Prodhimi global i kokainës arriti në 910 tonë metrikë 2005. Prodhimi potencial i kokainës në Peru arriti deri në 180 tonë metrikë në 2005 dhe deri në 90 tonë metrikë në Bolivi. Pothuajse 25 për qind e përdoruesve të kokainës në botë (më shumë se 3 milion njerëz) jetojnë në Evropën Perëndimore dhe Qendrore.

Megjithëse e destinuar kryesisht për tregun amerikano-verior, një sasi e konsiderueshme e kokainës trafikohet nga Amerika e Jugut për në Evropë përmes Oqeanit Atlantik, me anë të rrugëve ajrore apo detare, kryesisht nëpërmjet Spanjës dhe Hollandës, ndërkohë që kokaina vjen në Europën Juglindore përmes porteve të Detit Adriatik (në Greqi, Mal të Zi, Kroaci dhe Shqipëri). Trafikimi i kokainës nëpërmjet detit shpesh përfshin sasi më të mëdha (dhe cilësi më të mirë) të kësaj lënde. Transportet më të mëdha të kokainës kanë kryesisht karakter tranzit dhe transportohen me rrugë tokësore nga veriu dhe jugu nëpërmjet kamionëve, shpesh të paketuara në shishe dhe që i drejtohen tregjeve të BE-së. Sasi më të vogla kokaine kanë kryesisht një karakter tranzit, transportohen nëpërmjet rrugëve tokësore si nga jugu ashtu edhe nga veriu nëpërmjet kamionëve, shpesh janë të paketuara në shishe dhe i drejtohen tregjeve të BE-së. Sasi më të vogla kokaine dërgohen me postë ajrore, fshihen në valixhe dhe në rroba, transportohen me varka dhe me mjete lundruese ose dërgohen me shërbime urgjente postare.

³¹ UNODC, Raporti Botëror i Drogave 2006

³² po aty

Anijet e shpejta, anijet tregëtare dhe anijet e transportit kontenerier, mbeten format më të përdorshme për lëvizjen e drogës përmes rajonit, por trafikuesit mund të përdorin gjithashtu edhe avionët për hedhje nga lart në ujërat ndërkombëtare. Në vitin 2005, autoritetet kolumbiane raportuan madje konfiskimin e një nëndetëseje që ishte në proces ndërtimi³³. Grupet kriminale të përfshira në trafikimin e kokainës janë të organizuara mirë dhe kanë strategji efikase transportimi.

Si rezultat i një bashkëpunimi më të mirë ndërmjet shërbimeve të zbatimit të ligjit dhe një shkëmbim më të mirë të informacionit, konfiskimet e kokainës në shkallë botërore janë rritur në vazhdimësi duke arritur shifrën e 18 përqindëshit në 2004-ën (588 tonë metrikë), cfarë përbën dhe shifrën më të lartë që është regjistruar ndonjëherë. Janë vënë re dhe disa përmirësime në zonat e projektit:

Shqipëria gjatë periudhës së raportimit ka konfiskuar 9.1 kg kokainë dhe janë zbuluar vetëm pak raste në të cilat kokaina është trafikuar për në Greqi dhe Itali. Aktualisht në Shqipëri cmimi i kokainës është rreth EUR/kg 35,000.

Bosnja dhe Hercegovina reporton vetëm sasi të vogla dhe jo shumë domethënëse të kokainës së konfiskuar: 30.9 kg (2005) dhe 1.6 kg (2006).

Kroacia raporton një treg të brendshëm në rritje dhe një problem të vogël trafikimi. Konfiskimet janë vazhdimisht në ulje nga 17.6 kg (2004) deri në 9.0 kg (2005) dhe në 5.6 kg (2006). Ndërsa në 2005-ën problemet e vetme të raportuara lidheshin me portet ajrore, Kroacia përmend "konfiskime më domethënëse dhe më të mëdha të kokainës në lidhje me trafikun detar", kryesisht nëpërmjet "terminalit të kontenerit të portit të Rijekas, portit të Plominit", etj. Ka gjasa që administrata e portit, autoritetet e specializuara doganore, Zyra e Përkurorit të Përgjithshëm ose struktura të tjera të kenë të dhëna dhe shifra të tjera të cilat nuk janë raportuar nëpërmjet kanaleve të Ministrisë së Brendëshme.

Kosova thekson se ekziston aty një treg i përdorimit të kokainës, dhe raporti, pa dhënë shpjegime të hollësishme, një sasi prej 1.72 kg kokainë të konfiskuar në vitin 2006, ndërsa në dy vitet më përpara sasi të konfiskuara ishin 10 gramë (2004) ose 3.8 kg (2005).

Mali i Zi nuk ka dhënë informacion dhe ka raportuar vetëm konfiskime prej 30 g (2005) dhe 300 g (2006). Gjithsesi, sipas Raportit Ndërkombëtar të Kontrollit të Narkotikëve në vitin 2007³⁴, Mali i Zi ka qenë i angazhuar në një veprim të përbashkët nga Serbia dhe Italia në fund të 2004-ës dhe në gjysmën e parë të 2005-ës (shihni më poshtë).

Serbia raportoi se kokaina është e pranishme dhe në tregjet vendase, por qëllimi kryesor i saj është tranzitimi. Sipas përgjigjes së Serbisë, mjetet lundruese që vijnë nga Afrika e Jugut në portet e Greqisë, Italisë, Shqipërisë dhe Malit të Zi, nga ku vazhdon më tek transporti nëpërmjet kamionëve në Serbi. Gjatë tre viteve të fundit, Serbia ka konfiskuar rreth 48 kg heroinë (2004: 15.5 kg - në një operacion të përbashkët hetimi me forcat e tjera të policisë, kryesisht agjensi italiane të zbatimit të ligjit, Serbia ka konfiskuar 10 kg kokainë dhe ka ndihmuar në konfiskimin e 190 kg në Itali; 2005: 5.3 kg; dhe 2006: 12.9 kg).

"**Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë**" raporton konfiskime në ulje nga 11 kg (2005) në 0.5 kg (2006). Nuk jepet informacion i mëtejshëm.

3.1.5 Vështrim i Përgjithshëm mbi Konfiskimet në të gjitha Zonat e Projektit (në kilogramë dhe njësi)

Vendi	Droga	2000	2001	2002	2003	2004*	2005	2006
Shqipëria	Heroinë	47.00	4.50	71.71	114.48	155.93	40.9	120.0
	Kokainë	4.00	0.30	0.00	1.30	2.40	2.80	3.90
	Kanabis	6,604.	6,915.00	13,717.9	7,760.20	4,544.20	8,332.00	6,754.20
	(bimor) + bimët kanabis	00		0		+7,3757	+332,186	+74,052

³³ Raporti i Drogave të Europol-it; ky mjet do të kishte qenë në gjendje që të transportonte 15 tonë kokainë përmes Detit të Karaibeve.

³⁴ Byroja e Narkotikëve Ndërkombëtarë dhe Cështjeve të Zbatimit të Ligjit, Mars 2007, Raporti i INCB-së 2007, Volumi I

Bosnja dhe Hercegovina	Kanabisi në formë rrëshire + vaji	-	-	-	-	1,185.00		Marihuana dhe hashashi në shifra + 0.95 ltr
	Ecstasy / u	-	-	-	-	10	-	-
	Amf. / u	-	-	10	50	-	-	-
	Doza LSD	-	-	-	-	-	-	-
	Heroinë	0.38	1.90	3.27	-	5.04	68.53	9.24
Kroacia	Kokainë	164.40	-	0.24	-	-	30.86	1.61
	Kanabis (bimor) + bimët kanabis	127.98	467.59	919.55	-	168.19	318.51 + 1,956	336.14 + 9,952
	Kanabisi në formë rrëshire + vaji	-	0.06	-	-	-	11.86	137.38
	Ecstasy / u	-	-	1,212	-	-	3,387	93 + 4.72 kg
	Amf. / u	-	-	117,00	-	-	4.71	2.53
	Doza LSD	-	-	-	-	-	-	-
	Heroinë	7.04	19.57	46.36	85.73	114.40	27.10	81.60
	Kokainë	913.13	1.49	3.37	380.77	17.60	9.00	5.60
	Kanabis (bimor) + bimët kanabis	797.50	737.91	608.07	435.04	428.20	983.20	202,40 + 2,699
	Serbia dhe Mali i Zi/ 2006/2007 Serbia	Kanabisi në formë rrëshire + vaji	1.04	4.56	2.11	2.28	5.90	53.40
Ecstasy / u		9,979	12,906	11,0632	29,840	27,048	33,601	16,340
Amf. / u		2.12	0.93	28.03	3.81	7.20	14.30	11.60
Doza LSD		-	-	-	-	60	21	21
Heroinë		-	62.52	43.46	263,00	469.60	342.01	696.56
Kokainë		-	3.72	1.96	5.34	15.47	5.32	12.88
Kanabis (bimor) + bimët kanabis		-	1,230.22	774.28	1,464.96	3,901.87	1,142.00	1,817.32
Kanabisi në formë rrëshire + vaji		-	4,534,00	6,814,00	648.10	3,350.10	8,020,00	60,335.00
Ecstasy / u		-	10,811 + 0.08 kg	10,000	76,194	9,260	7,539	18,966
Amf. / u		-	0.09	-	113.10	6.10	1.10	26.30
Mali i Zi	Doza LSD	-	-	-	167	102	1,013	-
	Heroinë	-	-	-	-	-	17.60	4.00

(që prej 6/2006	Kokainë							0.03	0.29
	Kanabis (bimor) + bimët kanabis							367.5	1,114.00
Kosova	Kanabisi në formë rrëshire + vaji							10.50	0.00
	Ecstasy / u							-	0.33
	Amf. / u							-	-
	Doza LSD							-	-
	Heroinë	-	0.82	6.11	46.78	23.28		36.48	14.65
	Kokainë	-	0.04	1.41	8.48	0.01		3.79	1.72
	Kanabis (bimor) + bimët kanabis	-	30.72	48.05	30.82	23.29	+7,983	55.30	66.64
	Kanabisi në formë rrëshire + vaji	-	-	-	-	0.95		0.21	0.38
	Ecstasy / u	-	4	50	40	56		39.5	?
	Amf. / u	-	0.03	0.02	-	12.0		13.12	23.8
Doza LSD							-	?	
"Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë"	Heroinë	90.79	110.88	28.57	66.15	242.00		69.30	151.90
	Opium							-	2.90
	Kokainë	4.689	5.860	0.342	0.342	0.131		11.0	0.54
	Kanabis (bimor) + bimët kanabis	1,333.40	99.12	29.23	180.68	550.00		203.20	408.20
	Kanabisi në formë rrëshire + vaji	427.52	309.85	258.41	423.56	-		3.20	0.16
	Ecstasy / u	280	45	18,341	-	-		2,857	1,327
	Amf. / u	-	-	7.02	-	-		1.80	-
Doza LSD							-	-	

*Të dhënat për periudhën 1998-2004 janë marrë nga Raporti Botëror i Drogave të 2005. Të dhënat për 2004-ën janë marrë pjesërisht nga *Strategjia Ndërkombëtare e Kontrollit të Narkotikëve* të Departamentit Amerikan të Shtetit si dhe të dhënat për periudhën 2005 – 2006 janë marrë nga përgjigjet e zonave të projektit të dhëna në pyetësorët e 2006-ës dhe 2007-ës.

3.2 TRAFIKIMI I QËNIEVE NJERËZORE ³⁵

Në nivel botëror theksohet se ka ende mungesë informacioni në lidhje me përmasat e këtij krimi dhe kërkime dhe raporte të ndryshme tregojnë se nuk ekzistojnë statistika të mira³⁶ dhe se përpjekjet për të luftuar këtë lloj trafikimi kanë qenë deri më sot pak a shumë jo të bashkërenduara dhe jo të efektshme³⁷, megjithëse për shumë vite trafikimi i qenieve njerëzore ka qenë pjesë e axhendës së qeverive të shumë vendeve europiane³⁸.

Ndërkohë që është e pashmangshme që një pjesë e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore hyjnë në një vend tjetër si emigrantë të paligjshëm, si pasojë e metodave të përdorura nga trafikantët, kemi të bëjmë me dy lloje fushash³⁹ shumë të ndryshme krimi. Në ndryshim me konceptin e kontrabandimit të emigrantëve, që kryesisht nënkupton kalimin e kufirit në mënyrë të paligjshme, në rastin e trafikimit të qenieve njerëzore kemi të bëjmë me shkelje të të drejtave të njeriut të personave të trafikuar, të cilët shpesh janë viktimë e rrjeteve të organizuara kriminale. Si e tillë, pra, më shumë se me një çështje të politikës së emigracionit, çështja ka të bëjë me mbrojtjen e viktimave dhe të drejtave të tyre, si dhe me ndëshkimin e trafikantëve dhe bashkëpunëtorëve të tyre.

Trafikimi i qenieve njerëzore është një problem i vazhdueshëm i trajtuar në nivelin⁴⁰ botëror dhe është kryesisht një "krim i nëndheshëm", dhe duhet të trajtohet me një paketë voluminoze masash (psh zbatimin dhe përafrimin e legjislacionit⁴¹ antitrafik duke përfshirë dënime më të larta⁴², forcimin e masave të kontrollit të kufinjve, intensifikimin e bashkëpunimit dhe hetimeve me agjenci ndërkombëtare të zbatimit të ligjit të mbështetura nga një qasje e përbashkët grupi (hetime të përbashkëta), përmirësime në kërkim, kapje dhe konfiskim të të ardhurave nga trafikimi i qenieve njerëzore, mbrojtja e viktimës dhe e dëshmitarëve, ndihmë për riatdhesim.

Mbështetur nga të gjitha strukturat dhe programet ndërkombëtare dhe evropiane, të gjitha zonat e projektit u përqëndruan në problemet e tyre që në fazat e para të programit, hartuan legjislacionin e nevojshëm, ranë dakort që të mbështesnin qasjen rajonale⁴³, përcaktuan kuadrin për leje të përkohshme qëndrimi dhe programe për mbrojtjen e viktimave/dëshmitarëve, miratuan strategji dhe plane vepirmi anti-trafik.

³⁵ Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit Ndërkufitar ('Konventa e Palermos') dhe Protokollin përkatës për 'Parandalimin, Shtypjen dhe Dënimin e Trafikimit të Personave, ne vecanti të Grave dhe Fëmijëve' (i miratuar dhe i hapur për firmë më 15 nëntor 2000) janë ratifikuar në të gjitha zonat e projektit. Shih gjithashtu Konventën e Këshillit të Evropës Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore' (miratuar dhe hapur për firmë më 16 maj 2005).

³⁶ Qendra e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimit Ndërkombëtar (CICP) ka krijuar nja bazë të dhënash ku përfshihen të dhëna nga burime të shumta për tendencat globale, rrugët ndërkufitare dhe volumi i trafikimit në persona dhe në kontrabandimin e emigrantëve, si dhe të dhëna mbi viktimën dhe autorët e trafikimit dhe përgjigjet e sistemit të drejtësisë penale për këtë aktivitet kriminal. Këto lloje të dhënash janë të parat në llojin e tyre dhe përbëjnë një mekanizëm shumë të nevojshëm për të lehtësuar zhvillimin e strategjive për të luftuar trafikimin në nivel kombëtar dhe global, 5 qershor 2007 : http://www.unodc.org/unodc/trafficking_programme_outline.html

³⁷ Raporti i UNODC mbi "Trafikimin e personave: Partnerët Globalë", botuar më 24 prill 2006.

³⁸ Informacion më i kuptueshëm: Këshilli i Evropës, Raport i Situatës 2006 për Krimin e Organizuar dhe Krimin Ekonomik në Evropën Juglindore", kapitulli 3.2, Shtator 2006.

³⁹ Trafikimi i Qenieve Njerëzore për Shfytëzim Seksual në SHBA: Perspektivë e Europolit, Janar 2006.

⁴⁰ UNODC, Raport për "Trafikimin e Personave: Llojet globale, 24 prill 2006, 127 vendet e identifikuar të origjinës, 98 vende transit dhe 137 vende destinacioni.

⁴¹ Informacion shtesë: Projekti i Këshillit të Evropës LARA për të Drejtën Penale në Evropën Jug-lindore për Trafikimin e Qenieve Njerëzore dhe Kontrabandimin Ilegal të emigrantëve, qershor 2002 – tetor 2003 dhe Europol, "Legjislacioni për Trafikimin e Qenieve Njerëzore dhe Kontrabandim i Paligjshëm i Emigrantëve", përditësimi i fundit tetor 2005.

⁴² Në 2006, Europol raportoi dënime me burg të një 18 dhe 23 vjecari për ekspozim ndaj trafikantëve në Mbretërinë e Bashkuar. Pra, trafikimi i qenieve njerëzore nuk është më një ndërmarrje kriminale që mund të shoqërohet me "rrezik të ulur".

⁴³ Konferenca për Bashkëpunimin Rajonal për të Luftuar Trafikimin e Qenieve Njerëzore, Stockholm, 9 qershor 2006, McKinley, Drejtor i Përgjithshëm i IOM-it, fjala hapëse, në të cilën ai theksoi se "kjo përbën një shembull për disa Shtete Anëtare".

Zbatimi i të gjithë standarteve dhe masave ndërkombëtare “në terren” mbetet problem dhe mund të shpjegojë gjithashtu dhe vështirësitë në dhënien e saktë të numrit të krimeve në zonë dhe zbulimin e krimit të organizuar si i tillë. Shumë përpjekje të zbatimit të ligjit përqëndrohen vetëm në pjesët e dukshme të trafikimit të qënieve njerëzore, për shembull në disa raste përdhunimi, dënimi i padrejtë i të burgosurve, dëmtime të rënda trupore, vjedhja dhe grabitja (e dokumentave), migracioni i paligjshëm, duke injoruar shumë strukturat e rastësishme dhe të organizuara që fshihen pas. Probleme të tjera ngrihen nga fakti se gratë e trafikuarat shumë shpesh heshtin për trafikantët për të mbrojtur familjet e tyre në vendet e origjinës nga grupet e krimit të organizuar.

Trafikimi i qënieve njerëzore⁴⁴ përbën një problem serioz për Europën Juglindore. Ky rajon ka shërbyer si tranzit dhe vend burim, por gjithnjë e më shumë edhe si vend destinacioni. Për më tepër, afërsia mes vendeve të origjinës, si Moldavia, Rumania, Ukraina nga njëra anë dhe vendeve hyrëse për në BE, si Greqia dhe Italia në anën tjetër, i lejojnë rrjetet e trafikimit kriminal që të bashkëpunojnë ngushtësisht mes tyre. Për këtë arsye Task Forca e Paktit të Stabilitetit i pati kërkuar vendeve të rajonit zhvillimin e Planeve të Veprimit Kombëtar të plotë kundër trafikimit të fëmijëve dhe zbatimin e tij sa më shpejt të jetë e mundur⁴⁵ dhe ato duhet të marrin parasysh dhe të punuarit në përputhje me standardet⁴⁶ e BE-së. Duke patur parasysh rëndësinë që marrin “Rrugët e Ballkanit” për kontrabandimin dhe trafikimin e një serie mallrash të kërkuara në tregjet europiane, nuk është për t’u habitur që një numër i madh i personave të trafikuar, veçanërisht gra, kalojnë tranzit nëpër këto rrugë⁴⁷.

Nuk është akoma e qartë nëse kemi të bëjmë vërtetë me një ulje të numrit të personave të trafikuar nga dhe nëpërmjet Evropës juglindore në BE apo kemi të bëjmë me një ndryshim tendence, çfarë do të thotë që ka më shumë “trafikim të brendshëm” në disa prej zonave të projektit dhe një “treg më të fshehtë”. Gjithësi, në bazë të përgjigjeve nga pyetëtori dhe sondazhin e fundit të bërë UNODC, për zonat e projektit mund të sugjerohet si më poshtë:

Shqipëria në nëntë muajt e parë të vitit 2004 raporton se janë shpërbërë 13 grupe kriminale, të cilët kishin të regjistruara 74 raste femrash të trafikuarat për qëllime shfrytëzimi seksual, me implikimin e 126 shkelësve. Për vitin 2005, policia ka raportuar tre grupe të krimit të organizuar të përfshirë në 30 raste të trafikimit të grave dhe 10 raste trafikimi të miturish dhe 64 autorë të këtyre krimeve. Një tjetër burim policor ka raportuar 21 grupe të krimit të organizuar me 75 shkelës të akuzuar për krimin e trafikimit të femrave për prostitucion, të armëve dhe të qënieve njerëzore. Në 2006 Shqipëria raportoi katër grupe të krimit të organizuar të përfshira në 27 çështje të trafikimit të grave dhe 2 raaste të trafikimit të fëmijëve, të kryera nga 32 keqbërës. Duke parë periudhën kohore (2004-2006) të dhënat nuk janë shumë domethënëse; në total janë identifikuar të paktën 20 grupe të krimit të organizuar të angazhuar në 131 vepra të trafikimit të grave, 21 raste të trafikimit të fëmijëve dhe 222 autorë krimesh. Duke marrë parasysh shifrat e ofruara për vitet më parë, të gjitha shifrat e trafikimit të qënieve njerëzore (çështje, viktimat, autorë krimesh dhe grupe të organizuara të krimit) janë ulur ndjeshëm.

⁴⁴ Sipas Nenit 3 (a) të Protokollit të Trafikimit “Trafikimi i personave do të nënkuptojë marrjen në punë, transportimin, transferimin, strehimin dhe marrjen e personave nëpërmjet kërcënimeve ose përdorimit të forcës ose formave të tjera shtrënguese, mashtruese, abuzuese, gënjeshtre, abuzimi detyrues ose pozitive cënueshmërie apo dhënien e pagesave të nevojshme ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër për qëllim shfrytëzimi. Minimalisht, shfrytëzimi përfshin prostituimin ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbimet e detyruara, skllavërinë ose praktika të ngjashme me skllavërinë, dhe heqjen e organeve”. Me qëllim ky raport nuk trajton çështjen e adoptimit të paligjshëm të fëmijëve, trafikimin e organeve të njerëzve dhe pornografinë e fëmijëve; të gjitha këto lidhen me trafikimin e qënieve njerëzore.

⁴⁵ Grupi i Punës së Paktit të Stabilitetit për Trafikimin e Qënieve Njerëzore, takimi i 6-të i Anti-Trafikut, Beograd, 23-24 mars 2004, Përfundimet dhe Raporti i Progresit, Portoroz, 7 qershor 2004.

⁴⁶ Këshilli i Vendimit Kuadër të BE-së, ‘Trafikimi i qënieve njerëzore dhe lufta kundër shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve’, 19 qershor 2002, Këshilli i Direktivës së BE-së për lejet afat-shkurtra të qëndrimit për viktimat e trafikimit, dhe, më vonë Komunikim nga Komisioni COM (2006) 367, 13.2.2007

⁴⁷ Pra, shefi i Bashkimit Evropian për Grupin e Punës së policisë i vuri detyrë Europolit në 2002-in që të hartojë një plan Veprimi për trafikimin e qënieve njerëzore nga një vend me probleme të identifikuar (Bullgaria).

Megjithatë sipas UNODC, Shqipëria është, në radhë të parë vend tranzit (“shumë i lartë”), kryesisht për viktimat nga Moldavia, Rumania dhe Ukraina për në Greqi, Itali dhe në Mbretërinë e Bashkuar. Së dyti, është vend origjine (“shumë i lartë”), vendet destinacion janë kryesisht Belgjika, Franca, Greqia, Italia, Holanda, Mbretëria e Bashkuar dhe, në një masë më të ulët, Gjermania. Së treti, Shqipëria është vend destinacion (“mesatar”) për të trafikuarit nga Moldavia, Rumania dhe Ukraina. Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar trafikimit të fëmijëve, sidomos të fëmijëve romë, e egjiptianë. Së fundmi shifrat zyrtare janë dukshëm fragmentare dhe të diskutueshme, dhe sipas Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm dhe OJQ-ve numri i pazbuluar mund të jetë po aq i madh sa numri i krimeve të zbuluara.

Bosnja dhe Hercegovina (BiH) raporton shifra në rritje dhe shton se shfrytëzimi seksual është bërë më klandestin dhe i sofistikuar (apartamente private, shërbime shoqërimi, Internet). Numri i hetimeve të lëna pezull dhe i atyre të reja është rritur në mënyrë konstante nga 40 (2004) në 68 (2005) dhe 90 (2006). Numri i viktimave reflekton këtë zhvillim (54, 66,71); ka një ndryshim të qartë drejt viktimave të dhunës në familje (që janë rritur në mënyrë konstante që prej 2004 deri në 2006 në masën prej 44%) ose viktimat nga zona fqinje projekti, të cilat duket sikur janë objekti i më pak dhune dhe i kushteve më të mira të jetesës dhe aktualisht i shërbejnë kryesisht tregut të brendshëm. Në 2006-ën, në total 77 autorë të trafikimit të qënieve njerëzore dhe krime përkatëse janë hetuar (2005: 59). Autorët e përfshirë në trafikimin e qënieve njerëzore janë gjithnjë e më tepër qytetarë të Bosnjë-Hercegovinës, shpesh pronarë të klubeve të natës ose kanë lidhje biznesi me pronarë të tjerë lokalesh. Nuk janë dhënë shifra për përfshirjen në grupet e krimin të organizuar.

Sipas UNODC, BiH është, në radhë të parë, vend tranzit (“i lartë”), kryesisht për viktimat nga Bullgaria, Moldavia, Rumania, Ukraina për në Itali dhe vende të tjera të Europës Perëndimore. Së dyti, është vend destinacion (“i lartë”) për viktimat që vinë nga Bullgaria, Moldavia, Rumania, Ukraina, por edhe nga Bjellorusia, Kazakistani dhe Federata Ruse. Së fundi, BiH është vend origjine (“mesatar”), nga ku viktimat trafikohen për në Kroaci, Gjermani, Itali, Hollandë, Spanjë dhe në Mbretërinë e Bashkuar. Viktimat janë kryesisht gra dhe vajza për shfrytëzim seksual.

Kroacia ka raportuar se tregu i saj i trafikimit është i vogël krahasuar me vende të tjera të projektit, në rajon. Në 2004 ishin 4 grupe të krimin të organizuar me 11 keqbërës/shkelës të përfshirë në 3 raste të regjistruara, ku u përfshinë 19 viktimat. Në 2005 janë hetuar në total 5 raste të trafikimit të qënieve njerëzore, ku u përfshinë 8 autorë dhe 6 viktimat. Në 2006 janë hetuar në total 6 raste të trafikimit të qënieve njerëzore, ku u përfshinë 18 autorë dhe 13 viktimat nga të cilat vetëm dy prej tyre rezultuan të lidhura me krimin e organizuar. Në këtë hark kohor pjesa më e amdhe e viktimave vinin nga Kroacia dhe vendet fqinje të projektit ose vende të afërta të Evropës Juglindore. Shifrat e ulta, kombësia e trafikantëve dhe viktimave dhe vetëm 3 raste të zbuluara të përfshirjes në krimin e organizuar dëshmojnë se nuk ka rrjete të mëdha ndërkombëtare të krimin të organizuar - por ekziston dhe mundësia e një numri të madh të trafikimit të qënieve njerëzore të cilat janë të fshehura.

Sipas UNODC, Kroacia përgjithësisht klasifikohet vetëm si “mesatar”, si vend destinacion (për viktimat nga Ukraina), vend transit (për viktimat nga Bullgaria, Moldavia, Rumania, Ukraina dhe vende të tjera të Europës Qendrore dhe Juglindore për në vendet e BE-s) dhe vend origjine (veçanërisht për Austrinë, Italinë dhe Spanjën).

Kosova ka përditësuar raportimin e saj. Në 2004 u raportuan 85 çështje me 70 autorë dhe 58 viktimat. Në 2005-ën shifrat u ulën në 70 çështje, 92 autorë dhe 55 viktimat. Në 2006-ën shifrat u rritën përsëri -- 78 çështje, 97 autorë dhe 64 viktimat. Megjithëse numri i viktimave kosovare ka rënë ndjeshëm, pjesa më e madhe e autorëve (më shumë se 50%) dhe viktimat kanë qënë kosovarë ose shqiptarë (në 2006 janë raportuar 15 fëmijë nën moshën 18 vjeç, ku më i vogli ishte 13 vjeç) që kishin ardhur nga zonat fqinje të projektit ose vende të afërta të Evropës Juglindore. Nuk është dhënë informacion në lidhje me grupet e krimin të organizuar. Së fundmi, pjesa më e madhe e viktimave kanë dokumenta të vlefshme dhe kontrata pune, ka një tendencë në rritje të prostitucionit vullnetar dhe në përgjithësi duket sikur trafikantët ofrojnë kushte më të mira jetese dhe pagesa më të larta.

UNODC e klasifikon Kosovën, së pari, si vend tranzit (“i lartë”) për viktime nga Bjellorusia, Moldavia, Rumania, Federata Ruse dhe Ukraina, për t’u trafikuar për në Shqipëri, Bosnie e Hercegovinë, Itali dhe vende të tjera të Europës Perëndimore, si dhe në Mal të Zi dhe Serbi. Së dyti, Kosova është vend destinacion (“i lartë”), me viktime që trafikohen nga Moldavia, Rumania, Ukraina, por edhe nga Bullgaria dhe Federata Ruse. Së fundi, Kosova raportohet si vend origjine (“mesatar”) për viktime të trafikuar për në Itali dhe Austri, por edhe në Mbretërinë e Bashkuar.

Mali i Zi raporton shifra në rënie për trafikimin e qënieve njerëzore. Ndërkohë që për herë të parë nga 2000-2004 u raportuan gjithsej 10 çështje me 31 autorë të përfshira në shtatë grupe të krimit të organizuar, në 2005-ën u raportuan vetëm 3 çështje, me tre autorë që trafikonin 23 viktime. Në 2006-ën Mali i Zi raporton vetëm një çështje me një autor krimi (femër).

Raporti i Trafikimit të UNODC-së ka dalë në prill të 2006-ës; si rezultat në të nuk kishte analiza të lidhura me Malin e Zi.

Serbia ka raportuar për vitin 2003⁴⁸ një total prej 17 rastesh trafikimi të kryera nga 106 shkelës organizuar në 16 grupe të krimit të organizuar. Fenomeni i viktimave të dhunës në familje dhe të trafikuar në vend, në vecanti i fëmijëve, duket se është në rritje. Në 2004-ën 10 grupe të krimit të organizuar me rreth 100 anëtarë janë përfshirë në vepra të trafikimit të qënieve njerëzore. Për 2005-ën nuk janë dhënë të shifra për shfrytëzimin seksual të grave. Në 2006-ën u zbuluan 37 vepra të kryera nga 77 autorë. Pra, mund të sugjerohet se në 2005-ën, vit për të cilin nuk janë dhënë shifra, numri i çështjeve të hetuara mund të ketë qënë diku tek 20 deri në 30. Serbia raporton se pjesa më e madhe e çështjeve janë kryer me përfshirjen në grupet e organizuara të krimit.

Sipas Raportit të Trafikimit të UNODC, Serbia dhe Mali i Zi, ishin, në radhë të parë, vende tranziti (“të lartë”) për viktime nga Europa Qendrore dhe Juglindore për në Bosnje e Hercegovinë, sidomos nga Moldavia, Rumania dhe Ukraina për në Itali dhe vende të tjera të Europës Perëndimore. Në radhë të dytë, ato janë raportuar si vende destinacioni (“mesatar”), kryesisht për viktimat nga Ukraina dhe, në një shkallë më të ulët, nga Moldavia, dhe si vende origjine (“mesatare”) për Hollandën dhe Spanjën.

“Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë” ka raportuar se përmes vëndit janë trafikuar rreth 2000 deri 4000 gra duke gjeneruar një përfitim vjetor nga kjo veprimtari kriminale rreth 30 milione Euro. Në të njëjtën kohë raportohen vetëm 21 raste për 2004, që përfshijnë 13 grupe kriminale me 52 shkelës, dhe vetëm 12 raste me 40 shkelës për 2005. Në 2006-ën shifrat u ulën sërish në tri çështje, katër autorë, njëri prej tyre e detyroi një nënë të re që të shiste foshnjën e saj 7 muajshe në Greqi. Në asnjë rast tjetër nuk u përmendën grupet e krimit të organizuar.

Sipas UNODC, ky vend klasifikohet, në radhë të parë, si vend tranzit (“i lartë”) kryesisht për viktime nga Bullgaria, Moldavia, Rumania, Ukraina për në Shqipëri dhe, pjesërisht, që aty përmes Italisë për në Francë dhe Mbretërinë e Bashkuar, por edhe nga vende të tjera të Europës Qendrore dhe Juglindore drejt Kosovës, Malit të Zi dhe Serbisë. Veç kësaj, është vend origjine i nivelit “të mesëm” për viktimat e trafikuar drejt Italisë dhe vend destinacion për viktimat e trafikuar nga Bullgaria, Moldavia, Rumania dhe Ukraina.

Mund të nxirren përfundimet e mëposhtme në lidhje me trafikimin e qënieve njerëzore në Evropën Juglindore⁴⁹:

⁴⁸ UNICEF/UNOHCHR/OSCE (2004), p. 116.

⁴⁹ Më shumë informacion mund të gjeni në: Këshilli i Evropës, raporti i Situatës për 2006-ën për Krimin Ekonomik dhe Krimin e Organizuar në Evropën Juglindore, shtator 2006.

Nga pikëpamja sasiore, trafikimi i qenieve njerëzore në Europën Juglindore duket të jetë një krim në rënie ose, të paktën, po bëhet më pak i dukshëm dhe gjithnjë e më tepër rekrutimi dhe trafikimi në fazën e parë ndodh në vendin e origjinës ose në zonat përreth. Disa ekspertë vlerësojnë se vetëm 5% e viktimave raportojnë viktimizimin e tyre ose sillen në vëmendjen e autoriteteve qeveritare⁵⁰, ndërkohë që analiza të tjera identike ekzistojnë dhe në disa vende të tjera anëtare të BE-së.

Pjesa më e madhe e viktimave janë viktimat në familje ose vijnë nga zonat fqinje të projektit ose vendet fqinje të vendet e afërta të Evropës Juglindore. Kjo lidhet me konstatimet, sipas të cilave më pak viktimat kthehen nga vendet e BE-së në vendet e tyre të origjinës⁵¹.

Gjithsesi, ashtu sic dëshmohet dhe nga tabela e mëposhtme, analiza është e dyshimtë. Disa zona projekti përmendin se shifrat nuk reflektojnë situatën reale, disa të tjera nuk japin informacioni për grupet e krimit të organizuar, disa të tjera sugjerojnë se në cdo rast të përfshirjes së grupeve të krimit të organizuar në trafikimin e qenieve njerëzore, disa të tjera nuk raportojnë në mënyrë të qëndrueshme, disa nuk paraqesin të dhëna të gjyqësorit ose të PJQ-ve për të hedhur më shumë dritë në shifrat jo të qarta:

Vështrim i Përgjithshëm në Trafikimin e Qenieve Njerëzore në të Gjitha Zonat e Projektit

Zona e projektit	Shqipëria	Bosnja dhe Hercegovina	Kroacia	Kosova	Mali i Zi	Serbia	“Ish republika Jugosllave e Maqedonisë”
2004							
Çështjet	83	40	4	85	10 (2000 - 2004)	?	21
Viktimat*	?	54	19	58	?	ca. 150 since 2002	?
Autorët e krimit	126	?	11	70	31	100	52
Grupet e krimit të organizuar	13	?	?	85	?	10	13
2005							
Çështjet	?	68	5	70	3	?	12
Viktimat*	40	66	6	55		44	?
Autorët e krimit	64	59	8	92	31	?	40
Grupet e krimit të organizuar	3	?	1	70	7	-?	?
2006							
Çështjet	?	90	6	78	1	37	3

⁵⁰ Byroja e NRM (2005), Trafikimi i qenieve njerëzore, Raporti i Tretë dhe i Katërt i raportuesit Kombëtar Holandez: Bureau NRM (<http://www.victimology.nl/onlpub/national/NL-NRMEngels>); gjithashtu: Raporti i katërt nga qeveria e Hollandës për Zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (CEDAW), 2000-2004.

⁵¹ Kjo konfirmohet gjithashtu nga IOM Gjermani, e cila raportoi vetëm një numër shumë të vogël grash që vinin nga zonat e projektit në rajon, psh të arrestuara në Gjermani (2003/2004: asnjë, 2005: 1 në Shqipëri, 1 në Kroaci dhe 1 në “Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë” por 19 në Bullgari dhe 23 në Rumani).

Viktimat*	29	71	13	64	?	?	?
Autorët e krimet	32	77	18	97	1	77	4
Grupet e krimet të organizuar	4	?	2	78	0	?	0

* Vetëm disa zona projekti bëjnë dallimin ndërmjet numrit të veprave dhe viktimave në lidhje me viktimat fëmijë. Për të ofruar një krahasim më të mirë të shifrave të viktimave në rastet e shifrave të vecanta për fëmijët ato janë mbledhur.

3.3 KONTRABANDIMI I PERSONAVE

Globalizimi kontribon në rritjen e konsiderueshme të kontrabandimit të personave dhe trafikimit të qenieve njerëzore, duke bërë që, si kontrabandimi i personave, edhe trafikimi i tyre, të bëhen biznesi kryesor global i grupeve⁵² të kimit të organizuar dhe përgjithësisht ka shkallë të ulët rreziku dhe është krim me fitime të larta po të krahasohet me kontrabandimin e drogave, armëve ose piraterinë. Migracioni është një temë shumë komplekse si çështje shoqërore dhe problem kriminal. Shkaqet kryesore të kontrabandimit janë pikërisht “faktorët e shtytjes” që çojnë në zhvendosje të detyruar të njerëzve, si fatkeqësitë natyrore, lufta, konfliktet etnike dhe fetare, persekutimi politik, lufrat civile dhe varfëria, apo gjendja e rëndë ekonomike, faktorë që i shtynë emigrantët të lenë vendin e tyre. “Faktorët e tërheqjes”, të tillë si nevoja për forca të lira pune, gjendja ekonomike e stabilizuar dhe siguria e përgjithshme sociale, një lloj zhvillimi relativ në vendet destinacion, sistemet qeverisëse demokratike, stabiliteti politik e social dhe, më e rëndësishmja, ekzistenca e diasporave/komuniteteve të caktuara, përbëjnë kriteret për zgjedhjen e një vendi destinacion, që shpesh është një Shtet Anëtar i BE-s. Kontrabandimi i qenieve njerëzore nga sindikatat kriminale con në një ndër izolimet më serioze të të drejtave të njeriut sot – një skllavëri e kohëve moderne.

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar (‘Konventa e Palermos’) dhe “Protokolli Kundër Kontrabandimit të Migrantëve nga Toka, Deti dhe Ajri”⁵³ e kanë trajtuar këtë problem dhe e kanë përcaktuar kontrabandimin e emigrantëve si “prokurim në mënyrë që të arrihet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një përfitim financiar ose përfitim tjetër material nga hyrja e paligjshme e një personi në një Shtet, i cili nuk është shteti i kombësisë dhe i qëndrimit të përhershëm të personit.” (Neni 3, paragrafi a).

Të gjitha zonat e projektit kanë ratifikuar Konventën dhe Protokollin, kanë miratuar legjislacionin e nevojshëm me pothuajse të gjitha nivelet e gjobave dhe rrethanave⁵⁴ rënduese dhe kanë miratuar strategji dhe plane veprimi kundër kontrabandimit.

Trajtimi i sfidave dhe mundësive të migracionit për përfitimin e të gjithëve është një ndër përparësitë e BE-së në fillim të shekullit të 21⁵⁵. Si rezultat, politika e migracionit ka qënë në krye të axhendave për ca kohë, ndërmjet gjërave të tjera, në lidhje me zgjerimin e fundit të BE-së dhe zgjerimin e mundshëm në të ardhmen, lëvizjen e lirë të njerëzve, aksesin në tregjet e punës, ksenofobinë dhe racizmin si dhe në lidhje me kërkesat ekonomike të shkaktuara nga ulja e popullsisë⁵⁶ aktive për punë të BE-së, duke e shtrënguar nevojën për një migracion ekonomik më ligjor dhe më të kontrolluar ekonomik.

Politika evropiane e migracionit bazohet në konkluzionet e Këshillit Evropian të Tamperit në 1999-ën, programin e Hagës të 2004-ës dhe Direktivës e Këshillit të BE-së në 2005 për Procedurat⁵⁷ e Azilimit.

Përmirësimi i menaxhimit të kufirit të jashtëm të Bashkimit Evropian në bazën e strategjisë së integruar për menaxhimin e kufijve, e miratuar nga këshilli në 2006-ën ka një përparësi kyce, në vecanti rritja e kapaciteteve të Frontex, krijimi i procedurave për situatat e emergjencës, duke përforcuar lidhjet me Rrjetin e Oficerit Ndërlidhës së Emigracionit, etj.

⁵² Emigrantët nga Azia paguajnë më shumë se USD 30,000 për të hyrë në Evropën perëndimore dhe USD 60,000 për Amerikën e Veriut, Interpol, 2006-03, shih: <http://www.interpol.int/Public/ICPO/FactSheets/THB01.pdf>

⁵³ ‘Protokolli i Migracionit’ u hartua dhe u hap për firmë më 15 dhjetor 2000 dhe ka hyrë në fuqi që prej 28 janarit 2004.

⁵⁴ Europol, Legjislacioni dhe Kontrabandimi i Trafikimit të Paligjshëm, Mars 2004, Shtojca II, Krahasimi i legjislacionit përkatës për emigracionin e paligjshëm.

⁵⁵ Informacion shtesë: Komunikimi nga Komisioni - 'Forcimi i bashkëpunimit praktik - Strukturat e reja, qasje të reja: përmirësimi i cilësisë në vendimmarrje në sistemit e përbashkët të azilimit evropian': OJ C 67, 18.3.2006; COM (2006) 67; Bull. 1/2-2006, pika 1.18.11.

⁵⁶ Popullsia e BE-së pritet të ulet në rreth 20 milionë përsa i përket numrit të punëtorëve ndërmjet 2005-ës dhe 2030-së.

⁵⁷ Direktiva e Këshillit për Procedurat e Azilimit u miratua më 1 dhjetor 2005 dhe përbën dhe thelbin e sistemit të përbashkët të azilimit në BE.

Parlamenti Evropian dhe Këshilli janë të ftuar gjithashtu të arrijnë një marrëveshje të shpejtë për rregulloren për përcaktimin e ndërhyrjeve të Skuadrave të shpejta kufitare më 1 shtator 2007 dhe për të studiuar këtë model në funksione të tjera të lidhura me kufinj të, si për shembull ndihma humanitare.

Interpoli i njeh “Rrugët Ballkanike” për në Europën Perëndimore të cilat përdoren për kontrabandimin e emigrantëve nga vendet aziatike e të Lindjes së Mesme, nëpërmjet Iranit, Turqisë dhe Bullgarisë⁵⁸. Një numër gjithnjë e më i madh vendesh europiane raportojnë raste të krimit të organizuar, që kanë të bëjnë me kontrabandimin e personave. Sipas Eurostat, Europol dhe Frontex⁵⁹, rreth 500,000 emigrantë ilegalë vërshojnë çdo vit në BE, duke iu shtuar rreth 300,000 - 400,000 azi-kërkuesve të regjistruar, shumica e të cilëve përdorin “Rrugët ballkanike”.

Gjithsesi është e vështirë që të përshkruhet shkalla reale e kontrabandimit të personave⁶⁰. Shifrat e vlerësuar bazohen kryesisht në aplikimet për azil, të cilat mund të shërbejnë si një vlerësim i përafërt po jo si një bazë për masën reale të migracionit të paligjshëm. Shifrat e azilimit në BE janë përgjithësisht në ulje dhe që prej zbatimit të EURODAC, baza e të dhënave për shenjat e gishtave të azilkerkuesit, i cili filloi të zbatohet në janar 2003, është ulur “tregëtimi i azilimit”. Në bazë të një analize më të detajuar të Europolit⁶¹, zonat që paraqen shqetësim më të madh për Shtetet Anëtare të BE-së kanë akoma numra jo të përfillshëm të emigrantëve të paligjshëm nga “Rajoni i Ballkanit”, Federata Ruse, Kina, Iraku, vendet e nën Saharisë, India, Afganistani dhe Pakistani. Disa nga vendet më të afërta fqinje të BE-së përdoren si pika të rëndësishme përpara hallkës së fundit klandestine të udhëtimit për në BE. Afërsia gjeografike dhe marrëdhëniet social-kulturore ndërmjet vendeve të burimit, tranzitit dhe destinacionit, sistemet ekzistuese të ligjshme dhe të paligjshme të diasporës, të cilat natyrshëm përcaktojnë rrugët kryesore të përdorura nga kontrabandistët.

Situata në Europën Juglindore është përmirësuar ndjeshëm në vitet e fundit, edhe pse vazhdon të paraqesë një numër shqetësimesh. Rreth 2 milionë njerëz janë kthyer nëpër vendet e shtëpitë e tyre, por janë ende rreth 1.3 milionë të tjerë të shpërngulur, përfshirë edhe 230,000 serbë etnikë, romë dhe pjesëtarë minoritetesh të tjera të larguar nga Kosova. Mali i Zi, Serbia e Kosova vazhdon të strehojë 390,000 refugjatë nga konfliktet e mëparëshme, komuniteti më i madh i refugjatëve në Botë. Korrupsioni dhe urrejtja ndër-etnike janë shumë të përhapura në disa zona. Rajoni vazhdon të jetë në një udhëkryq mjaft të ndjeshëm dhe shërben kryesisht si një zonë tranziti për kontrabandimin e personave.

Në drejtim të kontrabandimit të personave dhe lidhjeve me krimin e organizuar, duhet të vihen re tendencat dhe çështjet e mëposhtme⁶²:

Shqipëria ka arritur një sukses domethënës, në vecanti, në mbylljen e rrugëve detare dhe në ndjekjen e një numri të madh kriminelësh⁶³. Përdorimi i rrugëve tokësore është bërë i rëndësishëm, përkatësisht kufiri me Kosovën (174 km i gjatë) që mbulon një terren të ashpër malor, i cili patullohet dobët nga policia. Duket sikur kufijtë veriorë dhe lindorë të Shqipërisë janë përdorur kryesisht për kontrabandë të paligjshme, ndërkohë që anashkalimi i rregullave të vizës është i thjeshtë. Në nëntë muajt e parë të vitit

⁵⁸ Rruga e Afrikës së Veriut duket sikur mban volumin më të madh të emigrantëve të paligjshëm në BE. Rrugët e Evropës qendrore dhe lindore duket sikur po bëhen më të rëndësishme, ndërkohë që ndikimi i rrugëve balltike është ulur. Vendet më të shpeshta të tranzitimit përpara arrijtes së kufinjve të jashtëm të BE-së janë Rusia (Moska), Ukraina (Kiev), Turqia (Stamboll), dhe, me një natyrë më të përgjithshme, disa vende në Evropën Juglindore. Për më tepër informacion shihni: www.interpol.org.

⁵⁹ Frontex është agjencia e re e menaxhimit të kufirit, e miratur nga Rregullorja e Këshillit (EC) No 2007/2004 e 26 tetorit 2004, e krijuar në Varshavë, (OJ L349, 25. nëntor 2004).

⁶⁰ Shih projektin e përbashkët të ICMPD-Europol “Drejt një Përgjigje të Kuptueshme për Rrjedhat e Emigracionit Miks”, takimi i 26-28 prillit 2006 në Liban dhe takimi i 7-9 qershorit 2006 në Brdo, Sllovenia.

⁶¹ Europol, Emigracioni i Paligjshëm i Organizuar në BE, Mars 2006.

⁶² Informacioni i UNHCR dhe përgjigje për pyetësorin të Këshillit të Evropës.

⁶³ Përpara përfundimit të rrugëve të kontrabandimit në det nga Shqipëria në Itali 100,000 emigrantë mund të kenë përdorur këtë rrugë për të hyrë në BE, gjë e cila mund të ketë sjellë një përfitim prej 60-100 milionë eurosh nga të ardhurat e krimit ndërmjet 1998 dhe 2002.

2004, të dhënat nga policia⁶⁴ shqiptare tregojnë për 365 raste të kalimit të paligjshëm të kufirit dhe të organizimit e asistimit të këtij procesi me implikimin 644 shkelësve, kryesisht me origjinë kosovare. Në vitin **2005**, Shqipëria ka raportuar 123 raste të kryera nga 259 shkelës, nga të cilat 13 raste janë raportuar me implikime të grupeve të krimit të organizuar. Në 2006 janë raportuar vetëm 134 raste, 172 autorë dhe përfshirja e grupeve të vogla të krimit të organizuar (3-5 anëtarë) në 14 çështje.

Bosnia dhe Herzegovina (BiH) konsiderohet si një vend tranziti nga ku transportohen ilegalisht qytetarë shqiptarë, kinezë, turq, indianë e pakistanezë për në vendet e Europës Perëndimore. Ata hyjnë në BiH nga Mali i Zi dhe Serbia, përmes kufirit të ligjshëm dhe të paligjshëm lindor të vendit nëpërmjet Malit të Zi dhe Serbisë. Grupe lokale kriminelësh i shoqërojnë ata përtej lumenjsh e kufijsh ilegalë për në Kroaci. Në të shkuarën, janë regjistruar mjaft raste kur në Bosnje e Hercegovinë kanë hyrë grupe të mëdha emigrantësh ilegalë, gjoja si turistë apo pjesëtarë të shoqatave kulturore. Kohët e fundit duket se komuniteti kinez i vendosur në vend ka lidhje me elementë kriminelë të organizuar që mundësojnë emiracionin nga Kina drejt Europës Perëndimore. Gjithsesi, nuk ka të dhëna nga policia për vitin 2004 dhe 2005), por çështjet nga zira e prokurorit të përgjithshëm, e cila bëri 102 hetime në lidhje me trafikimin e personave, 57 çështje nga periudha të mëparshme (nuk është e qartë nëse bëhet fjalë për të dhënat e 2004-ës ose të 2005-ës) Në 2006-ën, u regjistruan 63 çështje, 126 autorë krimesh dhe vetëm një rast i përfshirjes së grupit të krimit të organizuar. Nuk ka informacion tjetër të disponueshëm.

Kroacia është një vend klasik tranziti për në BE. Pjesa më e madhe e kontrabandimit të emigrantëve në Kroaci është i përqëndruar dhe ndodh në Zagreb, grupet e krimit të organizuar janë të përfshinë në aktivitete të tjera kriminale dhe të njëjtat kanale përdoren për trafikimin e drogave (opiateve) dhe armëve. Shumë nga kontrabandimi i emigrantëve në Kroaci është përqëndruar dhe shkon përmes Zagrebit. Në vitin 2004, janë raportuar 194 raste kalimesh të paligjshme të 223 emigrantëve ilegalë, nga të cilët 15 raste klasifikohen si krim i organizuar me implikimin e 11 grupeve. Në vitin 2005, janë raportuar 260 raste të kontrabandimit të 270 emigrantëve ilegalë, gjë që përfaqëson një rritje prej 34,02 për qind. Fatkeqësisht nuk ka asnjë raportim rastesh me implikim të grupeve të krimit të organizuar.

Në **2004-ën**, u regjistruan 194 çështje të kontrabandimit të 223 emigrantëve të paligjshëm, 5 grupe të krimit të organizuar të përfshirë në kontrabandimin e personave. Në **2005-ën**, 260 çështje (+34 përqind) të kontrabandimit të 270 emigrantëve të paligjshëm me përfshirjen e 5 grupeve të krimit të organizuar. Në **2006-ën**, shifrat u rritën përsëri në 320 çështje (+23 përqind) të kontrabandimit të 358 emigrantëve të paligjshëm, përfshirje të 4 grupeve të krimit të organizuar.

Kosova raporton një treg fitimprurës së kontrabandimit, ose nëpërmjet aktiviteteve të kontrabandimit ose nëpërmjet mbështetjes së kontrabandistëve (psh agjencitë e udhëtimit, strehimi i përkohshëm ose ofrimi i dokumentave fallso të identifikimit). Pjesa më e madhe e kontrabandistëve janë kosovarë të cilët punojnë sëbashku me autorët nga vendet e origjinës.

Në raportet e mëparshme, kontrabandimi i personave është vlerësuar për **2004-ën** në disa mijë/vit), për **2005**: 105 çështje (Policia Kufitare) ose shtatë me 27 autorë dhe emigrantë nga Bangladeshi, India dhe Pakistani (prokurorët ndërkombëtarë që punojnë me Departamentin e Drejtësisë së UNMIK-ut). Në bazë të përgjigjeve të këtij viti, në **2006-ën**, pati vetëm një rast të kontrabandimit të organizuar të personave, 12 autorë të cilët kontrabanduan 26 emigrantë të paligjshëm, përsëri nga Bangladeshi, India dhe Pakistani, çfarë dëshmon për kanale të mirë-përcaktuara kontrabandimi.

Mali i Zi ka liberalizuar regjimin e vizave, duke ulur në mënyrë të ndjeshme numrin e emigrantëve të paligjshëm dhe kontrabandimin e personave, gjë e cila është e vërtetë në vecanti për kontrabandimin nga Shqipëria. Një regjim më strikt vizash që kërkon viza për qytetarët shqiptarë dhe kosovarë kur futen në territorin e Bosnjës dhe Hercegovinës, nga ana tjetër ka krijuar një kërkesë për kontrabandim përtej kufirit. Pjesa më e madhe e autorëve janë nga Mali i Zi dhe nga Shqipëria.

⁶⁴ Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm jep shifra të ndryshme.

Gjithsesi, për nëntë-mujorin e parë të 2004-ën 372 çështje janë klasifikuar si kalime të paligjshme kufii. Nuk është raportuar se sa nga këto çështje janë cilësuar si të organizuar nga një grup i organizuar krimi. Në 2006-ën Mali i Zi raportoi shtatë raste të kontrabandimit të organizuar të emigrantëve të paligjshëm (kryesisht shqiptarë), por përderisa numri i autorëve të krimit në secilin grup raportohet në dy deri në gjashtë vetë, jo të gjitha shtatë çështjet mund të kenë qënë raste të kontrabandimit "të organizuar" të personave.

Serbia raporton kontrabandim të personave si një aktivitet kriminal në rritje, i cili shërben si zëvendësues i trafikimit të drogave, ku rreziku është i ulët dhe përfitimet të larta. Grupet e krimit të organizuar në Serbi janë të organizuara mirë dhe përgjithësisht të përfshirë në kontrabandimin e emigrantëve të paligjshëm dhe të organizimin e transporthimit përkatës për në Kroaci dhe më tej në Evropën Perëndimore. Organizatorët kryesorë janë nga Kosova, Mali i Zi dhe Kroacia. Shërbimet sekrete serbe thonë se kanalet e kontrabandimit përdorin dhe trafikimin e drogave, armëve dhe mallrave të akcizës, dhe përfitime të paligjshme që shkojnë në miliona euro. Serbia ka pasur të strehuar dhe një anëtar të grupit terrorist islamik përgjegjës për sulmin e Madridit, i cili ishte futur në mënyrë të paligjshme në Serbi.

Në 2004-ën çështjet e krimit të organizuar përfshinë 16 grupe të krimit të organizuar, ku përfshiheshin 64 autorë krimesh. Në 2005-ën ka një rritje të dukshme të shifrave: 37 shkelje të kontrabandimit të 219 emigrantëve ilegalë, të kryera nga 87 shkelës, kryesisht serbë (73), por edhe kinezë (5), boshnjakë (4), maqedonas (3) e të tjerë. Nuk është dhënë informacion për numrin e grupeve të krimit të organizuar. Në 2006-ën janë raportuar vetëm 6 çështje, dhe të gjitha paditë lidhen me kontrabandimin e "organizuar" të personave, ku u përfshinë 46 autorë (kryesisht serbë ose qytetarë nga ish Jugosllavia dhe Shqipëria, të angazhuar në kontrabandimin e 434 emigrantëve të paligjshëm.

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë sugjeron se vendi është kryesisht vend tranziti; konstatimet janë të ngjashme për Serbinë dhe Kroacinë. Emigrantët e paligjshëm shqiptarë transportohen në Greqi; emigrantët e paligjshëm turq kalojnë përmes Maqedonisë për të shkuar në shtete të Evropës Perëndimore. Emigrantët e paligjshëm aziatikë vijnë kryesisht nga Serbia në Maqedoni dhe më pas transportohen në Greqi.

Në vitin 2003, "Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë" regjistroi 8 raste të kontrabandimit të organizuar të personave, ku implikoheshin 4 grupe me një total prej 12 shkelësish. Për vitin 2004 nuk ka të dhëna të raportuara. Në 2005 janë raportuar 35 raste të regjistruara, me 61 keqbërës, dy nga të cilat të klasifikuara si raste të krimit të organizuar me 23 keqbërës. Në një rast, një grup i organizuar, me 31 pjesarë (nga Shqipëria, Mali i Zi, Serbia dhe Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë) kishte kontrabanduar përmes 10 veprimtarish të ndryshme, rreth 100 persona përmes kufirit Maqedoni-Greqi, pjesërisht të ndihmuar nga 3 punonjës të Policisë Kufitare Maqedonase. Në 2006-ën janë ngritur padi penal për 23 vepra, të realizuara nga 54 autorë krimesh (50% maqedonas dhe 50% shqiptarë), që kanë kontrabanduar 101 emigrantë të paligjshëm. Në tre raste u përfshinë 21 autorë prej grupeve të krimit të organizuar. Pjesa më e madhe e emigrantëve të kontrabanduar ishin shqiptarë, maqedonas, por kishte dhe kinëze, hindu dhe moldavë, ndërkohë që vetëm 9 emigrantë ishin femra.

Përfundimet e mëposhtme mund të nxirren për kontrabandimin e emigrantëve të paligjshëm në ose nëpërmejt Evropës Juglindore:

Megjithë shifrat e vogla e madje në rënie (përveç Kroacisë) dhe statistikave shumë të ndryshueshme (p.sh. emigrantë ilegalë/persona të kontrabanduar/trafikim qeniesh njerëzore, rekord krimesh/padi/dënime,drejtësia/policia/ burime të tjera nga njëri vend në tjetrin në projekt) shërbimet e inteligjencës sugjerojnë një rol të fuqishëm të të grupeve të krimit të organizuar me një sofistikim në rritje të mjeteve të përdorura dhe me një bashkëpunim mes grupeve të ndryshme kriminale lokale në të gjithë rrugët e njohura nga kalon kjo kontrabandë, si dhe me aktorë globalë në Azi dhe Evropën Lindore.

Sistemet e raportimit janë përmirësuar. Shifra nga 2003 dhe 2004 shpesh "ndoteshin" nga shifra të migracionit të paligjshëm pa mbështetjen e kontrabandës nga palë të treta ose pa përfshirjen e grupeve të krimit të organizuar. Në vitin **2004**, vetëm Kroacia dhe Serbia raportuan përfshirje të grupeve të krimit të organizuar (5 dhe 16). Në vitin **2005** shifrat u ofruan nga Shqipëria (13 grupe të krimit të organizuar), Kroacia (5 grupe të organizuara krimi) dhe "ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" (2 grupe të krimit të organizuar) – në total 20 grupe të krimit të organizuar. Në vitin **2006** vetëm Kosova nuk dha shifra për grupet e krimit të organizuar. Shifra në rritje u raportuan nga Shqipëria (14 grupe të organizuara krimi, Bosnja dhe Herzegovina (1 grup i organizuar krimi), Kroacia (4 grupe) Mali i Zi (rreth 5 grupe të krimit të organizuar), Serbia (6 grupe të krimit të organizuar) dhe "ish Republika jugosllave e Maqedonisë" (3 grupe krimi të organizuar), në total 33 grupe të krimit të organizuar. Zonat e projektit të cialt raportojnë numrin e emigrantëve të paligjshëm të kontrabanduar sugjerijnë se mund të ketë një rritje në të gjitha zonat e projektit (Kroacia: 223 - 270 - 358; Serbia: ? - 219 - 434).

Janë në fuqi grupe të një niveli më të lartë, të cilat mund të sigurojnë ndihmë për emigrantët në vendin e destinacionit përfundimtar, në përgjithësi duke u mbështetur në lidhjet me komunitetet e të njëjtave kombësi ose etni të atij vendi. Ndërkohë që rrjetet e trafikimit të qëneive njerëzore kryesisht operojnë në Evropën Juglindore, rrjetet e kontrabandimit e kanë origjinën thellë në Bangladesh, Pakistan, Indi dhe Kinë. Kjo tendencë aziatike duhet të ndiqet me kujdes, pasi disa zona të projektit përmendin ekzistencën e fshehtë të strukturave të tilla të kontrabandimit aziatik. Tendencat e vëna re nga zonat e projektit, sipas cilave grupet e krimit të organizuara të përfshira në kontrabandimin e personave lëvizin dhe në trafikimin e drogave dhe armëve dhe të mallrave të tjera paralelisht, dhe madje ndonjëherë dhe sëbashku, duke përdorur të njëjtat kanale dhe "pika kontakti".

Në nivelin ndërkombëtar shpesh ka një lidhje organike ndërmjet emigrantëve dhe institucionit të azilit në njërin anë ndërsa nga ana tjetër mohohet⁶⁵ ajo me terrorizmin ndërkombëtar. Masat e marra në kuadrin e kontrollit të hyrjes dhe kontrollit kufitar mund të kenë një ndikim të vogël në parandalimin e terrorizmit, pasi fusha të tjera të politikave janë shumë më të rëndësishme (p.sh. bashkëpunimi i strukturave të inteligjencës, ngrirja e aseteve, etj.). Gjithsesi, ashtu sic është demonstruar nga hetime të ndryshme dhe nga aktivitete terroriste shpesh terroristët kanë përdorur kërkimin e azilit si praktikë për të hapur rrugën për përgatitje për sulme terroriste, ose, për t'u fshehur në mjedise të sigurta pas kryerjes së sulmeve të tilla.

⁶⁵ Për shembull: ICMPTD, Sekretariati për Sesionin Special për Procesin e Budapestit për rolin e emigracionit dhe kontrollin e kufijve në luftën kundër krimit të organizuar, 22 shkurt 2002.

3.4 KRIMI EKONOMIK

Krimi ekonomik, ashtu siç përkufizohet në Rekomandimin e Këshillit të Evropës, R (81)12 të vitit 1981⁶⁶ ka qenë një nga shqetësimet madhore të shoqërive evropiane për dekada të tëra. Rekomandimi, mbështetet në supozimin se krimi ekonomik shkakton humbje të të ardhurave publike, ka një impakt negativ mbi shoqërinë në përgjithësi dhe deformon ekonominë kombëtare ose ndërkombëtare, si dhe çënon besimin tek sistemi ekonomik. Si përfundim, ai dëmton demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut si dhe progresin ekonomik dhe shoqëror⁶⁷.

Hartuesit e Rekomandimit të Këshillit të Evropës (2000)¹¹ lidhur me "Parimet udhërrëfyese në luftën kundër krimit të organizuar" kanë nxjerrë në pah "lidhjen e ngushtë që ekziston ndërmjet krimit të organizuar dhe krimit ekonomik dhe sidomos me korrupsionin, pastrimin e parave dhe me mashtrimet të cilat krijojnë ndërmarrje kriminale (madje dhe banka) për qëllimin e kryerjes së krimeve dhe investimeve në ekonominë e ligjshme"⁶⁸. Krimi ekonomik, në anën tjetër e përdor ndërmarrjen e ligjshme për kryerjen e bizneseve të ligjshme, por duke u mbështetur tek mashtrimet, kartelet, monopolet dhe korrupsioni për të qenë i konkurrueshëm në një treg të ligjshëm. Të dyja këto forma të krimit përdorin aftësi dhe teknika të ngjashme, që realizohen nga struktura të organizuara dhe që lulëzojnë nëse gjejnë terren për bashkëpunim. Integrimi i tregjeve financiare, bashkimet e kompanive ndërkombëtare dhe strategjitë neo-liberale të tregut (privatizimi, liberalizimi i tregut dhe ulja e barrierave tregëtare) e rrisin mundësinë e krimit ekonomik, ashtu sic vihet re në skandale⁶⁹ të ndryshme ndërkombëtare.

Vendet e rajonit u përballën me forma të reja të krimit të organizuar që kishin lidhje me privatizimin dhe me sektorët bankarë dhe financiarë, të sapokrijuar, të ndjekura nga evazion fiskal, mashtrime në fushën e doganave, mashtrime në fushën e falimentimit, mashtrime në fushën e kredive financiare, korrupsion dhe pastrim parash. Krimi ekonomik ka avancuar dhe përbën një shqetësim të veçantë për këto vende, për shkak të përmasave të tij të dukshme, humbjeve të jashtëzakonshme dhe impaktit në ekonomi, që ndjehet në masën më të madhe nga publiku i vetë këtyre vendeve.

Për pasojë, vendet e Evropës Juglindore kanë nënshkruar, ratifikuar dhe miratuar pothuaj të gjitha konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare dhe evropiane në këtë fushë. Ato gjithashtu kanë përpunuar strategji, plane veprimi dhe programe të gjera, në pajtim me standardet evropiane të të drejtave të njeriut, kanë krijuar struktura organizative të ngjashme me ato që ekzistojnë në Shtetet Anëtare të BE-së, kanë themeluar organizma të posaçme (të tilla si Njësitë e Inteligjencës Financiare), kanë shkëmbyer praktikat e mira/më të mira si dhe kanë bërë vëzhgime të njëri-tjetrit. Pavarësisht nga kjo, akoma dihet pak për përmasat reale dhe efektet e krimit të organizuar dhe krimit ekonomik, metodat për vlerësimin e humbjeve dhe ndikimit nuk ekzistojnë, ndërkohë që bashkëpunimi ndërmet FIU, Ministrive të Financës dhe agjencive të tjera të zbatimit të ligjit, Ministrive të Brendëshme dhe

⁶⁶ Rekomandimi i Këshillit të Evropës R (81) 12 I vitit 1981, mbi Krimin Ekonomik (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 25 qershor 1981) rendit 16 vepra penale specifike dhe jo-spezifike të cilat konsiderohen krime ekonomike.

⁶⁷ Këshilli i Evropës "Raporti mbi Gjendjen e Krimit të Organizuar, viti 2005", me theksin tek Kërcënimi i Krimit Ekonomik, dhjetor 2005.

⁶⁸ Shih pjesën 18 të Memorandumit Shpjegues të Këshillit të Evropës (2001) 11. Gjithsesi, nevojitet të bëhet një dallim i qartë ndërmjet krimit të organizuar, terrorizmit, dhe krimit ekonomik, dhe të shqyrtohen disa Konventa të Këshillit të Evropës si për shembull Konventa për Pastrimin e Parave, Kapjen, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e të ardhurave nga Krimi dhe Financimi i Terrorizmit (CETS 198), Krimi kibernetik (ETS 185) dhe Protokolli i Dytë Shtesë i Konventës për Asistencë të Ndërsjellë Ligjore në Çështjet Kriminale (ETS 182) si dhe Direktiva të tjera të ngjashme dhe Vendime Kuadër.

⁶⁹ Si për shembull skandali i Parmalat, Enron, Flow-Tex ose Elf Aquitaine ose, së fundmi, WorldCom, Tyco International, VW dhe Siemens.

Ministrive të Drejtësisë duhet të rritet. Duket sikur përgjigjet e pyetësorit nuk trajtojnë krimin ekonomik "të organizuar", por të gjitha llojet e krimit ekonomik .

Një panoramë e tillë e turbullt e krimit ekonomik⁷⁰ shkakton ndryshime të mëdha, dhe, si rezultat, analiza e krimit ekonomik dhe krimit financiar në këtë raport nuk ka synim që të jetë historikisht e saktë, por kufizohet vetëm në zhvillimet e fundit dhe në shifrat që janë marrë nga zonat e projektit për këto elementë:

Mashtrimet në fushën e taksave dhe të doganave

Mashtrimet në fushën e taksave dhe të doganave janë raportuar nga të gjitha zonat e projektit si një prej fushave më të rëndësishme të krimit. Ky lloj mashtrimi realizohet kryesisht me anë të kompanive fiktive të regjistruara, me dokumente identiteti të rreme (ID të vjedhura, ose të falsifikuara). Taksat doganore shmangen nga mos raportimi i saktë i vlerës së mallrave të importuara, duke pretenduar që të hyjnë tranzit në vend ndërsa mallrat shiten në "tregun e zi" dhe/ose bëhet kontrabandimi i mallrave përgjatë të gjithë kufirit. Kontrabandimi i naftës dhe cigareve në rajon, vecanërisht gjatë sanksioneve kundër Serbisë, vazhdon ende, por është në një nivel më të ulët. Suksesi i caktimit të kontrolleve mbi evazionin fiskal duke prezantuar TVSH-në ndryshon nga një vend në tjetrin.

Në pjesën më të madhe të zonave të projektit **kontrabandimi** përbën një treg të rëndësishëm për krimin e organizuar. Megjithëse shkalla e kontrabandimit është ulur si rezultat i normalizimit gradual të rajonit⁷¹, rrjetet e kontrabandimit të krijuara në vitet 90 janë akoma shumë aktive. Shërbimi kufitar dhe reformat doganore të zbatuara në rajon cuan në një kontroll më të mirë kufitar dhe mbylljen e pikave të paligjshme kufitare. Gjithsesi, korrupsioni i doganave dhe oficerëve kufitarë është ende kyc për aktivitetet kontrabanduese. Sipas vlerësimeve të Bankës Botërore, Europolit, FMN-së, OLAF-it, Europol-it, Frontex-it, dhe strukturave të tjera ndikimi i kontrabandimit të cigareve nga dhe në Evropën Juglindore vazhdon ende të ketë përmasa shqetësuese, në vecanti pasi së fundmi grupet turke të krimit të organizuar duket se janë të përfshira në trafikimin e cigareve dhe të heroinës⁷².

OLAF, Zyra Evropiane e Anti Mashtrimit, paralajmëroi në raportin e saj të 2004-ës drejtuar Këshillit dhe Parlamentit Evropian⁷³ se kontrabandimi i cigareve shkakton dëme të konsiderueshme për buxhetet e Shteteve Anëtare. OLAF-i në 'Raportin Vjetor të 2006-ës'⁷⁴ raporton operacionin e suksesshme "Fake" të majit të 2005-ës (një operacion i kryer për të kapur kontrabandimin e mallrave të fallsifikuara nga Azia, i cili coi në kapjen e 140 ngarkesave ajrore dhe 60 kontenierësh detarë). Një tjetër operacion i përbashkët i specializuar i policisë dhe doganave në Bullgari coi në kapjen e cigareve të kontrabanduara dhe në shmangien e trafikimit të një totali prej më shumë se 8,5 milionë paketash cigareje (Super Kings) nga Kina nëpërmjet Turqisë në Greqi; dëmi për buxhetin e BE-së do të kishte shkuar në rreth 3,1 milionë⁷⁵ euro). Më së fundi, në shkurt të 2007-ës, u mbyll operacioni i OLAF-it "Diabolo", i cili ishte një operacion i përbashkët ndërkombëtar doganor i 27 Shteteve Anëtare të BE-së, me pjesëmarrjen e Interpol-it, Organizatës Botërore të Doganave dhe Europol-it, i cili coi në kapjen e 67 kontenierëve me ngarkesa të paligjshme, në kapjen e aftësisht 135 milionë cigaresh me marka të fallsifikuara dhe 557,000 produkte të tjera të fallsifikuara me origjinë nga portet aziatike (vetëm për cigaret, operacioni ndihmoi në parandalimin e humbjeve të mundshme të rreth 22 milionë eurosh taksa dhe tarifa doganore për Komunitetin Evropian dhe buxhetin e Shteteve Anëtare⁷⁶).

⁷⁰ Megjithëse zonat e projektit janë udhëzuar që të bëjnë orientimin mbi 16 pikat e "Rekomandimeve të Këshillit të Evropës" R (81)12.

⁷¹ Regjimet e TVSH-së të krijuara së fundmi dhe tregëti më të liberalizuara ndërmjet vendeve do të cojnë në uljen e varësisë tek të ardhurat e akcizës dhe ato doganore, por nuk do të cojnë në heqjen e tyre të plotë.

⁷² Raporti i BE-së për Krimin e Organizuar, 2005, Europol.

⁷³ COM (2005)323, botuar më 19 qershor 2005.

⁷⁴ OLAF, Raporti Vjetor 2005, 13.7.2006.

⁷⁵ http://ec.europa.eu/comm/anti_fraud/budget/2005/bg.pdf

⁷⁶ Pjesëmarrja e Europol-it synuar në kontrollimin e informacionit të mbledhur gjatë operacionit për përfshirjen në rrjetet e krimit të organizuar. <http://www.europol.europa.eu/index.asp?page=news&news=pr070419.htm>

Shqipëria raporton përsa i përket krimeve në fushën e doganave në vitin **2004** 163 raste, numri u rrit në vitin **2005** në 125 raste dhe u rrit përsëri në vitin **2006** në 170 raste. Gjithsesi, numrat korrespondues të rasteve gjatë periudhës së raportimit (224-174-205) dëshmojnë se mund të ketë vetëm pak raste të përfshirjes së grupeve të krimit të organizuar. E njëjta gjë është e vërtetë për krimet e raportuara në fushën e taksave (**2004**: 66 raste me 71 autorë; **2005**: 33 raste me 31 autorë; **2006**: 17 raste me 25 autorë). Gjithsesi, bazuar në të dhënat e policisë duket se të paktën në fushën e krimeve të taksave shifrat po ulen dhe organizatat e taksave janë përmirësuar pas kontrollit të të ardhurave publike. Disa operacione të kryera nga organizatat e doganave në vitin **2005** janë premtuese, si për shembull konfiskimi i cigareve, kafesë, telefonave celularë dhe mallra të tjerë me një vlerë totale prej 4 milionë eurosh. Duhet përmendur një operacion i vecantë policie që zbuloi një grup krimit të organizuar i cili dyshohej se kishte kontrabanduar 11 kontenerë me cigare në vend. Studime për raste të tilla nuk janë raportuar për vitin **2004** dhe **2006**. Shumë e rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm do të jetë synimi për të krijuar një klimë më miqësore për investimet dhe bërja më konkurruese e ekonomisë duke miratuar një paketë fiskale në fund të majit, e cila përfshin një taksë së sheshtë në nivelin e 10% – nivelin më të ulët në Evropën Juglindore.

Ky 'revolucion fiskal'⁷⁷ do të inkurajojë legalizimin e ekonomisë informale dhe do të thjeshtojë mbledhjen e taksave. Aktiviteti ekonomik dhe raportimi i ndershëm i të ardhurave pritet që të rritet, ndërkohë që evazoni i taksave do të ulët. Cështje shqetësuese mbeten të dhënat për zbatimin e ligjit, të cilat nuk janë as në nivelin e shifrave të raportura nga Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, e cila, për shembull në vitin **2005** raportoi një shifër prej afërsisht 9,700 çështjesh, ndërsa numri i raportuar nga policia ishte rreth 1,000 çështje.

Bosnja dhe Hercegovina raporton se krimet ekonomike inkurajohen si rezultat i hapësirës ekonomike, ndarjes⁷⁸ juridiksionale dhe globalizimit të përgjithshëm. Në vitin **2004**, Federata e BiH cilësoi 1,187 njësi ligjore si të padisponueshme, fiktive ose paralele⁷⁹. Autoritetet e taksave të Republika Srpska-s raportuan për të njëjtin vit 464 kompani të padisponueshme, 73 kompani fiktive dhe 21 kompani paralele. Statistikat dhe informacionet e raportuara gjatë viteve të fundit nuk u përgjigjen pyetjeve të pyetësorit. Gjithsesi në vitin **2005**, u raportuan 54 raste të evazionit fiskal, dhe në "fushën e doganave" u raportuan të paktën 580 raste. Në vitin **2006** u raportuan të paktën 11 raste të mashtrimit të taksave. Krimet në fushën e doganave nuk u raportuan qartësisht. Raportet e Distriktit të Brčko në BiH raportojnë për vitin **2005** pesë raste të mashtrimit të taksave dhe në vitin **2006** dhe nëntë raste të tjera, ndërkohë që nuk ka informacion të disponueshëm për krimet në fushën e doganave. Republika Srpska ka raportuar deri tani vetëm shifra të përgjithshme. Pra nuk qe e mundur që të bëhej një krahasim dhe analizim i të dhënave me vitet e mëparshme. Asnjë nga juridiksionet nuk dha informacion për përfshirjen e grupeve të krimit të organizuar.

Kroacia e bazon evazionin e kontrollit doganor në krimet më të zakonshme. Në një vështrim të 60 krimeve që besohen që janë pjesë e krimit ekonomik, evazoni i taksave ose tarifave të tjera (neni 287 CC) po ulët nga 98 raste (**2005**) në 68 raste (**2006**), ndërsa mënjanimi i kontrollit doganor (art. 298) është në nivel të lartë me 632 raste (**2005**) dhe 621 raste (**2006**). Nuk është dhënë informacion tjetër, dhe nuk është dhënë informacion për përfshirjen e grupeve të krimit të organizuar.

Kosova raporton nga **2004** rreth 5,000 raste të krimit ekonomik, por vetëm tri raste janë të lidhura qartësisht me grupet e krimit të organizuar⁸⁰. Për vitin **2005**, dhe **2006** u raportuan pesë raste të evazionit të taksave dhe dy raste të kontrabandimit të mallrave. Nuk është dhënë informacion tjetër, dhe nuk është dhënë informacion për përfshirjen e grupeve të krimit të organizuar.

⁷⁷ <http://www.albania.de/alb/index.php?p=974>, 4 qershor 2007.

⁷⁸ Bosnja dhe Hercegovina ka katër juridiksione në sistemin e drejtësisë kriminale: niveli shtetëror, dy nivele entitetesh (Republika Srpska dhe Federata e Bosnje dhe Hercegovinës) dhe Distrikti Brcko.

⁷⁹ Kompanitë janë të disponueshme kur ato regjistrojnë një adresë që nuk ekziston ose përdorin dokumenta fallso regjistrimi; kompanitë fiktive përdorin dokumenta fallso identifikimi; kompanitë janë paralele kur përdorin kopje të dokumentave të regjistrimit, por ndyshojnë emrin e pronarëve.

⁸⁰ Këshilli i Evropës, raport i situatës së Krimit të Organizuar 2005; vëmendja në kërcënimin e krimit ekonomik, Strasburg, Dhjetor 2005, fq 88.

Mali i Zi e sheh krimin ekonomik si një ndër kërcënimet kryesore, megjithëse gjatë viteve të fundit ekonomia është bërë më e qëndrueshme dhe "ekonomia gri" është shtypur në mënyrë efikase. Si vend tipik tranziti, Mali i Zi haset me një potencial të konsiderueshëm të formave të ndryshme të kontrabandimit dhe akoma vuan nga "mekanizma të dobët të kontrollit të zhvillimit". Në vitin **2005** gjashtë padi u ngritën kundër 36 autorëve të krimit, të cilët ishin pjesë e grupeve të organizuara të krimit dhe të dyshuar për kryerjen e 54 veprave kriminale dhe 15 rasteve të kontrabandimit. Në vitin **2006** u raportuan 107 raste. Nuk është dhënë informacion tjetër, dhe nuk është dhënë informacion për përfshirjen e grupeve të krimit të organizuar. Për të gjithë periudhën nuk u dha asnjë informacion për krimet e taksave.

Në **Serbi**, kontrabandimi i mallrave të akcizës po rritet lehtë dhe përbën ende një ndër format më të zakonshme të krimit të organizuar⁸¹. Në bazë të shifrave të raportuara nga policia e taksave, evazoni total i taksave u rrit nga 48.2 milionë euro në vitin **2004** në 108.7 milionë euro, në vitin **2005** dhe 226.1 milionë euro. Gjithsesi, pjesa më e madhe e rasteve kryheshin nga një ose dy persona. Kjo dëshmon se përqindja e përfshirjes së grupeve të krimit të organizuar në evazionin e taksave është një përqindje me një shifër kundrejt të gjitha 1,938 rasteve të raportuara. Megjithëse ka disa rezultate të mira (agjencitë e zbatimit të ligjit në Serbi konfiskuan gjatë tri viteve të fundit mallra që kapin një vlerë të përgjithshme prej 5 milionë eurosh), grupet e krimit të organizuar i ndryshojnë praktikatat e kontrabandimit në varësi të kushteve të reja. Nuk është dhënë informacion tjetër, dhe nuk është raportuar asgjë në lidhje me përfshirjen e grupeve të krimit të organizuar.

"Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" përmend evazionin fiskal si një ndër veprat penale më të shpeshta. Në vitin **2005**, policia raportoi 114 raste të evazionit të taksave të kryer nga 178 autorë, dhe në kushte të përgjithshme, TVSH-ja dhe kontrabandimi vazhdon të jetë problem, në vecanti kontrabandimi i cigareve, alkolit, tekstileve, kompjuterave, telefonave celularë ose artikujve ushqimorë në të gjithë vendin, i cili thuhet se është *'epiqendra e kontrabandës'* në rajon. Zyra e Prokurorit Publik që është përgjegjëse për raportet për krimin e organizuar dhe korrupsionin për vitin **2006** hetoi (në etapa të ndryshme) më shumë se 100 autorëve (lidhur me evazionin e taksave) respektivisht më shumë se 60 ishin të lidhur me kontrabandimin e mallrave. Policia për vitin **2006** raporton 35 raste të evazionit fiskal dhe 164 raste të kontrabandimit me 212 autorë krimesh. Së pari, për vitin **2006**, u dhanë shifra të sakta për përfshirjen në grupet e krimit të organizuar në këto fusha krimesh: në 20 raste u zbuluan grupet e krimit të organizuar (tre deri në shtatë anëtarë); ato përbëheshin nga 80 kriminelë, kryesisht nënshkretas meshkuj nga vendi, Serbia dhe Bullgaria. Në dy raste u zbuluan dy grupe të organizuara kriminale që kontrabandonin në sasi të mëdha medikamente, alkol dhe cigare nga Serbia në Maqedoni. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ka paraqitur informacion të detajuar në lidhje me rastet e kontrabandimit, mallrat e kontrabanduara, vlerat, rrugët e kontrabandës, magazinat, zhvillimet e reja, mekanizmat e kontrollit dhe konfiskimet (psh 25 milionë cigare dhe mallra të tjera, taksat e të cilave shkojnë në 2,416 milionë euro).

Fabrikimi i parave dhe fallsifikimi i dokumentave

Fabrikimi i parave dhe fallsifikimi i dokumentave kanë paraqitur rëndësi të madhe për zonat e projektit; në vecanti fabrikimi i parave, i cili po rritet në rajon. Numri i eurove të fabrikuara rritet çdo vit e më shumë. Europol-i tregon nëpërmjet analizave të tij se pjesa më e madhe e kartmonedhave euro të cilësisë së mirë prodhohen nga kriminelë në Evropën Juglindore (kryesisht Bullgaria) dhe rajonet balltike⁸² dhe nënvizon se fabrikimi i eurove bëhet në ato tregje kriminale të cilat do të thithin më shumë vëmendje gjatë viteve në vijim⁸³.

Shqipëria raportoi se gjatë periudhës së raportimit janë zbuluar 2,500 raste të fallsifikimit të dokumentave dhe rritje të numrit të rasteve të fabrikimit të parave (27 – 36 – 51 raste). **Bosnja dhe Hercegovina** renditën si vepra penale më domethënëse të krimit ekonomik shpërndarjen e parave të fabrikuara (në total rreth 350 raste). **Kroacia** raportoi më shumë raste të fabrikimit të parave (**2005**: 15 raste, **2006**: 27 raste) dhe shifra të mëdha fallsifikimesh për të gjitha llojet e dokumentave (**2005**: 1,287 raste, **2006**: 1,180 raste). **Kosova** raportoi vetëm shifra të vogla të fabrikimit të parave (gjashtë raste në 2006-ën) dhe fallsifikime

⁸¹ Po aty

⁸² Raporti i BE-së për krimin e organizuar, 2005, Europol.

⁸³ Vlerësimi i Kërcënimit të Krimit të Organizuar 2006.

dokumentash (në total rreth 20 në vitin 2006). **Mali i Zi** raportoi vetëm tre raste të fabrikimit të parave në vitin 2005, por numri u rrit në 108 për 2006-ën dhe në të njëjtin vit janë raportuar dhe rritje në numrin e fallsifikimit të dokumentave (më shumë se 450 raste). **“Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë”** raportoi në 2005-ën sekuestrimin e 195 kartmonedhave të fallsifikuara, por për vitin 2006 nuk u dha ndonjë informacion.

Disa nga zonat e projektit kanë raportuar statistika të përgjithshme mbi krimin (krime në fushën e kompanive private, falimentimit, vjedhjes së pronës, mashtrimit, abuzimit me detyrën, etj) disa të tjera dërguan informacion të detajuar mbi lloje të caktuara krimi, dhe disa zona të projektit bënë deklarata më të përgjithshme. Si rezultat, të dhënat nuk mund të përdoren për një analizë serioze.

Gjithsesi, në bazë të të dhënave që u morën për këtë periudhë kohe, mund të bëhet deklarata e mëposhtme:

Krimi ekonomik në Ballkan ka natyrë në thelb rajonale dhe pavarësisht nga specifikat e zonave të projektit ai lulëzon vetëm nëse është ushqyer më pare nga lidhje të ngushta rajonale. Të gjitha vendet besojnë se krimi ekonomik përbën një kërcënim serioz për ekonominë dhe shoqëritë e tyre. Gjithsesi nuk është e qartë nëse krimi ekonomik po rritet apo po ulët. Informacioni i disponueshëm në nivelet e autoriteteve gjyqësore, doganore ose të taksave nuk përkon gjithnjë me statistikat e ofruara nga agjencitë e policisë. Po të mblidhen përgjigjet e dhëna në dy pyetësorët dhe po të krahasohen rezultatet me sondazhe të tjera ndërkombëtare krimi ekonomik duket se po rritet

Fallsifikimi i dokumentave dhe fabrikimi i parave

Fallsifikimi i dokumentave dhe i parave duket se po rritet. Afërsia me qendrat e prodhimit (Bulgari) është shumë e rëndësishme për zhvillimin në të ardhmen. Teknologjia e nevojshme bëhet më e lirë dhe më e disponueshme dhe fuqizimi i euros dhe pranimi i saj të gjërë si mjet pagese, vecanërisht në Evropën Juglindore e bën atë më shumë tërheqëse për fabrikim sesa dollari amerikan.

Vetë krimi ekonomik shkakton **humbje domethënëse të të ardhurave publike** dhe prish tregjet ligjore. Vetëm pak zona të projektit (Shqipëria, Serbia dhe Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë) kanë raportuar humbje të miliona eurosh, kryesisht në fushën e evazionit të taksave dhe të kontrabandimit. Në këtë kontekst, ekonomia rajonale dhe buxhetet publike do të vazhdojnë që të pësojnë humbje⁸⁴. Si rezultat, krijimi i Strukturave të Koordinimit të Anti-Mashtrimit (AFCOS) sa më shpejt të jetë e mundur është thelbësore. Këto pika qëndrore kontakti për koordinimin e të gjitha aspekteve legislative, administrative dhe operative për mbrojtjen e interesave financiare janë krijuar në vendet që u futën në BE rishtazi--Bullgari dhe Rumani⁸⁵.

Pirateria e prodhimeve dhe krimi kibernetik

Prodhimi pirat i produkteve dhe krimet kundër të drejtës së pronësisë intelektuale (IPR) kanë ndoshta impaktin më të madh tek Shtetet Anëtare të BE-së në drejtim të humbjes së taksave dhe punësimit⁸⁶ dhe është duke u zhvilluar si treg kriminal në Evropën Juglindore.

Policia e **Shqipërisë, Kosovës, Malit të Zi dhe “Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë”** nuk kanë paraqitur asnjë të dhënë mbi këtë lloj krimi. **Kroacia** përmirësoi kapacitetin e saj, krijoi një njësi të specializuar dhe ka raportuar për vitin 2004 936 raste të krimeve të tilla, për vitin 2005 1,090 raste dhe për vitin 2006 2,032 raste, me rritje domethënëse të pornografisë tek fëmijët. **Kosova**, në raportin e saj të parë

⁸⁴ Shih raportin e Qendrës për Studimet e Demokracisë *Korrupsioni, Kontrabanda dhe Krimi i Organizuar në Evropë* (2003), fq 8.

⁸⁵ Takimi i AFCO-s në Bukuresht, 1 qershor 2006, ku OLAF dhe ekspertë të anti-mashtrimit dhe hetues nga 10 Shtete të cilët u bënë pjesë e BE-së në 2004-ën ndanë eksperiencën e tyre operative me kolegët e tyre nga Bullgaria dhe me Rumania dhe me kolegë nga shtetet kandidatë për në BE, Kroaci dhe Turqi.

⁸⁶ Europol, 2005 EU Raporti mbi Krimin e Organizuar.

në vitin 2006 flet për këto lloj krimesh. FIU zbuloi një ndër rrjetet më të fuqishme të krimit kibernetik në zonat e projektit, të përbërë nga 12 autorë (shqiptarë të Kosovës) në bashkëpunim me autorët e vendeve fqinje, dhe në bashkëpunim me autorët e 36 vendeve të tjera. Ky rrjet ishte i suksesshëm në ndërtimin e faqeve të rreme në internet për kompani të mëdha, duke bërë të mundur "shpikjen" e bazës së të dhënave dhe tërheqjen e parave nga llogaritë fiktive bankare (nëpërmjet ATM-ve ose Ëestern Union). **Mali i Zi** raporton vetëm 2 raste me 4 autorë, që kanë kryer 7 krime, të cilat kanë sjellë përfitime të mëdha (EUR 800,000) dhe përfitime të vogla. Pirateria në **Serbia** lulëzoi në fund të viteve 90. Në përgjigje të pyetësorit të parë, Serbia raportoi kapjen e mbi 60,000 vidio kasetave, CD-ve dhe sasive të mëdha vidiosh dhe pajisje audio dhe video të përdorura për të regjistruar imazhe, si dhe programe kompjuterike, në vitin **2004** u ngritën 680 akuza kundër 816 autorëve të dyshuar për kryerjen e 8937 krimeve; në vitin **2005** shifrat u rritën në mënyrë të ndjeshme, duke shkuar në 1,118 padi kundrejt 1,170 autorëve të dyshuar për kryerjen e 1,489 krimeve dhe në vitin **2006** shifrat u ulën në 720 padi kundër 743 autorëve të dyshuar për kryerjen e 1,054 krimeve, të cilat gjithsesi raportohen si raste të vecanta pa përfshirjen e grupeve të krimit të organizuar. Duke marrë parasysh përvojën e Serbisë në fushën e "mafias" (ku ekspertët e kompjuterave janë marrë në punë nga grupe të krimit të organizuar), mbetet e dyshimtë mungesa e përfshirjes së grupeve të krimit të organizuar.

"**Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë**", në vecanti administrata e taksave përmirësoi përpjekjet e saj kundër keqpërdorimit të pronës intelektuale. Megjithëse nuk ishin paraqitur shifra të plota të krimit për vitin **2004** dhe **2005**, u paraqit një vështrim i përgjithshëm mbi tendencat dhe modelet aktuale. Në 2006-ën u ngritën 22 padi kundër 25 autorëve të dyshuar për kryerjen e krimeve IPR dhe kundër 7 rasteve të krimeve kibernetike me përfshirjen e grupeve të organizuara të krimit, të përbërë nga 3-5 anëtarë të moshës 20-31 vjeç, që kishin nxjerrë një fitim të paligjshëm prej më shumë se 2.6 milionë dollarësh. Për më tepër, në luftën kundër piraterisë së prodhimit, Inspektoriati i Tregut Shtetëror konfiskoi më shumë se 77,000 kampionë nga entet ligjore dhe zyrtarët nga Ministria e Kulturës konfiskuan edhe 14,700 gjëra të tjera të ndryshme. Gjithsesi, nuk është dhënë informacion në lidhje me përfshirjen e grupeve të krimit të organizuar ("dyshime të arsyeshme për format e organizuara të krimit").

3.5 PASTRIMI I PARAVE

Lufta ndaj pastrimit të parave është një prej mënyrave më efektive për t'iu kundërvënë krimit të organizuar, meqenëse emëruesi i përbashkët i të gjitha krimeve të rënda dhe krimit të organizuar është nxjerrja e fitimit.

Siguria, integriteti dhe stabiliteti i institucioneve financiare dhe kreditore si dhe besimi tek sistemi financiar në tërësi mund të vihet seriozisht në rrezik nga përpjekjet e kriminelëve dhe të bashkëpunëtorëve të tyre për ta tjetërsuar origjinën e të ardhurave të tyre, ose për të kanalizuar paratë e ligjshme për qëllime terroriste. Të ardhurat e përfituara në mënyra të paligjshme mund të ri-investohen në biznese kriminale apo biznese të ligjshme, mund të konsumohen apo mund të fshihen. Për të parandaluar kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit, ato pastrohen në mënyrë që të mos dallohen prej parave të fituara me mënyra të ligjshme. Paratë pastrohen në shumë mënyra, të cilat bëhen edhe më të lehta nga metodat elektronike të pagesës dhe të transaksioneve bankare.

Për të fshehur sa më mirë origjinën kriminale të fondeve, zakonisht pastrimi i parave kryhet në një kontekst ndërkombëtar. Masat e miratuara vetëm në nivel kombëtar, apo në nivelin e Komunitetit, pa marrë në konsideratë koordinimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, do të kenë efekte shumë të kufizuara. Me qëllim që të shmanget marrja e masave nga ana e Shteteve Evropiane që do të ishin të papajtueshme me funksionimin e tregjeve evropiane, është e domosdoshme të merren masa të përbashkëta në këtë fushë - në të gjitha kontekstet (BE, Këshilli i Evropës, Kombet e Bashkuara). Këshilli i Evropës ka zhvilluar një qasje tri-planëshe për të trajtuar këtë problem (duke përcaktuar standarde mbarë evropiane, duke monitoruar situatën nëpërmjet MONEYVAL dhe duke dhënë asistencë dhe ekspertizë teknike). 40 rekomandimet e FATF dhe 9 Rekomandimet e Vecanta për Financimin e Terrorizmit mund të mos jenë të bazuara në traktat, por ato janë miratuar nga 175 juridiksione në mbarë botën dhe si rezultat përfaqësojnë një referencë botërore për parandalimin e pastrimit të parave. Pastrimi i parave është një vepër penale, që mendohet se kryhet nga grupe të krimit të organizuar për të ligjruar

fondet e paligjshme dhe shtron një sfidë gjithnjë e më të madhe në planin global, sidomos në raport me financimin e terroristëve. Në vendet evropiane, shumica e hetimeve mbi krimin e organizuar lidhen me drogën, prandaj dikush mund të mendojë që pastrimi më i madh i parave, të ketë lidhje me drogën. Por, duke pasur parasysh informacionin e raportuar mbi pastrimin e parave që vijnë nga lloje të tjera krimesh, të tilla si trafikimi i qenieve njerëzore, ose kontrabanda e personave “krimi plotësues”⁸⁷ i pastrimit të parave po spikat gjithnjë e më shumë. Gjithshtu, duke patur parasysh rendësinë e krimit ekonomik në Evropën Juglindore, pastrimi i parave në raport me fushat kryesore të krimit (të organizuar) ekonomik, mund të ketë të njëjtën përhapje. Për pasojë, “krime të tilla plotësuese” dhe krimi ekonomik që shkakton pastrim parash mendohet se do të zënë një pjesë të mirë të hetimeve financiare në të ardhmen.

Teorikisht, një sistem rigoroz kundër pastrimit të parave për të vëzhguar dhe zbuluar këtë lloj krimi, është krijuar që në fillim të viteve⁸⁷: Në një kuadër të tillë të shkëlqyer raportimi për transaksione të dyshimta financiare nëpër Evropë është rritur vitet e fundit që dëshmon jo vetëm për një rritje të mundshme të aktiviteteve të pastrimit të parave, por edhe për rigjallërimin e aktiviteteve për zbulimin e financimit të terrorizmit pas 11 shtatorit, shtimin e organizmave raportues dhe përmirësimin e sistemeve të luftës kundër pastrimit të parave në vendet evropiane si dhe për njësi më aktive të inteligjencës financiare.

Të influencuara nga ky moment, edhe vendet e Evropës Juglindore kanë marrë përsipër të formojnë kuadrin e përshtatshëm ligjor kundër pastrimit të parave si dhe të ngrenë njësitë e inteligjencës financiare, të cilat pjesërisht janë në fazat e hershme të punës së tyre. Në vijim të kësaj, hetimi financiar, si një mjet thelbësor në gjurmimin e produkteve të krimit, ende mbetet për t’u zbatuar në praktikë. Për pasojë, përveç të dhënave të rastësishme dhe vëzhgimeve që kryhen nga agjencitë rajonale të zbatimit të ligjit, të dhënat zyrtare që raportojnë nëse dhe si funksionojnë sistemet e pastrimit të parave në rajon, ose mungojnë fare, ose janë të pakta dhe të varfra.

Metodat për pastrimin e parave në Evropën Juglindore mund të jenë më pak të sofistikuara se në vende të tjera evropiane, me tregje financiare më të zhvilluara⁸⁸. Megjithëse shumica e vendeve evropiane raportojnë se investimi i të ardhurave të paligjshme në bizneset e ligjshme është bërë një pjesë e rregullt e modus operandi të grupeve të krimit të organizuar (dhe ka një impakt domethënës në zhvillimet shoqërore, ekonomike dhe demokratike të të gjitha shteteve), siç pasqyrohet ndër të tjera edhe në shtimin e numrit të hetimeve, akuzave dhe dënimeve për veprën penale të pastrimit të parave, një praktikë e tillë mbetet ende për t’u asimiluar nga vendet e Evropës Juglindore⁸⁹.

⁸⁷ Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave dhe Substancave Psikotropike (1988); Konventa e Këshillit të Evropës për Pastrimin, Kapjen, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e të Ardhurave nga Krimi e vitit 1990 (ETS 141); Rekomandime të Grupit të Punës për Veprim Financiar (FATF) (1990 dhe 2004); Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1617 (2005); Konventa e Këshillit të Evropës për Pastrimin, Kërkimin, Konfiskimin dhe Sekuestrimin e të Ardhurave nga Krimit dhe Financimin e Terrorizmit (CETS 198, 2005); Direktiva e Këshillit të BE-së për Parandalimin e Përdorimit të Sistemit Financiar për Qëllim të Pastrimit të parave dhe Financimit të Terrorizmit (2005); për më shumë detaje shihni Këshillin e Evropës, “Raporti për Situatën e Krimit të Organizuar i vitit 2005”, Fokusi tek krimi ekonomik, dhjetor 2005, fq 45 .

⁸⁸ Grupi i Punës i Veprimit Financiar dëshmoi për tendencat e mëposhtme të pastrimit të parave dhe lidhjet e mundshme me financimin e terrorizmit: “transfertat e drejtpërdrejta”, “keqpërdorimi i organizatave jo-fitimprurëse” (që mund të përbëjnë një problem specifik serioz për financimin e terrorizmit), “cënueshmëria në sektorin e sigurimeve”, “mashtrimi nëpërmjet TVSh-së”, “kazinotë dhe kumari”, “kompanitë dhe bankat përtej detit”, “Gatekeepers”. Në qershor 2006, FATF nxorri një raport të vecantë për “pastrimin e parave bazuar mbi tregëtinë” duke u përqëndruar në cënueshmëritë në importin dhe veprimet e eksportit në mars 2007 dhe një raport i vecantë për “mashttrimin nëpërmjet TVSH-së” dhe në nëntor 2007 një raport i vecantë për “Metodat e reja të Pagesës” (kartat me parapagimin, sistemet e pagesave me internet, pagesat e lrvizshme, metale të cmuara dixhitale). Po punohet për një raport të ri për “pronat e patundshme”. Për më tepër, Europoli informoi për “sisteme alternative të remitancave (ARS)” si sistemet ‘haëala’ or ‘hung fei’.

⁸⁹ Një vlerësim i rregullt efektiviteti në luftën kundër pastrimit të parave është ndërmarrë nga mekanizmi i monitorimit të Këshillit të Evropës MONEYVAL www.coe.int/moneyval.

Zonat e projektit kanë raportuar se i kanë hasur të tre etapat e pastrimit të parave dhe kanë paraqitur shembuj të karakteristikave specifike të pastrimit të parave në rajon:

Në **Shqipëri**, një sasi e konsiderueshme e parave “të pista” e ka origjinën tek krimet e kryera nga grupet shqiptare të krimit të organizuar, jashtë kufijve shtetërorë. Sektori mbizotërues për pastrimin e parave, mendohet se është biznesi i ndërtimit, ndërkohë që zonat bregdetare dhe zonat urbane janë më tërheqëset, pasi ato ofrojnë potencial për kthimin shumëfish të investimit fillestar. Një prej pengesave kryesore për të bërë kërkime serioze në fushën e krimit ekonomik dhe të pastrimit të parave është mungesa e të dhënave dhe karakteri i ndryshëm i tyre. Të dhënat statistikore e paraqitura janë të varfra dhe të fragmentarizuara: autoritetet shqiptare kanë raportuar vetëm për dy raste të pastrimit të parave në vitin 2003, gjashtë raste në vitin 2004 dhe asnjë të dhënë për vitin 2005.

Vendi është përmirësuar në lidhje me gjurmimin e sistemeve të pastrimit të parave, pasi grupet e krimit të organizuar investojnë zakonisht fitimet e paligjshme në ekonominë e brendshme formale, por dhe jashtë vendit, me mbështetjen e shqiptarëve etnikë në diasporë. Në vitin **2004**, FIU, e cila u krijua në Ministrinë e Financës, raportoi gjashtë raste të pastrimit të parave, por pa përfshirjen e krimit të organizuar. Në vitin **2005** u regjistruan katër raste, por vetëm një rast u regjistrua “në emër të palëve të treta” dhe nuk u dha informacion rreth përfshirjes së grupeve të krimit të organizuar. Në përgjigjet e këtij viti këto raste nuk janë të reflektuara në statistika. Në vitin **2006** u raportua vetëm një rast me një autor. Në lidhje me raportet në zonat e krimit gjatë kësaj periudhe kohore, duhet të përmirësohen përpjekjet për të zbuluar dhe për të hetuar rastet e pastrimit të parave dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimet.

Bosnja dhe Herzegovina (BiH) raporton se një element kyç i kësaj skeme është ndarja e brendshme ndërmjet entiteteve të Republikës Srpska, Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës me sisteme të ndryshme të zbatimit të ligjit, të bankave, të taksave dhe të regjistrimit. Shuma më të mëdha se 15000 euro ndahen në depozita më të vogla me qëllim që të shmangët zbulimi dhe shpërndahen nëpër llogari të ndryshme bankare, duke përdorur për këtë qëllim, korrierët me pagesë. Të ardhurat nga krimi integrohen nëpërmjet blerjes së pasurive të patundshme, sendeve luksoze dhe privatizimit. Në vitin **2004** BiH ka raportuar 16 raste (+ 100 për qind, krahasuar me vitin 2003). Vlera e parave të pastruara arrin përafërsisht shifrën e 26.5 milionë eurove, prej të cilave mendohet se 1 milionë Euro kanë ardhur nga evazioni fiskal. Duke iu referuar përgjigjeve të dhëna nga BiH, në vitin **2005** janë regjistruar vetëm 2 raste të pastrimit të parave në Federatën e BiH. Në këtë vit Prokurorisë së Përgjithshme, policisë shtetërore dhe gjykatës iu dha juridiksion për pastrimin e parave. Në vitin **2006**, Federata e BiH raporton në statistikat e policisë një rast të pastrimit të parave. Gjithsesi, Departamenti për Inteligjencë Financiare (FID) depozitoi 23 raporte kriminale për zyrën e prokurorisë për pastrimin e rreth 27 milionëve, ku përfshiheshin 40 autorë.

Në **Kroaci**, u raportuan mesatarisht 1,5 milionë të ardhura vjetore nga krimi, ndërsa shifra u rrit shumë në 2006, duke arritur në 54 milionë euro të nxjerra kryesisht nga trafikimi i drogave dhe krime të tjera ekonomike. Në drejtim të integritetit të produkteve të paligjshme, bregdeti kroat mendohet se është më fitimprurësi, (kompani dhe prona të paluajtshme) dhe tërheq investitorë të brendshëm si dhe investitorë rusë. Mesatarisht, 50 njoftime (sinjalizime) për transaksione të dyshimta (STRs) janë raportuar tek organet kompetente.

Në periudhën e viteve **1999-2004**, policia kroate ka hetuar 42 vepra penale të pastrimit të parave, të kryera kryesisht nga shtetas kroatë, me origjinë tek krime të tjera, që lidheshin kryesisht me drogën dhe me mashtrime në fushën e taksave. Gjatë kësaj periudhe janë dhënë dy vendime nga gjykata lidhur me pastrimin e parave, që kanë çuar në konfiskimin e 2.5 milionë, të fituara nga biznesi i drogës. Gjatë vështrimit të statistikave për periudhën **2004-2006** u pa se në këtë kohë ishin raportuar rastet të vogla të pastrimit të parave (5 - 15 - 27 raste) dhe vetëm në një rast në 2006-ën u raportua i përfshirë një 23 vjeçar pjesëtar i një grupi të organizuar krimi. Në **2006**-ën FIU kroat Kroacia analizoi 282 raste dhe në 81 raste i dërgoi autoriteteve kompetente material për transaksionet e dyshimta.

Qendra Financiare e Inteligjencës (FIC) në **Kosovë** raportoi për herë të parë për periudhën mars-dhjetor 2006 65 transaksione të dyshimta financiare. Në 50 raste informacioni iu dha autoriteteve kompetente. Nuk u dha informacion në lidhje me përfshirjen e grupeve të krimit të organizuar.

Në **Malin e Zi** sektori më i prekur nga pastrimi i parave mendohet se është bregdeti, i cili është tërheqës për biznesin e paligjshëm rus, ndërkohë që zonat bregdetare që kufizohen me Shqipërinë dhe që rrethojnë qytetin e Ulqinit mendohet se janë më tërheqëse për kapitalin e paligjshëm shqiptar. Për vitin **2005**, Mali i Zi ka raportuar vetëm për dy padi kundër 7 autorëve të pastrimit të parave në strukturat e krimit të organizuar dhe një rast shtesë. Në vitin **2006** policia raportoi në total 10 raste të pastrimit të parave, të kryera nga 41 autorë, kryesisht malazez dhe rusë. Gjithsesi, APML, FIU malazez, gjatë nëntë muajve të parë të **2006** mori mbi 100,000 CTRs, analizoi 106 transaksione dhe i referoi 20 çështje agjencive të tjera qeveritare për të marrë veprime të mëtejshme. Në vitin **2005**, Mali i Zi bllokoi një total prej 10.9 milionë dollarësh amerikanë; gjatë tetë muajve të parë të **2006** kjo shifër është rritur në 23.4 milionë⁹⁰ dollarë.

Në **Serbi** krimet që përfshijnë pastrimin e parave dhe korrupsionin konsiderohen si më të dëmshmet për shoqërinë. Sasi të mëdha të produkteve të paligjshme duket se vijnë nga shmangia e detyrimeve tatimore dhe doganore, por edhe nga trafiku i drogës, trafikimi i qenieve njerëzore dhe nga krimet e dhunshme. Produktet pastrohen nëpërmjet procesit të privatizimit si dhe nëpërmjet blerjes së pasurive të patundshme dhe sendeve të luajtshme, duke përdorur llogari bankare brenda dhe jashtë vendit (përtej detit). Në vitin **2005** u raportua vetëm një rast kundër tre bibliotekarëve, të cilët kishin ndihmuar në aktivitete të pastrimit të parave. Për më tepër u kryen pesë hetime, dhe njëra nga çështjet e shqyrtuara lidhej me marrjen peng. Në vitin **2006**, u ngritën 16 padi për aktivitete për pastrimin e parave; psh një grup i organizuar krimi i përbërë prej 14 anëtarësh që krijojnë kompani fiktive për pastrimin e rreth 250,00 eurove, një grup i organizuar krimi i lidhur me shitjen e një tenderi të një kompanie në Novi Popovac ku pastroheshin rreth 2 milionë dollarë dhe një rast i tretë dhe domethënës në të cilin një grup i krimit të organizuar u përpoq që të pastronte 400,000 euro duke përdorur kompani fiktive.

Në **“Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë”**, mundësia e parë për pastrimin e parave u krijua nga futja e Euros në vitin 2000. Që nga ajo kohë, shumica të konsiderueshme në cash (para në dorë) janë depozituar nga Kosova, me të cilën **“Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë”** nuk ka një qarkullim bankar elektronik.

Në vitin 2006, pastrimi i parave u zbulua më shumë nëpërmjet evazionit të taksave, kontrabandimit të medikamenteve, faturave fiktive, prokurimit të telefonave celularë, abuzimit me postin dhe autorizimet, si dhe mashtrimet, etj. Në total u raportuan 20 raste me përfshirjen e **“grupeve të organizuara të krimeve”** dhe përfshirjen e 63 autorëve të moshës 30-50 vjeç, që të gjithë maqedonas, në përjashtim të një nigeriani dhe një greku. Dëmi financiar për **“Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë”** thuhet se shkon deri në 2.6 milionë euro. Për më tepër, Policia Financiare ka raportuar në 2006-ën 43 raste, nga të cilat 7 ishin përfaqësuar me pjesëmarrjen e grupeve të krimit të organizuar. Humbjet financiare do të kishin qënë 3,830 milionë euro. Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave (FIU) në 2006-ën i dërgoi 20 raste agjencie përkatëse qeveritare për të bërë hetime të mëtejshme dhe për të bllokuar më shumë se 2.9 milionë euro.

⁹⁰ Byroja e Çështjeve të Narkotikëve Ndërkombëtarë dhe Zbatimit të Ligjit, Raporti i Kontrollit, mars 2007.

3.6 KORRUPSIONI

Korrupsioni nuk përbën çështje specifike vetëm për Evropën Juglindore. Ai është i vjetër sa edhe raca njerëzore dhe ka përfshirë gjithë planetin⁹¹.

Gjithsesi, pabarazitë ekonomike ndërmjet shteteve të rajonit dhe Shteteve Anëtare të BE-së dhe vendeve të tjera evropiane mund të shkaktojnë njëfarë presioni, që mund të shfrytëzohet lehtësisht nga grupet e krimit të organizuar, nëse mbetet pa përgjigje. Në vendet në tranzicion, ose në krizë¹⁷⁸, korrupsioni mendohet se ka përshkuar shumicën e strukturave të jetës publike, duke përfshirë organet e zbatimit të ligjit dhe sistemin e drejtësisë penale. Pagat e ulëta, papunësia, pasiguria dhe varfëria si dhe shpesh shembulli që ndiqet nga zyrtarët e lartë, i bën nëpunësit publikë, subjekte të pambrojtur dhe partnerë të besueshëm për grupet e krimit të organizuar. Sa më i madh të jetë depërtimi në sektorin e ligjit dhe atë qeveritar, aq më i madh është fleksibiliteti i grupeve të krimit të organizuar, për t'iu përshtatur situatave të reja dhe për të ndryshuar modus operandi të tyre.

Korrupsioni realizon marrëdhënie afat-gjata të cilat janë më të qëndrueshme dhe më të besueshme se marrëdhëniet që kanë në bazën e tyre dhunën dhe frikësimin. Korrupsioni është gjithashtu i rëndësishëm si praktikë maskuese për aktivitetet e krimit të organizuar. Grupet e krimit të organizuar e përdorin korrupsionin për të depërtuar në shtet, ekonominë e ligjshme, organet e zbatimit të ligjit dhe politikën dhe konsiderohet si një praktikë maskuese shumë më e fuqishme dhe me një nivel të caktuar garancie.

Në Evropën Juglindore, korrupsioni është identifikuar vazhdimisht nga Këshilli i Evropës dhe nga Komisioni Evropian si një problem⁹² serioz. Ai ndikon në administratën publike, politikanët, administratën e tatimeve dhe doganat, shërbimet kufitare, sistemin e drejtësisë penale, median dhe sektorin privat nëpërmjet përdorimit të rryshfeteve dhe mjeteve të tjera korruptuese siç janë mbështetja në marrëdhëniet pronar-klient, nepotizmin, favoritizmin, lidhjet familjare, marrëdhëniet etnike, raportet me personat që kanë poste të rëndësishme, ose “personat e ekspozuar politikisht” – kanë qenë metodat kryesore të grupeve të krimit të organizuar për të krijuar me sektorin e ligjshëm.

Është krijuar një sistem strikt anti-korrupsion⁹³, si dhe ka instrumenta të rëndësishëm për raportimin e korrupsionit, si për shembull Transparency International (TI), e cila ka vite të tëra përvojë, pranohet në mbarë botën dhe ka statistika të provuara⁹⁴, dhe GRECO i Këshillit të Evropës (skuadrat e vlerësimit ishin në vecanti në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci dhe “Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë”) të cilat vëzhgojnë këtë lloj krimi në planin botëror. Takimet vjetore të BE-së për datat e pranimit dhe Komitetit Drejtues të Iniciativës së Paktit të Stabilitetit për Luftën kundër Korrupsionit (SPAI) vlerësojnë vazhdimisht zonat e projektit dhe për të përpilohen raporte të rregullta vlerësimi.

⁹¹ Associated Press, e dates 29 tetor 2005, duke cituar Hetuesin Kryesor të Kombeve të Bashkuara, Paul Volckerm, i cili paraqiti raportin mbi Skandalin e Programit “Naftë në këmbim të Ushqimit” në Irak, që dukshëm ilustronte shtrirjen e korrupsionit në botë: Hetuesit zbuluan se kompani dhe individë nga 66 vende, kanë paguar një numër rryshfetesësh të paligjshme, duke përdorur metoda të shumëllojshme.

⁹² Raporti i Gjashtë i Aktivitetit të Përgjithshëm të GRECOs i vitit 2005. Në këtë kontekst shih gjithashtu Këshilli i Evropës 2004: E ardhmja e Demokracisë, (Projekti i Integruar “Vënia në punë e Institucioneve Demokratike”), raportet e përvitshme të Strasburgut dhe të Komisionit të BE-së lidhur me progresin e vendeve të pranuar.

⁹³ Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit të miratuar në vitin 2003, është nënshkruar nga 140 shtete dhe ratifikuar nga 38 prej tyre. Duhet marrë në konsideratë edhe Konventën e Bashkimit Evropian mbi Luftën kundër Korrupsionit të Zyrtarëve të Komuniteteve Evropiane ose të Zyrtarëve të Shteteve Anëtare, Konventën e OECD-së kundër Korrupsionit tek Zyrtarët e Huaj Publikë gjatë Transaksioneve Ndërkombëtare të Biznesit, Rek omandimin e Rishikuar të OECD-së mbi Luftën kundër Korrupsionit tek Zyrtarët e Huaj Publikë gjatë Transaksioneve Ndërkombëtare të Biznesit dhe Kodin e Sjelljes së Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) mbi Parimet e Biznesit të Luftës kundër Gjobëvënies dhe Rryshfetit, si masa kundër Rryshfetit.

⁹⁴ Për informacion të detajuar shihni: www.transparency.org

Korrupsioni dhe krimi i organizuar/ekonomik mendohet se janë dy anët e të njëjtës medalje. Ai përfshin rryshfetin dhe praktika të tjera korruptive të cilat drejtohen si kundër nëpunësve civilë të nivelit të ulët ashtu dhe kundër atyre të nivelit të lartë për përmbushjen e objektivave afat - gjata (rryshfete në bazë, rryshfete sistematike dhe rryshfete politike). Sipas Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit në vitin 2005, zonat e projektit janë shumë poshtë⁹⁵.

Konkluzionet e Barometrit Global të Korrupsionit, për vitin 2005, të Transparency International që përbën një radiografi të perceptimeve dhe përvojave të qytetarëve në lidhje me korrupsionin në vendet e tyre, pasqyrojnë mosbesimin e publikut të gjerë tek sistemet e tyre kombëtare politike dhe të drejtësisë penale, tek partitë politike. Rezultatet në nivelin rajonal janë pak sa ndryshe, pasi qytetarët e Evropës Juglindore i vënë gishtin sistemit të partive dhe policisë si njëlloj të korruptuara. Raporti jep informacione të dobishme mbi mënyrën se si ndryshon frekuenca e mitmarrjes në vende të ndryshme: qytetarë nga Serbia (dhe Mali i Zi) raportojnë më shpesh se ata kanë paguar një rryshfet gjatë 12 muajve të fundit sesa qytetarët nga Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia dhe Kosova ose "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë". Kjo përkon me rezultatet e pritjeve të qytetarëve: ata që jetojnë në Kosovë (ashtu si dhe ata që jetojnë në Ukrainë dhe Rumanë) ishin më shumë pozitivë (1/3 besonte se situata do të përmirësohet ndërsa në të kundërt qytetarë nga Bosnja dhe Hercegovina të cilë ishin shumë optimistë një vit më parë, raportojnë në masën 40% se presin që korrupsioni të rritet gjatë tre viteve të fundit. Duke marrë parasysh rezultatet e nxjerra nga Skuadrat e Vlerësimit të GRECO-s në Raundin e Parë dhe të Dytë të Vlerësimit në Evropën Juglindore vlerësime të tilla ka më shumë gjasa të ndodhin.

Të gjitha zonat e projektit kanë ndërmarrë masa të ndryshme për të trajtuar këtë aktivitet kriminal; ato kanë nënshkruar dhe/ose ratifikuar konventa ndërkombëtare, kanë marrë parasysh Konventat dhe Rregulloret e BE-së, kanë krijuar struktura të specializuara dhe kanë miratuar strategji dhe plane veprimi kombëtare.

Gjithsesi, nuk ka të dhëna të besueshme për të bërë analiza për lidhjen e korrupsionit me krimin e organizuar:

Shqipëria deklaroi në 2005-ën se grupet e krimit të organizuar nuk kryejnë korrupsion, por mund të përfshijnë ndërmjetësa të cilët në përgjithësi veprojnë në emër të këtyre personave. Ekspertët ndërkombëtarë besojnë akoma se të paktën në Shqipërinë e Veriut dhe të Verilindjes "kanuni" – një sistem tradicional rregulloresh që bazohet në nderin e individit që është subjekt i "klanit", ekziston ende. Janë kanunet, në vecanti "Kanuni i Lekë Dukagjinit (KLD)" që përcakton rregullat e jetës së përditshme dhe parashikon aktivitetet korruptive.⁹⁶ Në 2005-ën, u raportuan tetë raste me 11 të akuzuar dhe në 2006 u raportuan 26 raste me 43 persona të inkrimuar, dhe u tha që asnjë nga këto raste nuk lidhej me grupet e krimit të organizuar. Duke pasur parasysh se në 2004-ën Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm raportoi 443 të dyshuar për korrupsion, dhe vlerësimin e përgjithshëm të policisë sipas të cilit "korrupsioni ka përpirë të gjitha institucionet shtetërore dhe sektorin privat", shifrat e policisë duhet të vihen në dyshim.

Bosnja dhe Hercegovina (BiH) plotësoi 16 rekomandimet e Fundit të GRECO-s (nga 18 rekomandime gjithsej) dhe kaloi në raundin e dytë të vlerësimeve. Raundi i dytë i vlerësimeve për BiH u miratua nga GRECO në takimin e tij të 31 plenar, të mbajtur më 4-8 dhjetor 2006. Sipas Kodit Penal të BiH veprat e mëposhtme penale konsiderohen si vepra penale të lidhura me korrupsionin: pranimi i dhuratave ose formave të tjera të përfitimit; dhënia e dhuratave ose formave të tjera të përfitimit, penetrimi i paligjshëm, abuzimi me detyrën ose autoritetin zyrtar, keqpërdorimi i detyrës, mashtrimi në detyrë dhe përdorimi i pajisjeve të zyrës. Për 2005-ën u raportuan raste vetëm nga Federata e BiH (167). Në 2006 BiH raportoi 110 dosje kriminale kundër 159 personave. Nuk u dha informacion tjetër.

⁹⁵ Transparency International, Raporti Vjetor 2006; Ndërmjet 2003 dhe 2005, Shqipëria ra nga vendi i 92 në të 108 dhe në të 126; Bosnja dhe Hercegovina ra nga vendi i 70 në të 83 dhe më pas në të 88; Kroacia ra nga vendi i 60 në të 67 dhe më pas në të 70; "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" ka lëvizuar nga vendi i 108 në të 99 dhe më pas në të 103; vetëm Mali i Zi dhe Serbia kanë përmirësuar pozicionin e tyre nga vendi i 109 në vend të 100 dhe më pas në vend të 97.

⁹⁶ Agjensia Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), shkurt 2006.

Kroacia është e vetmja zonë e projektit që ka raportuar në mënyrë të vazhdueshme për të gjithë kohën (2003-2006) shifra në lidhje me korrupsionin: 329 raste (2003), 266 raste (2004), 442 raste (2005) dhe 430 raste (2006). Në 2006-ën, pjesa më e madhe e këtyre rasteve lidheshin me abuzimin e autoritetit zyrtar dhe detyrave qeveritare (269) dhe përmendeshin të dyja llojet e rryshfeteve (139), të cilat së bashku zënë më shumë se 90 % të të gjitha rasteve të korrupsionit. Kroacia ka regjistruar 2 raste korrupsioni, me 2 grupe të krimit të organizuar dhe 6 persona të përfshirë. Edhe raste të tjera korrupsioni janë regjistruar, që kanë përfshirë gjyqtarë dhe zyrtarë të zyrave të regjistrimit, pranë gjykatave, që lëshojnë certifikata pronësie. Kodi Penal u ndryshua në 2004-ën për të parashikuar dhe rastet e rryshfeteve në operacionet e biznesit, të tërë sistemin e supervizimit të brendshëm, i cili parashikohet që të përmirësohet, si dhe të ofrojë një organizim të ri për të forcuar luftën kundër korrupsionit.

Kosova raportoi në 2005-ën në mënyrë të përgjithshme dhe për çështje jo shumë të rëndësishme (rryshfete në masën e 250 eurove) ndërkohë që Prokurorët Ndërkombëtarë që punojnë për Departamentin e Drejtësisë së UNMIK-ut raportuan padi kundër 177 personave të përfshirë në 62 çështje korruptive. Si rezultat, vërtetësia e tre rasteve për 2006 është disi dyshuese.

Mali i Zi regjistroi 221 raste korrupsioni në 2004-ën, dhe asnjëri prej tyre nuk dëshmon lidhje me krimin e organizuar, ndërkohë që për vitin 2005 u raportuan 207 raste korruptive. Raporti i këtij viti tregon për shifra të ndryshme dhe bën dallimin ndërmjet llojit klasik të korrupsionit (dhënies dhe marrjes së një rryshfeti) dhe aktiviteteve të tjera korruptive. Sipas këtij raporti, në vitin 2005 kishte vetëm 6 raste korrupsioni dhe asnjë nga këto raste nuk ishte i lidhur me krimin e organizuar. Kjo është situata dhe për aktivitetet korruptive, përkatësisht abuzimin e pozicionit zyrtar (32 raste) ose keqpërdorimi i detyrës (32 raste). Në vitin 2006 u raportuan dy raste të korrupsionit klasik, 35 raste të abuzimit me detyrën dhe dy raste të keqpërdorimit të detyrës, dhe asnjë prej tyre nuk ishte e lidhur me krimet e organizuara. Është e diskutueshme nëse në të vërtetë nuk ka pasur raste të abuzimit me pozicionin zyrtar.

Serbia raporton mbi bazën e Kodit të Ri Penal, i cili hyri në fuqi më 1 janar 2006, dhe që parashikon të gjitha format e aktiviteteve korruptive. Ndërsa në 2003-in u raportuan 18 raste të korrupsionit të lidhura me grupet kriminale, të kryerë nga 4 grupe të krimit të organizuar të përbërë prej 81 autorëve, për vitin 2004 dhe 2005 nuk u dhanë të dhëna, por kishim të bënim me "një numër të madh të rasteve të pa raportuara". Në vitin 2006, sistemi i raportimit u përmirësuar dhe u paraqitën shifra të detajuara. U zbuluan 4 raste korrupsioni të lidhura me grupet e krimit të organizuar, me përmasa të konsiderueshme (31, 31, 51 dhe 60 autorë, kryesisht nga Serbia dhe nga vendet ish Jugosllave). Për më tepër, statistika e krimit për dhënien dhe pranimin e rryshfetit (2004: 187 padi kundër 273 personave; 2005: 237 padi kundër 381 personave; 2006: 1,813 padi kundër 2,556 personave) dërguan sinjale në të dyja drejtimet: së pari, korrupsioni i ka ende rrënjët e thella, dhe është i përhapur gjerësisht dhe së dyti struktura e LEA-s dhe kuadri i saj kanë dhënë efekte. Kjo deklaratë mbështetet dhe në raportet e rasteve studimore, të hartuara për shembull rreth "mafias së falimentimit", "mafias së trafikut" ose "mafias doganore", ku u regjistruan 18 raste që përfshinin 4 grupe të krimit të organizuar.

"Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" miratoi një ligj specifik që përmbante përkufizimin ligjor të korrupsionit⁹⁷ dhe raportoi për vitin 2005 536 raste korrupsioni, të cilat thuhet se nuk janë të lidhura me krimin e organizuar. Abuzimi me postet zyrtare qëndronte në qëndër të aktiviteteve korruptive dhe u përmendën disa mangësi në legjislacion. Në bazë të përgjigjeve të marra këtë vit, ka vetëm 47 përqind të rasteve të korrupsionit me 102 autorë, por vetëm një rast raportohet se është i lidhur me grupin e krimit të organizuar, të përbërë prej 30 anëtarësh. Marrja dhe dhënia e rryshfeteve u raportua të kishte ndodhur në 10 raste, me 12 autorë (asnjë nga rastet nuk i plotësonte kriteret e "krimit të organizuar"),

⁹⁷ Korrupsioni mendohet se është përdorimi i funksionit, autoritetit publik dhe detyrës ose pozitës zyrtare për të realizuar përfitime për veten ose të tjerët.

4 REKOMANDIME (TË SHKURTRA)

Të gjitha zonat e projektit njohin ndikimet negative të krimit të organizuar dhe krimit ekonomik në shoqëri, buxhet, ekonomi, shëndetin publik dhe segmente të tjera të jetës publike. Masat e zhvilluara nga zonat e projektit, në vecanti brenda kuadrit të projektit rajonal CARDS ndihmuan në kapërcimin e disa mangësive që ekzistonin tre ose katër vjet më parë. Është arritur rezultat i mirë në zonat e projektit, në vecanti në ndërtimin e institucioneve, dhe në kuadret legjislative dhe politike. Gjithsesi, rekomandohen këto elementë :

- Finalizimi, ratifikimi dhe zbatimi i plotë i instrumentave europiane për të ndihmuar zonat e projektit të arrijnë rezultatet dhe të lehtësojnë bashkëpunimin ndërkombëtar. Këtu përfshihen vecanërisht Protokollin i Dytë Shtesë i Konventës për Ndihmë të Ndërsjellët në Cështjet Kriminale (CETS 182), Konventa për Pastrimin, Kërkimin, Konfiskimin dhe Sekuestrimin e të Ardhurave nga Krimet dhe Financimin e Terrorizmit (CETS 198) dhe Konventa për Veprim Kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore (CETS 197);
- Intensifikimi dhe zbatimi i standardeve përkatëse evropiane për legjislacionin në fushën e privacisë dhe mbrojtjes së të dhënave, në vecanti për të rritur besueshmërinë, për të hapur dritën jeshile për pranimin në BE në të ardhmen dhe për të lejuar negocim për marrëveshje të bashkëpunimeve operative me Europol-in;
- Intensifikimi dhe miratimi i Konventës së SECI-t për qendrën rajonale, për të lejuar shkëmbimin e informacionit për të dhënat e karakterit personal ndërmjet Europol-it dhe Qendres SECI;
- Vazhdimi i nxitjes së mbledhjes së informacionit dhe analizim i të gjitha fenomeneve të krimit të organizuar dhe krimit ekonomik si dhe të terrorizmit dhe financimit të terrorizmit për të përmirësuar njohjen dhe kuptimin e tyre në rajon;
- Rritja e mbledhjes së statistikave dhe analizave për krimin në nivelin e BE-së, përdorimi i përkufizimeve të njëjta, krijimi i një sistemi të përbashkët raportimi në përputhje me sistemin e përdorur nga Europol-i dhe 27 Shtetet Anëtare (ENFOPOL 35);
- Redaktimi i raporteve vjetore mbi situatën e krimit ekonomik dhe krimit të organizuar dhe vlerësimet e kërcënimeve si dhe raportet specifike të krimit (THB, drogat etc.);
- Krijimi i mekanizmave mbështetës së informacionit sekret me qasje pro-aktive dhe ndërmjet agjensive për të filluar bashkëpunim hetimor mbështetës të orientuar drejt një qëllimi;
- Nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar duke përfshirë strukturat evropiane ose të BE-së (OLAF, Europol, Eurojust, Frontex) dhe rrejet e oficerëve ndërlidhës të BE-së;
- Vazhdimësia e masave për të forcuar aftësitë hetuese në fushat e krimit të organizuar dhe krimit ekonomik, duke përfshirë përpjekje domethënëse në heqjen e pengesave gjuhësore nëpërmjet një trajnimit të mirë të oficerëve të zbatimit të ligjit;
- Monitorimi i efektivitetit të masave për parandalimin dhe kontrollin e krimit ekonomik dhe krimit të organizuar në bazë sistematike (analiza kosto/përfitime);
- Krijimi i komiteteve drejtuese rajonale ose kombëtare të përbërë nga përfaqësues të institucioneve kryesore ndërkombëtare ose partnerë lokalë për të konsoliduar sinergjitë dhe për të kursyer kostot;
- Nxitje e vazhdueshme e kapaciteteve për hetim financiar, të synuara për kërkimin, konfiskimin dhe sekuestrimin e të ardhurave nga krimi.

5 SHTOJCË: KONCEPTI I KRIMIT TË ORGANIZUAR

Koncepti më i vjetër shumëkombësh i krimit të organizuar (1998) i përkufizuar në mënyrë zyrtare në një dokument që ka fuqinë e të drejtës ndërkombëtare është përkufizimi i organizatës kriminale në Veprimin e Përbashkët të miratuar në nivelin e BE-së⁹⁸

“Organizata kriminale nënkupton një shoqatë të strukturuar, të krijuar për një periudhë të dhënë kohore, me pjesëmarrjen e një, ose më shumë personave, që operon në mënyrë të bashkërenduar, me qëllim kryerjen e veprave penale të cilat ndëshkohen me heqje lirie, ose urdhër izolimi, për të paktën 4 vjet, ose me një dënim edhe më të rëndë, kur këto vepra përbëjnë qëllim në vetvete, ose mjet për arritjen e përfitimeve materiale, ose sipas rastit, për të influencuar në mënyrë të padrejtë, autoritetet publike operative.”

Sidoqoftë, edhe pse ai ishte miratuar në formën e Veprimit të Përbashkët, asnjëherë nuk u ratifikua nga asnjë prej Shteteve Anëtare të BE-së.

Këshilli i Evropës⁹⁹ – në Rekomandimin e tij Rec (2001) – miratoi një përkufizim të ngjashëm të ‘grupit të krimit të organizuar’, pa e reduktuar fushën e tij të veprimit tek veprat e ndaluara ndërkombëtare.

‘Grupi i organizuar kriminal’ nënkupton një grup të strukturuar, i përbërë nga tre ose më shumë persona, të cilët veprojnë në harmoni me njëri-tjetrin, me qëllim që të kryejnë një ose më shumë krime, me qëllim që të sigurojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose jo të drejtpërdrejtë, përfitime financiare ose materiale; ‘krimi i rëndë’ nënkupton atë akt që përbën një vepër të ndëshkueshme me një dënim maksimal të heqjes së lirisë, prej të paktën katër vjetësh ose me një dënim më të rëndë.

Konventa mbi Krimin e Organizuar Ndërkufitar e Kombeve të Bashkuara (UNTOC) mund të konsiderohet si përpjekja më e rëndësishme deri më sot, për të arritur një koncept të pranuar globalisht për krimin e organizuar. Kjo konventë ka hyrë në fuqi në shtator të vitit 2003. Deri në qershor 2006, ajo është ratifikuar nga të gjitha zonat e projektit, nga shumica e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës dhe të Bashkimit Evropian (deri më sot, 19 shtete). Kështu, është instrumenti ligjor më i vlefshëm për Evropën dhe për rajonin. UNTOC zbatohet për krimin e organizuar, korrupsionin, pastrimin e parave, dhe pengimin e drejtësisë, por me kusht që vepra penale të ketë natyrë ndërkombëtare dhe të përfshijë një grup të organizuar kriminal, sipas përkufizimit të dhënë në konventë. Sipas nenit 2 të kësaj konvente:

(a) ‘Grupi i organizuar kriminal’ nënkupton një grup të strukturuar, i cili ka ekzistuar për një periudhë kohe të caktuar, i përbërë nga tre ose më shumë persona, të cilët veprojnë në harmoni me njëri-tjetrin, me qëllim që të kryejnë një ose më shumë krime, ose vepra penale të rënda, të përcaktuara si të tilla, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, me qëllim që të sigurojnë, në mënyrë direkte, ose indirekte, përfitime financiare ose materiale.

(b) ‘krimi i rëndë’ nënkupton atë akt që përbën një vepër penale të ndëshkueshme me një dënim maksimal të heqjes së lirisë, prej të paktën katër vjetësh ose me një dënim më të rëndë.

(c) ‘grup i strukturuar’ nënkupton një grup që nuk krijohet rastësisht për kryerjen e menjëhershme të një vepre penale, dhe që nuk nevojitet të ketë të përcaktuar rolet e anëtarëve të tij, vazhdimësinë e anëtarësisë në të, ose të ketë një strukturë të zhvilluar.

Pyetësi i CARPO-s kërkoi përcaktimin e kritereve të mëposhtme gjatë përcaktimit të krimit ose grupit kriminal si ‘krimi i organizuar’:

⁹⁸ Veprimi i përbashkët 98/733/JHA (Justice and Home Affairs-Punët e Brendëshme dhe Drejtësia), i datës 21 dhjetor 1998, miratuar nga Këshilli Evropian, mbi bazën e Nenit K.3 të Traktatit për BE-në, që parashikonte penalizimin e pjesëmarrjes në një organizatë kriminale në Vendet Anëtare të Bashkimit Evropian.

⁹⁹ Rekomandimi (2001) 11 i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare lidhur me parimet udhërrëfyese kundër krimit të organizuar, miratuar nga Komiteti i Ministrave, më datë 19.09.2001, në mbledhjen e 765-të të Zëvendës-Ministrave.

Kriteret e detyrueshme

Bashkëpunimi i tre ose më shumë personave + një periudhë e zgjatur ose të pacaktuar kohe + të dyshuar, ose të dënuar për kryerjen e një vepre të rëndë penale + me synimin për të arritur fitime dhe/ose pushtet

Kriteret fakultative:

1. Secili anëtar ka një rol, ose një detyrë të veçantë
2. Përdor një formë të caktuar të disiplinës së brendshme
3. Përdor dhunën ose metoda të tjera të frikësimit
4. Ushtron ndikim mbi politikën, median, administratën publike, organet e zbatimit të ligjit, administrimin e drejtësisë, apo mbi ekonominë duke përdorur korrupsionin, ose mjete të tjera
5. Përdor struktura tregtare, apo të ngjashme me biznesin
6. Përfshihet në pastrim parash
7. Vepron në nivel ndërkombëtar

Përveç karakteristikave minimale (ose 'kriterëve të detyrueshme' nga 1 tek 4), të paktën dy nga 'kriteret fakultative' duhet të plotësohen, për ta kualifikuar një grup kriminal, ose një krim, si krim të organizuar.

6 BIBLIOGRAFIA

Amnesty International:

Kosova (Serbia & Mali i Zi) – “A do të thotë kjo që unë kam të drejta?” – *Mbrojtja e të drejtave njerëzore të grave dhe vajzave të trafikuar*

për prostitucion në Kosovë, Londër, 2004

Gratë dhe vajzat e trafikuar në Kosovë kanë të drejta njerëzore, Botim shtypi, 5 Qershor 2004

(<http://news.amnesty.org/mavp/news.nsf/print/ENGEUR700122004>)

Kosovë: *Paqeruajtësit ndërkombëtare mbajnë ndezur shfrytëzimin seksual, trafikimin dhe mizorinë njerëzore*, 6 Maj 2004.

Begovic Boris, Mijatovic, Bosko, dhe Hiber Dragor: *Korrupsioni ne Gjqësor, Qendra e Studimeve Liberale – Demokratike*,

Beograd 2004, <http://www.clds.org.yu>

Bosnja dhe Hercegovina, Ministria e Sigurimit: *Raport mbi Sigurinë: Tre – mujori i parë*, 2004

Korporata e Transmetimit Britanik (BBC, <http://news.bbc.co.uk>):

Zyra Ndërkombëtare e Anti – Drogës dhe e Çështjeve të Fuqizimit të Ligjit, Raporti i Sigurisë mbi Malin e Zi, Mars 2007

Trupat e OKB-se në Kosovë ‘mbajnë ndezur tregtinë e seksit’, 5 Qershor 2004, news.bbc.co.uk/go/pr/fr/-/2/hi/europe/3686173.stm

Krimi ekonomik ‘kushton 40 miliard paund britanik’, 17 Tetor 2004

Ashdown shkarkon liderin e Boshnjakëve Kroatë, 29 Mars 2005,

www.newsbbc.co.uk/1/hi/world/Europe/4390635.stm.

Black, C./Van der Beken, T./Frans, B./Paternotte, M. (2001): *Raportim mbi krimin e organizuar. Një zhvendosje nga përshkrimi në*

shpjegim në Raportin Vjetor Belg mbi Krimin e Organizuar, Antwerp, Maklu.

Projekti Blue Bird (Axhendë për Shoqërinë Civile në Evropën Jug - Lindore: *Në kërkim të një Qeverie Reaguese: Ndërtimi i Shtetit*

dhe Rritja Ekonomike në Ballkan, Qendra për Studimin e Politikave, , Central European University, 2003 (www.cls-sofia.org)

Capps, Robert: *Jashtë ligjit dhe ‘Fryrësit e bilbilit’ skllavë - seksi të mbrojtur, nga Korriku dhe Gushti 2002*, www.salon.com.

Castells, M. (20032) : *Ngritja e Shoqërisë në Rrjet. Malden/Oxford/Victoria.*

Qendra për studimin e Demokracisë (www.csd.bg/publications.php)

Korrupsioni, Kontrabanda dhe Krimi i organizuar ne Evropën Jug - Lindore, Sofje, 2003

Tregu i drogës në Bullgari, Sofje, 2003

Bashkëpunëtorë në krim: Rreziku i simbiozës midis sektorit të sigurimit dhe krimit të organizuar në Evropën Jug – Lindore, Qendra për

studimin e Demokracisë, Sofje, 2004

Transporti, Kontrabanda dhe Krimi i Organizuar, Qendra për studimin e Demokracisë, Sofje, 2004

Tendencat e krimit në Bullgari: Statistikat e policisë dhe anketat viktimizuese, Qendra për studimin e Demokracisë, Sofje, 2005

Chossudovsky, Michel: *Shefi i OKB-se fajëson pjesërisht shtetet e BE-së për dështimin në pengimin e rritjes së trafikimit në Evropën Jug -*

Lindore, 26 Korrik 2002, Qendra për Kërkime mbi Globalizimin, www.globalresearch.ca

Këshilli i Evropës:

Trafikimi i Qenieve Njerëzore dhe Korrupsioni (Programi PACO, TP 28 rev), Strasburg, 2002

Trafikimi i Qenieve Njerëzore, Reforma e Legjislacionit Penal në Evropën Jug-Lindore, Projekti “LARA”, Zagreb, Prill 2003.

Raporti i situatës mbi Krimin e Organizuar,2004 - Fokus: Kërcënimi i krimit elektronik, Strasburg, 2005

Raporti i situatës mbi Krimin e Organizuar,2004 - Fokus: Kërcënimi i krimit ekonomik, Strasburg, Dhjetor 2005

Këshilli i Bashkimit Evropian / Grupi Ndër – Disiplinor mbi Krimin e Organizuar (2003): Kontrabanda e produkteve të duhanit në

Bashkimin Evropian dhe lidhjet e tij me krimin e organizuar. Bruksel (CRIMORG 90).

Komisioni Evropian:

Opinion mbi Aplikimin e Kroacisë për Anëtarësim në Bashkimin Evropian: Komunikatë nga Komisioni, Komisioni i Komuniteteve

Evropiane, Bruksel, 20 Prill 2004

Procesi i Stabilizimit Asociimit për Evropën Jug – Lindore: *Raporti i Tretë Vjetor*, Komisioni i Komuniteteve Evropiane, Bruksel, 2004

Delegacioni i KE-se në Bosnje Hercegovinë: *Mashtrim i mundshëm i sheqerit*, Botim shtypi, Sarajevë, 2 Gusht 2004,

<http://www.delbih.cec.eu.int/en/worddocuments/word271.htm>

Qendra Evropiane e Monitorimit për Drogën dhe Varësinë nga Droga (EMCDDA):

Raporti Vjetor 2003: Situata e problemit të drogës në Bashkimin Evropian dhe Norvegji, Lisbonë, 2003

Raporti Vjetor 2003: Situata e problemit të drogës në vendet hyrëse dhe kandidatë të Bashkimit Evropian. Lisbonë, Qendra Evropiane e

Monitorimit për Drogën dhe Varësinë nga Droga.

Iniciativa Evropiane e Stabilitetit (www.esiweb.org):

Momenti i Helsinkit: Ndërtimi i Shteteve Anëtare Evropiane në Ballkan, 1 Shkurt 2005

Ç'industrializimi dhe pasojat e tij: Një histori Kosovare, Mars 2002

EUROPOL:

(www.europol.eu.int)

Raporti i Bashkimit Evropian mbi Krimin e Organizuar, Dhjetor 2004,

Raporti i Bashkimit Evropian mbi Krimin e Organizuar, Tetor 2005,

Trafikimi i qenieve njerëzore për shfrytëzim seksual në BE: Një këndvështrim i Europol-it, Janar 2006, (www.europol.eu.int)

Vlerësimi i Kërcënimit të Bashkimit Evropian për Krimin e Organizuar, (OCTA) 2006

Krimet e lidhura me kompjuterin brenda BE-së: Krimet të vjetra, mjete të reja; krimet të reja, mjete të reja, (2002), Hagë.

Niveli i Bashkimit, Sirakuzë/Itali, Maj 2005.

Financial Times: *Sondazh mbi rolin e Malit të Zi në tregtinë e jashtëligjshme të cigareve*, 9 Gusht 2001;

FOCUS:

"Fauler Geschmack", raport mbi kontrabandën e duhanit dhe prodhimin të jashtëligjshëm të cigareve në Gjermani, Nr. 20, Maj 2006

"Weiße Lawine", raport mbi sekuestrimet e kokainës në Bashkimin Evropian, Nr. 27, Korrik 2006

FIJNAUT, Cyrille dhe Letezia Paoli, *Krimi i Organizuar në Evropë, Konceptet, Modelet dhe Politikat e Kontrollit në Bashkimin Evropian*

e më tej, Studime të Krimin të Organizuar, edituar nga Springer, Doordrecht/Holandë, Shtator 2004

HINA (Agjencia Kroate e Lajmeve): *Punonjësi i administratës shtetërore në Makarska nën hetim*, Lista Jutarnji, 12 Maj 2005.

Human Rights Watch: *Shpresat e tradhtuara: Trafikimi i grave dhe vajzave në Bosnje Hercegovinë e mbas luftës për prostitucion të*

detyruar, Vol 14, Nr. 9, Nëntor 2002.

Huremagic, Ramiz: *Trajtimi i "Fantazma": Krimi i Organizuar dhe Kontrolli i tij*, Tema e Studimeve pas universitare për M.Sc në

Kriminologji dhe Sistemin e Drejtësisë Penale, Universiteti i Wellsit, Cardiff, Shtator 2001 (i pa publikuar)

Komisioni Ndërkombëtar mbi Ballkanin: *Ballkani në të ardhmen e Evropës*, Prill 2005, www.balkan-commission.org

Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM):

Modelet dhe Tendencat në ndryshim të trafikimit të personave në rajonin e Ballkanit: Vlerësim i bërë në Shqipëri, Bosnje Hercegovinë,

Provencën e Kosovës (Serbia, Mali i Zi), "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" dhe Republika e Moldovës, Korrik 2004, www.iom.int

Grupi Ndërkombëtar i Krizave:

- Serbia: *Rrotullimi i rrotave të saj*, Njoftim i përditësuar, Njoftim i Evropës Nr. 39, 23 Maj 2005, Beograd/Bruksel, www.crisisgroup.org
- Kthesa në vend e Serbisë, Raporti Evropës N°154, 26 Mars 2004, www.crisisgroup.org
- Raporti Ndërkombëtar i Luftës dhe Paqes (IWPR, www.iwpr.net)
- Jovanovska, Svetlana: *BE mendon për një marrëveshje të re ndihme për Ballkanin*, IWPR, Nr. 550, 6 Prill 2005
- Barnett, Neil: *Raketat e sekuestruara në Shqipëri*, IWPR, Nr. 533, 16 Dhjetor 2004
- Musta, Suela: *Nano pyetet në lidhje me paditë mbi kontrabandën e armëve*, IWPR, Nr. 528, 19 Nëntor 2004
- Ahmetasevic, Nidzara: *Opozita Boshnjake kërkon ligje anti - korrupsion*, IWPR, Nr 552, 15 Prill 2005
- Jelacic, Nerma: *Hetuesit e mafias nën sulm*, IWPR, Nr. 542, 18 Shkurt 2005
- Lasica, Natalija: *Bosnja lufton me valën e varësisë nga droga*, IWPR, Nr. 550, 6 Prill 2005
- Jelacic, Nerma dhe Griffiths, Hugh: *Hetuesit e mafias nën sulm*, IWPR, Nr. 542, 18 Shkurt 2005
- Jelacic, Nerma dhe Griffiths, Hugh: *A do të përballohet Evropa me Mafien e Bosnjës?*, (IWPR), Nr. 531, 2 Dhjetor 2004
- Jelacic, Nerma: *Përhapjet e Eksplozivëve*, IWPR, Nr. 458, 05 Shtator 2003
- Papic, Srdjan: *Kontrabandistët e Bosnje Hercegovinës gjejnë rrugë për të anashkuar shtrëngimet e kufirit*, IWPR, Nr 425, 25 Prill 2003
- Radic, Renata: *Shpenzimet e larta të liderëve Boshnjakë përçajnë buxhetin*, IWPR, Nr. 511, 12 Gusht 2004
- Anna McTaggart dhe Drago Hedl: *Kroacia: Një punë në vazhdim*, IWPR Nr. 562, 27 Qershor 2005
- Dimovski, Sase: *Gjykatat Malazeze, Serbe në krizë*, IWPR, Nr. 437, 13 Qershor 2003
- Hajrullahu, M., Salihu, A., Xharra, J.: *Perëndimi i egër i Kosovës*, IWPR, Nr 542, 18 Shkurt 2005
- Xharra, Arbana: *Gangsterët dhe burokracitë pengojnë Investitorët e Kosovës*, IWPR, Nr. 550, 6 Prill 2005
- Sullivan, Stacy: *Raport Special: A i ka mbushur standardet Kosova?*, IWPR, Nr. 549, 1 Prill 2005
- Sunter, Daniel: *Policia merr në kontroll kufijtë e Serbisë*, IWPR, Nr 543, 25 Shkurt 2005
- Sunter, Daniel: *Shkarkimi i shefit të policisë shikohet si "pastrim"*, IWPR, Nr. 512, 20 Gusht 2004
- Cvijanovic, Zeljko: *Drita jeshile e BE-se do të siguronte një qeveri reaguese*, IWPR, Nr. 548, 23 Mars 2005
- Simpson, John dhe Bojovic, Zelimir: *Serbia humb luftën me korrupsionin doganor*, IWPR, Nr. 541, 11 Shkurt 2005
- Serbia: *BE-ja mund të zgjasë ndalimin e sheqerit*, IWPR Nr. 445, 18 Korrik 2003
- Joosens, Luk/Raw, Martin (1998): *'Kontrabanda e cigareve në Evropë: Kush përfiton në të vërtetë?'* Në: Kontrolli i duhanit 1998 (7) 66-71.
- Raporti mbi Situatën CARPO
- Kleinfeld Belton, Rachel: *Përkufizime konkurruese të shtetit të së drejtës: Implikime për Praktikuesit, Esetë e Carnegie-t, Seritë e*
- Shtetit të së Drejtës, Ndihma e Carnigie-t për Paqen Ndërkombëtare, Nr. 55, Janar 2005 (www.ceip.org/files/projects/dlr/dlr_home_121002.ASP)
- Krastev Ivan: *Retorika anti - korrupsion dhe reformat e politikave*, Qendra për Strategjitë Liberale, 1997 (www.cls-sofia.org)
- Morrison, J. (1992): *'Skanimi mjedisor'*, në M. Whitely et al (eds.): *Një guitë për Studiuesit e rinj institucionalë*, Tallahassee,
- Shoqata për Kërkime Institucionale.
- Shërbimi Kombëtar Informativ për Krimin (NCIS): *Vlerësimi i Kërcënimit i Mbretërisë së Bashkuar: Kërcënimi nga krimet e rënda dhe krimi i organizuar*, 2003, www.ncis.gov.uk
- Nelken, D. (2002): *Krimi i kravatave të bardha*. Në: Maguire et al., 844-876.
- Nicolic-Ristanovic, V. et al (2004): *Trafikimi i personave në Serbi*. Beograd (Shoqëria e Viktimologjisë në Serbi dhe OSBE).
- Obradovic, Vladimir: *Trafikimi i grave në Bosnje Hercegovinë*, Fakulteti i Qendrës për Kërkime në Kriminologji, Universiteti i Sarajevës, Sarajevë, Janar 2004
- OLAF (Zyra Anti - Mashtrim e Bashkimit Evropian, europa.eu.int/olaf)
- Olaf jep fakte në gjyqin e "Lidhjes Malazeze" për përfshirjen në trafikimin ndërkombëtar të cigareve*, Botim për shtyp OLAF/12/2003, 30 Prill 2003,
- Hetimi i Olaf-it në importin e sheqerit nga rajoni i Ballkanit*, OLAF/15/2003, 29 Maj 2003, Instituti i Shoqërisë së Hapur (www.eumap.org):

Monitorimi i procesit të anëtarësimit në BE: Politika e korrupsionit dhe anti - korrupsionit, OSI, 2002
Monitorimi i procesit të futjes në BE: Kapaciteti gjyqësor, OSI, 2002
Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (www.osce.org):
Raporti i Ekspertëve të pavarur për Sekretarët e Përgjithshëm të OSBE-së dhe Këshillit të Evropës në vizitën e tyre në Podgoricë (Mali i Zi, Serbi) nga 22 deri më 24 Korrik 2003, raporti i përbashkët i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë dhe Këshillit të Evropës, 3 Shtator 2003
Qëndrimi dhe Konkluzioni i qeverisë së Malit të Zi në lidhje me Raportin e Ekspertëve të pavarur për Sekretarët e Përgjithshëm të OSBE-së dhe Këshillit të Evropës në vizitën e tyre në Podgoricë (Mali i Zi, Serbi) nga 22 deri më 24 Korrik 2003, Qeveria e Malit të Zi, 16 Tetor 2003.
Komisioni për ristrukturimin e policisë së Bosnje Hercegovinës, Raporti përfundimtar mbi punën e Komisionit për ristrukturimin e policisë së Bosnje Hercegovinës, , Dhjetor 2004 (www.ohr.int/ohr-dept/rule-of-law-pillar/prc/)
Radio Evropa e Lirë: Mali i Zi: Kryeministri mohon akuzat për kontrabandë cigaresh, 7 Nëntor 2003
Zyra Ndërlidhëse Informativë Rajonale për Evropën Perëndimore - RILO (2001): LASSO 2000 - Përmbledhje mbi Kontrabandën e cigareve në Evropë, Cologne/Rotterdam.
Save the Children, Mbretëria e Bashkuar (Programi i Serbisë) 2004: *Mbrojtja e fëmijëve nga trafikimi i qenieve njerëzore*. Beograd.
Savona, Ernesto U. dhe Curtol, Federica: Kontributi i Sistemit të shkëmbimit të të dhënave në Luftën kundër krimin të organizuar në vendet e Evropës Jug - Lindore: Raporti Përfundimtar, Krimi ndërkombëtar (Qendra e Studimeve të Përbashkëta mbi Krimin Ndërkombëtar e Universitë Degli Studi di Trento dhe Università Cattolica Del Sacro Cuore), Nëntor 2004,
www.transcrime.unitn.it
Skrozza, Tamara: Intervju - Verica Barac: *Vlada je centar korupcije*, Vreme Nr. 748, 5 Maj 2005, www.vreme.com
Pakti i Stabilitetit për Evropën Jug - Lindore: *Raporti i Parë Vjetor mbi Viktimat e Trafikimit në Evropën Jug Lindore, Task Forca e Paktit të Stabilitetit mbi Trafikimin e Qenieve Njerëzore*, Shtator 2003
TRANSCRIME, Qendra e Kërkimit mbi Krimin Ndërkombëtar në Universitetin e Trentos, Janar 2003
"Situata e Krimin të organizuar në vendet e Evropës Jug-Lindore dhe Aktivitetet e Jashtëligjshme të kryera nga grupet e kriminelëve të organizuar", një vlerësim i Paktit të Stabilitetit, të kryer nga Transparenca Ndërkombëtare:
Raporti Global mbi Korrupsionin, 2005: *Korrupsioni në ndërtimin dhe rindërtimin e mbas luftës*, Transparenca Ndërkombëtare, (www.globalcorruptionreport.org)
Tisné, Martin, dhe Smilov, Daniel: Nga toka sipër: *Vlerësimi i Rekordit të Ndihmës Anti - Korrupsion ne Evropën Jug - Lindore*, Qendra për Studimin e Politikave, Central European University, Rrjeti i Fondacionit Soros, 2004
Anti - Korrupsioni në Evropën Jug - Lindore: *Hapat e para dhe politikat*, Qendra për Studimin e Demokracisë, Iniciativa Evropës Jug - Lindore për Zhvillimin Ligjor (SELDI), 2002,
Kombet e Bashkuara (UN): UNMIK Trafikimi dhe Njësitë e Prokurorisë (TPIU): *Raporti i fundit të vitit 2003 Trafikimi i qenieve njerëzore në Evropën Jug - Lindore*, Raporti i përbashkët me UNICEF, UNOHCHR, dhe OSBE/ODIHR, Nëntor 2003
Raporti mbi Situatën CARPO

Trafikimi i qenieve njerëzore në Evropën Jug - Lindore: 2004 - Përqendrimi në parandalim, raport i përbashkët i UNICEF, UNOHCHR, dhe OSBE/ODIHR, Mars 2005
UNODC (www.unodc.org)
Raporti Botëror i Drogës, 2004, Vjenë
Drogat dhe tendencat e krimit në Evropë e më tej, 2004 (a), Vjenë.
Sondazhi i shtatë i Kombeve të Bashkuara për tendencat e krimit dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë penale, duke mbuluar periudhën 1998 - 2000, Zyra e Kombeve të Bashkuara mbi Drogën dhe Krimin / Qendra për Parandalimin e Krimit Ndërkombëtar, 2002, Vjenë.
Departamenti i Shtetit Amerikan: Raporti i Trafikimit të Personave, Zyra për Monitorimin dhe Luftimin e Trafikimit të Personave, 14 Qershor 2004, (www.state.gov/g/tip/rls/tiprpt/2004)
Vander Beken, Tom: *Matja e Krimit të Organizuar në Evropë: Një studim i realizueshmërisë së një metodologjie të bazuar në rrezikun nga krimi i organizuar në Bashkimin Evropian*, Instituti për Studime Ndërkombëtare dhe Politika Kriminale, Universiteti Ghent, Publikuesit Maklu, 2004
Von Lampe, Klaus (2001) *Tregu i jashtëligjshëm i cigareve në Gjermani: Një studim i një çështjeje të krimit të organizuar* (Ese e prezantuar në takimin e parë vjetor të Shoqërisë së Kriminologjisë Evropiane, Lausanne, Zvicër, 6 Shtator 2001).
Xenakis, Sappho: *Sfida e krimit të organizuar ndaj sovranitetit shtetëror në Ballkan, Një përfaqje historike*, 7 Janar 2001, www.ksg.harvard.edu/kokkalis/GSW3/Sappho_Xenakis.pdf
Raporti mbi Situatën CARPO

7 SHKURTIMET DHE AKRONIMET

ABA CEELI	Shoqata Amerikane e Avokatisë dhe Nisma Ligjore e Evropës Qendrore dhe Lindore
AFCOS	Strukturat Koordinuese Kundër Mashtrimit
AHTU	Njësia kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore e UNODC
AI	Amnistia Ndërkombëtare
AIDS	Sindroma e Përfitur Imuno-Deficite
AISI	Nisma Detare e Adriatikut dhe Jonit
ARQ	Pyetësorët e Raporteve Vjetore
ATS	Simulantët e llojit të amfetaminave
BiH (BIH)	Bosnje dhe Hercegovina
BUMAD	Programi i Asistencës së BE-së për Parandalimin e abuzimit me drogën dhe trafikimit të saj në Belarus, Ukrainë dhe Moldavi.
BSCE	Nisma Bashkëpunimit të Detit të Zi
CADAP	Programi Aksionit të Drogës së Azisë Qendrore të Bashkimit Evropian
CAN	Rrjeti i Analizës Kriminale
CARDS	Asistenca Komunitare për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilitet (KE)
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit kundër Grave
CEE	Evropa Qendrore dhe Lindore
CEI	Nisma e Evropës Qendrore
CEPOL	Kolegji i Policisë Evropiane
CIA	Agjencia Qendrore e Informacionit
CIDA	Agjencia Ndërkombëtare e Zhvillimit Kanadeze
CIS	Komonuelthi i Shteteve të Pavarura
CIVPOL	Njësia e Policisë Civile të UNMIK-ut
CNPA	Policia Anti Narkotike e Afganistanit
COE	Këshilli i Evropës
CRC	Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës
CPI	Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit
DAS	Asistencë e drejtpërdrejtë e viktimave të trafikimit
DFID	Departamenti Britanik Për Zhvillimin Ndërkombëtar
DG	Drejtoria e Përgjithshme (KE)
DOC	Departamenti i Kriminologjisë të Organizuar
DOS	Mohim i Shërbimit
EC	Komisioni Evropian
EU	Bashkimi Evropian
EUFOR	Forca e Bashkimit Evropian në Bosnje dhe Hercegovinë
EURODAC	Baza e të dhënave të BE-së për azil kërkuesit
EUROPOL	Zyra e Policisë Evropiane
EUROJUST	Njësia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin Gjyqësor
ELCS	Sistemi i Europol-it për etiketimin e kokainës
EPLN	Rrjeti Evropian i Mësimin Policor
EMDCCA	Qendra Evropiane e Monitorimit për Drogat dhe Varësinë ndaj Drogës
FATF	Task Forca e Veprimin Financiar
FIU	Njësia e Inteligjencës Financiare
FIC	Qendra e Informacionit Financiar
FRONTEX	Kufijtë e Jashtëm, (ligjërisht: Agjencia e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Bashkëpunimit Operacional në Kufijtë e Jashtëm të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian)
FSRB	Organ rajonal i ngjashëm me FATF
GAP	Programi i Vlerësimit Global
GDP	Prodhimi i Brendshëm Bruto
GPAT	Programi Global kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore

GPO Zyra e Prokurorisë së Përgjithshme

Raporti mbi Situatën CARPO

GRECO	Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit
HAART	Terapia Shumë Aktive Antiretrovirale
HDI	Indeksi i Zhvillimit Njerëzor
HIO	Operacionet me Ndikim të Lartë
HINA	Agjencia Kroate e Lajmeve
HOPS	Projekti i Opsionit të Shëndetshëm, Shkup
HIV	Virusi Imuno - Deficit Njerëzor
IDI	Indeksi i Drogave të Jashtëligjshme
ICITAP	Programi Ndërkombëtar i Asistencës Trajnuese për Hetimet Penale
ICMC	Komisioni Ndërkombëtar Katolik për Migrimin
ICMPD	Politika e Zhvillimit e Qendrës Ndërkombëtare për Migrimin
ICS	Sindikata Italiane e Solidaritetit
ICTY	Gjykata Ndërkombëtare për Krimet e Luftës në ish - Jugosllavi
IIPM	Misioni Policor Italian - Interforze
IHRLG	Grupi Ligjor i të Drejtave Ndërkombëtare të Njeriut
ILO	Oficer Ndërlidhës Emigracioni (Rrjeti i BE-së)
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
ILO-IPEC	Programi Ndërkombëtar i ILO-s për Eliminimin e Punësimit të Fëmijëve
INTERPOL	Organizata Ndërkombëtare e Policisë
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
IPO	Oficer Ndërkombëtar Policie
IREX	Bordi Ndërkombëtar për Kërkime dhe Shkëmbime
ISS	Shërbimet Sociale Ndërkombëtare
KFOR	Forca e Kosovës (Forcë e udhëhequr nga NATO)
KLA	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
KPS	Shërbimi i Policisë së Kosovës
LPO	Oficerët Lokalë të Projektit të Këshillit të Evropës CARPO
MAPE	Element Shumë Kombësh Këshillues i Policisë
MARRI	Nisma e Paktit të Stabilitetit për Migracionin, Azilin, Refugjatët dhe Ri-atdhesimin
MoI (MOI)	Ministria e Brendshme
MOJ	Ministria e Drejtësisë
ML/TF	Pastrim i Parave/Financim i Terrorizmit
MONEYVAL	Komiteti i Zgjedhur i Ekspertëve të Këshillit të Evropës mbi Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave
MOU	Memorandum Mirëkuptimi
NCB	Byroja Qendrore Kombëtare (Interpol)
NGO	Organizatë jo-Qeveritare
NHDR	Raport i Zhvillimit Kombëtar Njerëzor (UNDP)
NPA	Plani Kombëtar i Veprimit
NPO	Organizatë jo Fitimprurëse
NRM	Raportuesi Kombëtar Holandez kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore
OCTA	Vlerësim i Kërcënimit nga Krimi i Organizuar
OHR	Zyra e Përfaqësuesit të Lartë në Bosnje dhe Hercegovinë
ODIHR	Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
OLAF	Zyra e Bashkimit Evropian kundër Mashtrimit
OPDAT	Zyra e Jashtme e Asistencës dhe Trajnimit për Zhvillimin e Prokurorisë
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OSCE/CPE	Qendra e OSBE-së për parandalimin e krimit
OSCE/ODIHR	Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
PAMECA	Misioni i Asistencës Policore të Komunitetit Evropian në Shqipëri

PCU	Njësia e Kontrollit të Perkursorëve
PMI	Philip Morris Ndërkombëtar
PRSP	Dokumentet Strategjike për Zvogëlimin e Varfërisë

Raporti mbi Situatën CARPO

PNI	Rrjeti i Kombeve të Bashkuara të Parandalimit të Krimit dhe Programit të së Drejtës Penale
SALW	Armë të vogla dhe të lehta
SAA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
SAP	Procesi i Stabilizim Asociimit BE - Ballkani Perëndimor
SCF	Fondi Shpëto Fëmijët
SDC	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SECI	Nisma Jug Lindore e Bashkëpunimit
SEE	Evropa Jug - Lindore
SEEPAG	Grupi Këshillimit të Prokurorëve të Evropës Jug - Lindore
SEESAC	Shtëpia e pastrimit të Evropës Jug - Lindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta
SELDI	Nisma e Zhvillimit Ligjor të Evropës Jug - Lindore
SIPA	Agjencia Shtetërore e Hetimit dhe Mbrojtjes (Bosnje dhe Hercegovinë)
SIDA	Agjencia Suedeze e Zhvillimit Ndërkombëtar
SOP	Procedurat Standarde të Veprimit
SP	Pakti i Stabilitetit
SPMU	Njësia e Çështjeve Policore Strategjike OSBE
SPOC	Nisma e Paktit të Stabilitetit për Krimin e Organizuar
SPTF	Task Forca e Paktit të Stabilitetit për Trafikimin
STI	Infeksion Seksualisht i Transmetueshëm
STR	Transaksion i Dyshimtë
SWAP	Përjasje Mbarë-Sektoriale
TAXUD	Unioni i Taksave dhe Doganave (Komisioni Evropian)
TI	Transparenca Ndërkombëtare
TIP	Njësia e Trafikimit të Personave e Departamentit të Shtetit Amerikan
THB	Trafikimi i Qenieve Njerëzore
THC	Tetrahidrokanabinol
THBS	Shërbimi i Trafikimit të Qenieve Njerëzore (Kosova)
TPIU	Njësia e Hetimit të Trafikimit dhe Prostitucionit (Kosova)
TRANSCRIME	Qendra Kërkimore mbi Krimin Ndërkombëtar në Universitetin e Trentos
UN	Kombet e Bashkuara
UNAIDS	Programi i Përbashkët i Kombeve të Bashkuara mbi HIV/AIDS
UNDP	Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara
UNFPA	Fondi i Popullsisë i Kombeve të Bashkuara
UNHCR	Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët
UNICEF	Fondi i Fëmijëve i Kombeve të Bashkuara
UNICRI	Instituti Ndër-Rajonal i Kombeve të Bashkuara për Kërkime Mbi Krimin dhe Drejtësinë
UNIFEM	Fondi i Zhvillimit për Gratë i Kombeve të Bashkuara
UNINCB	Bordi Ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara për Kontrollin e Narkotikëve
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara për Administrim të Ndërmjetëm në Kosovë
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin
UNOHCHR	Zyra e Kombeve të Bashkuara e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
UNTOC	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndër-kombëtar
VAT	Tatim mbi Vlerën e Shtuar
VOICE	Grupi i Punës ad-hoc i 40+ OJQ-ve aktive në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore
WODC	Qendra e Kërkimeve dhe Dokumentacionit (Qendra Holandeze e njohurive në fushat e drejtësisë)